

Banka popullore e Republikës së Maqedonisë



**RAPORTI VJETOR
viti 2016**

Shkup, prill 2017

Përkthim në gjuhën shqipe: Grupi punues i Fakultetit të biznesit dhe ekonomisë pranë
Universitetit të Evropës Juglindore Tetovë (i pa lektuar).

Përmbajtja

Fjala e guvernatorit.....	5
I. Politika monetare në vitin 2016	8
1.1. Qëllimet e politikës monetare.....	8
1.2. Pozicionimi i politikës monetare.....	9
II. Ambienti ndërkombëtar	17
III. Lëvizje makroekonomike në vitin 2016.....	21
3.1. PBB dhe inflacioni.....	21
3.2. Tregu i punës.....	23
3.3. Financa publike	26
3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm.....	29
3.5. Agregatët monetar dhe kreditor	35
IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2017 dhe 2018.....	40
V. Instrumentet monetare	43
5.1. Ndryshimet në likuiditetin e bankave	43
5.2. Instrumentet monetare	45
5.2.1. Bonot e thesarit.....	45
5.2.2. Depozitat në dispozicion dhe huatë në BPRM.....	46
5.2.3. Repo operacionet për krijimin e likuiditetit në sistemin bankar	48
5.2.4. Depozitat në valutë me Bankën Kombëtare	48
5.2.5. Rezerva e detyrueshme	48
Shtojcë 1. Lëvizjet në tregun e parasë	50
VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore	52
6.1. Drejtimet themelore në menaxhimin me rezervat në valutë të huaj	52
6.2. Kushtet për investim në tregjet financiare ndërkombëtare në vitin 2016	54
6.3. Investimi në rezerva valutore.....	56
6.3.1. Shpërndarja e investimeve sipas portofoleve	56
6.3.2. Ekspozimi kreditor dhe instrumentet	57
6.3.3. Struktura e valutave	60
6.3.4. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit dhe rezultateve nga investimi i rezervave valutore.....	61
Shtojca 2. Aktivitete të lidhura me ngritjen e kapacitetit institucional gjat menaxhimit me rezervat valutore.....	63
VII. Aktivitetet dhe trendet në sistemet pagesore	64
7.1. Sistemi i përgjithshëm i pagesave në vend	65
7.2. Instrumentet pagesore	65
7.3. Infrastruktura pagesore	68

VIII.	Emetimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike në Republikën e Maqedonisë - operacionet e thesarit	70
8.1.	Monedha në qarkullim	70
8.2.	Furnizimin e bankave dhe qendrave për para të gatshme me kartëmonedha dhe monedha metalike	71
8.3.	Përpunimi dhe anulimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike	72
8.4.	Ekspertiza për paratë e dyshimta / falsifikuara	72
8.5.	Shitja e monedhave metalike për qëllime koleksionimi	74
IX.	Statistika	75
X.	Funksioni mbikëqyrës dhe rregullator i BPRM-së.....	78
10.1.	Kryerja e supervizionit dhe mbikëqyrjes	78
10.2.	Kontrolle terreni të rreziqeve	79
10.3.	Kontrolle terreni rreth përputhshmërisë së dispozitave.....	80
10.4.	Licencimi i bankave dhe kursimoreve në vitin 2016	80
XI.	Auditimi i brendshëm.....	82
XII.	Përmirësimi i kapacitetit institucional të BPRM-së	83
12.1.	Planifikimi strategjik	83
12.2.	Menaxhimi me rreziqet operacionale.....	83
12.3.	Sigurim i funksionimit të vazhdueshëm	83
12.4.	Menaxhimi me burimet njerëzore	84
12.5.	Aktiviteti hulumtues	85
12.6.	Zhvillimi në fushën e teknologjisë informative	86
XIII.	Aktivitete të tjera	88
13.1.	Bashkëpunimi ndërkombëtar	88
13.2.	Marrëdhëniet me publikun.....	89
13.3.	Edukimi financiar	90
13.4.	Aktivitetet e Muzeut, Bibliotekës dhe arkivit të BPRM-së	91

Fjala e guvernatorit

Të nderuar,

Në vitin 2016 Banka popullore e Republikës së Maqedonisë është përballur me një varg sfidash të imponuara nga mjedisi. Ambienti makroekonomik në ekonominë vendore në të kaluarën e vitit 2016 ka qenë nën ndikimin e jostabilitetit të brendshëm politik, e cila edhe pse ekzistonte edhe në vitin 2015, megjithatë në tremujorin e dytë të vitit 2016 është thelluar në mënyrë shtesë. Në të vërtetë, duke pasur parasysh luhatjet e shkaktuara nga disa variabla të veçanta, vitin 2016 do ta shënonim në grupin e viteve të "stresuara" për ekonominë e Maqedonisë. Ambienti ndërkombëtar, krahas rreziqeve në raport me rikuperimin e eurozonës dhe rreziqeve gjeopolitike, në vitin 2016 ishte i mbingarkuar edhe me efektin e Bregxit, rezultatet e zgjedhjeve presidenciale në Amerikë, si dhe pasiguria e çmimeve të prodhimeve primare në tregjet botërore. Ngjarjet ndërkombëtare kishin efekte ndikuese shtesë në zhvillimin e pasigurisë në ekonominë vendore, edhe pse në vitin 2016 më së shumti ndikim kishin faktorët vendor joekonomik. Megjithatë, për të theksuar është reaksioni i ekonomisë ndaj goditjeve në dy vitet e fundit që na shpie në një vitalitet solid të rikuperuar me ndryshime strukturore veçanërisht në periudhën e fundit, që në kombinim me reagimin e shpejtë të BPRM në vitin 2016, kontribuuan në stabilizimin e pritjeve brenda një periudhe relativisht të shkurtër dhe rikthimi kah trendet pozitive në gjysmën e dytë të vitit.

Eskalimi i gjendjes politike në vend në prill të vitit 2016 si dhe spekulimet rreth stabilitetit të kursit të këmbimit dhe sistemit bankar, kontribuuan për të destabilizuar pritjet e popullatës. Pasojat ishin kryesisht në tregun e këmbimit dhe te depozitat e popullatës në banka, të theksuara me derdhjen e depozitave denarike dhe rritjen e pritjes për depozita në valuta të huaja. Në periudhën prill-maj, BPRM ka intervenuar me shitje neto të valutave të huaja, ndërsa në fillim të muajit maj e rriti edhe normën bazë të interesit nga 3.25% në 4%, me një zvogëlim të njëkohshëm të ofertës së bonove të thesarit në pajtueshmëri me likuiditetin e nevojshëm të bankave. Krahas asaj, ishte rritur rezerva e detyrueshme depozitave në denarë me klauzolë të valutës së huaj dhe qen aktivizuar ankandet për depozita në valutë të huaj te BPRM. Të gjitha këto masa, në kombinim me komunikimin e sforcuar me publikun, mundësuan qetësim relativisht të shpejtë të pritjeve, që krijoi kushte për rritje graduale të depozitave të popullatës tashmë që nga qershori, si edhe neto-grumbullim të valutave në tregun valutor i cili kryesisht e tejkaloi derdhjen nga faza akute e krizës. Rezervat valutore në vitin 2016 shënuan rritje, kryesisht si pasojë e prurjeve të euroobligacionit qeveritar të ri, por për gjatë tërë vitit treguesit e për mjaftueshmërisë e tyre u ruajt në një nivel solid. Pritja e rritur për mjete valutore të huaja në këtë periudhë kohore imponoi rreziqe në relacion të trendit disavjeçar të çeuroizimit, por në aspekt të qetësimit të shpejtë të pritjeve ajo ndikoi vetëm në një rritje modeste të pjesëmarrjes së depozitave të valutave në gjithsej depozitat, me çka mundet të thuhet se përfitimet nga vitet paraprake në këtë sferë në masë të madhe janë ruajtur.

Kundrejt pasigurisë të shkaktuar nga situata e brendshme politike dhe trysnive spekulative, me përjashtim të ndikimit psikologjik të pranishëm kryesisht te popullata, ekonomia e Maqedonisë u tregua mjaftë vitale, me çka edhe njëherë u vërtetuan ekzistimi i themeleve të shëndosha. Në vitin 2016 është realizuar rritje reale e PBB prej 2.4%, që paraqet realizim solid në krahasim me rrethinën dhe njëherit mbi pritjet e para të skenarit alternativ të BPRM nga maji i vitit 2016 (1.6%). Megjithatë, rritja e këtyre paraqet përshpejtim në relacion me vitin paraprak (3.8%) dhe qartësisht e shpreh ndikimin e pasigurisë në raport me vendimet e investitorëve. Pra investimet bruto shënoi rënie, ndërsa promotor kryesor të rritjes ekonomike ishin neto eksportet, të kryesuara nga kompanitë e

reja me kapital të huaj dhe efekti i volitshëm i çmimeve të importit të naftës, si dhe konsumit individual, në kushte të volitshme të zhvillimeve të tregut të punës dhe pagave. Në këtë kontekst, për të nënvizuar është edhe trendi i vazhdueshëm i zvogëlimit të normës së papunësisë, e cila kah fundi i vitit u reduktua gjer më 23.1%. Në mënyrë shtesë investimet e huaja neto realizuan rritje duke arritur 3.6% të PBB, ndërsa në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave është arritur deficit i moderuar prej 3.1% të PBB, në kushte të përmirësimit të saldoshës së këmbimit të mallrave dhe shërbimeve. Mesatarja e inflacionit në vitin 2016 shënonte vlerën prej -0.2% si pasojë e çmimeve më të ulëta të produkteve ushqimore dhe energjisë, ndërsa inflacioni bazë (pa ushqimet dhe energjinë) mesatarisht shënonte 1.4%.

Duke pasur parasysh stabilizimin e realizuar të zhvillimeve të gjysmës së dytë të vitit, fundamentit ekonomik të shëndosh të ekonomisë dhe në mënyrë shtesë konsolidimit fiskal të arritur kah fundi i vitit, në muajin tetor i ndërpreme ankandet e depozitave në valutë të huaj, ndërsa në dhjetor filluam në mënyrë graduale me normalizimin e politikës monetare. Norma bazë e interesit u zvogëluar në tre tentimet me nga 0.25 p.p., duke e sjell atë në nivelin e para krizës (në shkurt të vitit 2017).

Sistemi bankier në mënyrë të suksesshme e tejkaloi edhe këtë seri krize duke e ruajtur stabilitetin e tij. Lulohet të moderuara në fazat akute u shënuan kryesisht të treguesit e likuiditetit, edhe pse ato mbajtën në nivel të kënaqshëm, ndërsa që nga tremujori i tretë u kthyen në nivelin e zakonshëm. Kah mbarimi i vitit 2016, gjithsej depozitat të sistemi bankier u rritën për 6%, që ishte mbi pritjet e projeksioneve të muajit tetor. Rritja e kredive, nga qershori e mëtej ishte nën ndikimin e masave prudençe për shlyerje të plotë të plasmanëve jofunksionale të cilët tërësisht ishin të mbuluara me korigjime, me çka me korigjim për këtë efekt, u ruajt në nivel të lakmueshëm edhe kah fundi i vitit që shënoi 6.5%. Megjithatë rritja e kredive kryesisht udhëhiqej nga kreditimi i popullatës, kundrejt rritjes së moderuar të kredive ndaj subjekteve afariste. Në pajtueshmëri me masat prudençe të përmendura, pjesëmarrja e kredive jofunksionale në gjithsej plasmanet e bankave u zvogëluar nga 10.3% kah fundi i vitit 2015 në 6.3% kah fundi i vitit 2016.

Duke pasur parasysh mjedisin dinamik ndërkombëtar dhe zhvillimeve në tregun financiar ndërkombëtar, edhe në vitin 2016 u ndërmor një qasje aktive dhe tejet avancuese në menaxhim dhe investim në rezervat valutore, që mundësoi menaxhim fleksibil dhe tejet të suksesshëm me ndryshimet në rezervat valutore, në kushte të luhatjeve të tregjeve.

Në vitin 2016 u përmbyll edhe mbindërtimi i sistemit pagesor ndërbankar në Maqedoni MIPS të BPRM për realizimin e pagesave edhe në euro (krahas asaj denarike), me çka kaloi në sistem pagesor dy valutash duke vendosur lidhje korrespondente me sistemin pagesor Evropian. Ky projekt paraqet reformat e gjeneratës së dytë në sferën e infrastrukturës pagesor, pas reformës së parë kyçe të vitit 2001. Objektivi përfundimtar i këtij projekti kapital është pagesa në euro e subjekteve vendore tej kufijve më shpejtë, më sigurt dhe më lirë. Në vitin 2016 vazhduam me avancimet e mëtejme dhe realizimi i standardeve në sferën e sistemit pagesor, statistikës, teknologjisë informatike. Njëkohësisht vazhduan aktivitetet edhe të përmirësimit të rregullativë bankare në harmoni me kërkesat e Bazelit. Kah mesi i vitit 2016, lëshuam në qarkullim kartëmonedhat e reja në vlerë prej 200 dhe 2,000 denarë, me çka do kontribuojmë në rritjen e ofertës së kartëmonedhave që janë në disponim gjatë realizimit të transaksioneve në të gatshme, si dhe ekuilibrimi i kërkesës së denominimeve të caktuara. Edhe në vitin 2016 vazhduam me mbindërtimet ekzistuese dhe përsosjen e dijeve e të punësuarve, stimulimi i mëtejme i aktiviteteve hulumtuese, si edhe organizimi i konferencave ndërkombëtare dhe ngjarjeve tjera në këmbim me publikun.

Njëherit, me qëllim të përafritit me publikun më të gjerë, nga viti 2016 BPRM është e pranishme edhe në rrjetet sociale me përmbajtje dhe informacione nga sfera e punës.

Në vitin 2016, BPRM nëpërmjet një varg aktiviteteve e shënoi jubileun e rëndësishëm të 70 vjetorit të aktiviteteve të bankës qendrore në Republikën e Maqedonisë. Vend qendror në këtë ngjarje kishte edukimi financiar i popullatës, si një nga funksionet më të rëndësishme të bankave qendrore bashkëkohore, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë dhe rolin e BPRM në shoqërinë e Maqedonisë. Në këtë kontekst, për gjatë vitit u realizua Programi për edukimin e fëmijëve nga shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë, me vizitën e tyre BPRM-së, si dhe u organizua Karvani i BPRM gjer te disa shkolla fillore të vendit. Njëherit, u realizuan dhe u promovuan dy filma edukativ, dy përmbledhje bibliografike të punimeve hulumtuese shkencore, si dhe u realizua manifestim sportiv-vrapim humanitar. Programi i aktiviteteve u rrumbullakua me manifestimin qendror të shënimit të jubileut me 19 tetor të vitit 2016, në të cilën BPRM u dekorua me Urdhrin e Meritës për Maqedoninë nga Presidenti i Republikës së Maqedonisë. Ky çmim për BPRM është dhënë për arritjet e rezultateve të rëndësishme në punët bankës qendrore, si e pavarur, bankë emetuese dhe bartës kryesor she shtyllë e stabilitetit makroekonomik të Republikës së Maqedonisë sovrane dhe të pavarur. Urdhri është një mirënjohje për të arriturat e përgjithshme dhe profesionalizmit të lartë të institucionit dhe rrjedhimisht, është një krenari për punonjësit e BPRM-së.

Në vitin 2016 u përballëm dhe në mënyrë të shkëlqyer i menaxhuam sfidat e mëdha gjatë zbatimit të politikave monetare, me çka në mënyrë të shkëlqyer u ruajt stabiliteti i kursit valutor dhe stabilitetit të çmimeve, ndërsa sistemi banka e ruajti stabilitetin e tij. Pasiguria në lidhje me situatat politike vendore, si edhe pasiguria e mëtejme globale, imponojnë nevojën e mëtejme të ndjekjes së kujdesshme të zhvillimeve vendore dhe ato të huaja. Sie edhe gjer më tani BPRM është e gatshme për të ndërmarr masa adekuate për ruajtjen e mëtejme të stabilitetit të çmimeve dhe të atij financiar, si qëllime të punës të caktuara me ligj.

27 Prill, viti 2017
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi i Këshillit të BPRM
Dimitar Bogov


I. Politika monetare në vitin 2016

1.1. Qëllimet e politikës monetare

Ruajtja e stabilitetit të çmimeve paraqet objektivin kryesor ligjor të definuar të politikës monetare të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë (NBRM). Objektivi tjetër i BPRM i cili është në varësi të objektivit kryesor, është të kontribuoj drejtë ruajtjes së sistemit financiar stabël, konkurrues dhe orientues kah tregu. BPRM e mbështet politikën e përgjithshme ekonomike pa mos rrezikuar arritjen e objektivit kryesor dhe në përputhje me parimin e ekonomisë së lirë të tregut me një konkurrencë të hapur. Në aspekt strategjik, në drejtim të arritjes së objektivave bazë, nga tetori i vitit 1995 e gjer më vitin 2001 BPRM e aplikon strategjinë e rruajtjes stabël të kursit të këmbimit nominal të denarit në raport me markën gjermane dhe më pas në raport me euron.

Në vitin 2016 BPRM me sukses i realizoi objektivat e definuara ligjore. Stabiliteti i kursit të këmbimit u ruajt, me çka të gjithë treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave zyrtare valutore edhe matej ngelën në një stad komod. Në raport me stabilitetin e çmimeve, në vitin 2016 mesatarisht është arritur një ndryshim i lehtë negativ i çmimeve vendore, në tërësi si pasojë e çmimeve më të ulëta importuese të produkteve ushqimore dhe të energjisë, përkatësisht faktorët e anën e ofertës. Në anën tjetër, inflacioni bazë (pa ushqimet dhe energjinë u ruajt në një nivel të moderuar pozitiv që korrespondon me rikuperimin e kërkesës vendore dhe kah fundi i vitit në mënyrë graduale mbyll hendekun negativ të prodhimit. Njëherësh, në mënyrë të suksesshme u ruajt stabiliteti financiar si përkrahje plotësuese në realizimin e qëllimit bazë. Realizimi i qëllimeve që arritur kryesisht në një ambient tejet të pasigurt dhe pjesërisht në rreziqe joekonomike nga ngjarjet e brendshme politike, të cilat janë të pranishëm në ekonomi që nga viti 2015. Pra, nga mesi i vitit 2016 si pasojë e përqësimeve shtesë të gjendjes politike në vend si dhe spekulimeve për stabilitetin e denarit si dhe të sistemit bankar vendor erdhi gjer te tërheqja e depozitave nga sistemi bankar, konvertimi i tyre në valutë të huaj si dhe një trysni në tregun valutor dhe atë të këmbimit. Si pasojë e ruajtjes së stabilitetit të valutës vendore si dhe stabilizimi i pritjeve dhe besimit të subjekteve ekonomike, BPRM intervenoi me shitjen e valutave të huaj nga rezervat zyrtare dhe ndërmori më shumë masa monetare për të stabilizuar gjendjen. Masat e ndërmarra si dhe komunikimi i qartë i BPRM rreth përkushtimit për ruajtjen e qëllimeve të politikës monetare sollën gjer në stabilizim më të shpejtë të besimit të subjekteve ekonomike, me çka nga fillimi i qershorit u paraqitën sinjalet e para të normalizimit, ndërsa gjer në fund të vitit efektet negative të tregut valutor edhe te depozitat në sistemin bankar qen eliminuar. Në rrethana të këtilla, kah fundi i vitit u krijuan kushtet për normalizimin e politikës monetare, nëpërmjet zvogëlimit gradual të normës bazë të interesit si dhe tërheqjen e një pjese të masave shtesë.

Grafik 1
Hendeku i prodhimit dhe inflacioni në %*




* Hendeku i prodhimit paraqet indikatorin për gjendjen ciklike të ekonomisë dhe përlogaritet si raport në mes të shmangies së PBB së realizuar nga PBB potenciale dhe nivelit të PBB potencial, hendeku i [prodhimit=(PBB i realizuar-PBB potencial)/ PBB potencial]. Inflacioni i përgjithshëm bazë paraqet ndryshimin mesatar vjetor.

Grafik 2
Rezervat valutore bruto



Grafik 3
Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore*




* Sipas rregullës së Grinspan dhe Gvidoti (Greenspan-Guidotti rule) është e nevojshme që vendi të ruaj mbulimin e plotë të borxhit afatshkurtër (maturimi rezidual) me rezervat valutore.

** Aktivi likuid përbëhet nga aktivi me likuiditet më të lartë dhe depozitave afatshkurtra të afatizuara te bankat e huaja. Aktivi gjithsej nuk i inkorporon mjetet te bankat vendore.

*** Treguesi u referohet kredive kah sektorin financiar dhe jofinanciare, me çka të dhënat për vitin 2016 i përfshinë ndryshimet nga rregullatorëve.

Burimi: BPRM dhe ESHS

Grafik 4
Treguesit e zgjedhur për stabilitetin financiar (në %)



1.2. Pozicionimi i politikës monetare


Gjatë vitit 2016, një nga faktorët kyç të rrezikut në bilancin e rreziqeve në ekonominë vendore ishte jostabiliteti i ambientit politik në vend. Efektet negative nga ky rrezik në mënyrë më të theksuar u ndej kah mesi i muajit prill, kur në kushte të eskalimit të krizës politike erdhi gjer te tërheqja më e theksuar e depozitave të popullatës nga sistemi bankar, gjatë një trendi pozitiv të konvertimit të depozitave denarike në valutë të huaj, që solli gjer te rritja e kërkesa për valuta të huaja në tregun valutor dhe atij të këmbimit. Në këtë ambient BPRM intervenoi në tregun valutor me shitje të valutave të huaja, ndërsa në fillim të muajit maj të vitit 2016 shtrëngoi politikën monetare nëpërmjet rritjes së normës bazë të interesit për 0.75 p.p. përkatësisht nga 3.25% në 4.00%¹. Sinjali për ndryshimin e drejtimit të politikës monetare u sforcu në mënyrë plotësuese me rritjen e normës së rezervave të detyrueshme për detyrimet e bankave me klauzolë në valutë të huaj. Masat e

¹ Normat e interesit në Raportin vjetor janë shprehur në nivel vjetor.

BPRM për një kohë relativisht të shkurtër, sollën gjer te stabilizimi i pritjeve dhe besimit të subjekteve ekonomike. Sinjalet e para rreth normalizimit të situatave qen shënuar në fillimi e qershorit, në të dy punktet ku kriza politike kishte efekte të drejtpërdrejta - depozitat e popullatës në sistemin bankar dhe tregun valutor. Zhvillimet e volitshme vazhduan në kontinuiteti gjer në fund të vitit, ndërsa ishin të dukshme me një rritje të vazhdueshme të depozitave të popullatës dhe intervenimeve të BPRM me riblerje të valutave, me çka rënia e rezervave valutore nga intervenimi i shitjes së valutave në periudhën prill-qershor u rimbursuar plotësisht gjer në fund të vitit. Këto zhvillime krijuan hapësirë për normalizim gradual të politikës monetare gjer në fund të vitit. Mundësia për pasimin e depozitave valutore të bankave të BPRM u tërhoq kah mbarimi i tetorit, ndërsa në fillim të dhjetorit, BPRM tani më e kishte zvogëluar normën bazë të interesit për 0.25 p.p. nga 4.00% në 3.75%².


Ambienti i jashtëm për ekonominë e Maqedonisë dhe politikën monetare karakterizohej me pasiguri dhe ndryshueshmëri të zhvillimeve edhe për gjatë vitit 2016. Edhe pse rikuperimi globale ekonomik vazhdoi, megjithatë më shumë faktor të jashtëm imponuan nevojën për menaxhim të kujdesshëm të politikës monetare vendore. Banka qendrore evropiane (BQE) edhe matej zbaton politik monetare ekspansioniste, që kontribuoi në përmirësimin e kushteve ekonomike financiare ne euro zonën, por njëkohësisht e theksoi cenueshmërisë dhe pasigurinë e rikuperimit në të ardhmen. Pasiguria nga ambienti i jashtëm në mënyrë shtesë u sfocua kah mesi i muajit qershor, me vendimi e Britanisë së Madhe për dalje nga Unioni Evropian (Brexit). Sidoqoftë, efektet potenciale direkte nga dalja e Britanisë së Madhe na Unioni Evropian ndaj ekonomisë vendore u vlerësuan si të ulëta, duke pasur parasysh ndërlidhje e ulët të ekonomisë së Maqedonisë me atë të Britanisë së Madhe, ndërsa rreziqet indirekte u kushtëzuan nga efektet ndaj Unionit Evropian, si një partner tregtar kyç me ne. Politika monetare e Rezervave Federale në SHBA (FED) ishte e pandryshuar gjer në fund të vitit, kur pas një pauze prej një viti e rriti normën e interesit. Luhatja e çmimeve e produkteve primare, që ndikojnë në inflacion vendor si dhe kushteve të këmbimit ishte karakteristika shtesë e ambientit në vitin 2016. Për gjatë vitit, prognozatat për çmimet botërore të naftës, metaleve dhe ushqimeve u korrigjuan në drejtime të ndryshme, duke rritur pasigurinë dhe duke ndryshuar supozimet në bazë të së cilëve bazoheshin pritjet për ekonominë vendore.

Grafik 5
Arritjet Rishikimet e rritjes ekonomike globale, ndryshimet vjetore (në %)



Burimi: Pasqyra ekonomike botërore (FMN, data baza e PEB)


Grafik 6
VIX indeks (indeksi i ndryshueshmërisë implicite të letrave me vlerë S&P500)



² Gjatë stabilizimit të mëtejshëm të pritjeve dhe besueshmërisë së subjekteve, gjatë muajit janar dhe shkurt të vitit 2017 BPRM në mënyrë plotësuese e zvogëloi normën e interesit për gjithsej 0.50 p.p., me çka norma e interesit të bonove të thesarit që kthyer në nivelin e parakrizës në nivel prej 3.25%.

Grafik 7

Çmimet botërore të produkteve primare, realizimet dhe revidimet, ndryshimet mesatare vjetore, në %




Politika fiskale në vitin 2016 në thelb vlerësohet si prudente, me çka, dy vite me radhë u realizua më pak deficit buxhetor në relacion me vitin paraprak, me çka vazhdoi procesi i konsolidimit. Megjithatë, rreziqet dhe pasiguritë ishin në mënyrë permanente të pranishme. Ashtu që edhe gjatë vitit, deficitet buxhetor për vitin rrjedhës në dy raste për një kohë relativisht të shkurtër qe rishikuar në drejtim rritës (nga 3.3% në 3.6% të PBB në korrik dhe nga 3.6% në 4.0% të PBB në muajin gusht³), ndërsa njëkohësisht ishte ndryshuar edhe te burimi i financimit të tij.

Këto ndryshime patën ndikim ndaj ambientit në të cilin zbatohet politika monetare. Ashtu krahas planit parësor për financimin e kombinuar të deficitit buxhetor nëpërmjet burimeve vendore dhe ato të huaja, me rishikimin e parë të buxhetit ishte parashikuar vlerë relativisht më të lartë të financimit të huaj me supozim të ndarjes së një pjese të mjeteve në llogari te BPRM. Me rishikimin e buxhetit në gusht, përsëri u bënë ndryshime edhe te vlera e deficitit buxhetor edhe te struktura e financimit të tij, me çka blera e financimit të huaj qe zvogëluar dhe ishte paraparë shfrytëzim të mjeteve paraprakisht të siguruar nga huazimi i huaj të shtetit dhe zvogëlimit të depozitave shtetërore tek BPRM, realizimet kah fundi i vitit ishin të ndryshme nga buxheti fillestar dhe dy rishikimet e bëra. Megjithatë, deficitet buxhetor në fund të vitit shënonte 2.6% të PBB dhe ishte më i ulët edhe nga ai fillestar i planifikuar dhe nga dy rishikimet buxhetore për vitin 2016, me çka shteti siguroi mjete nga ngarkesa me borxh të huaj, përkatësisht nga emisioni i euroobligacionit të rij, ndërsa një pjesë e mjeteve qen deponuar te BPRM.

³ Rishikimi i dytë i buxhetit ishte i dedikuar, me qëllim të inkorporimit në shpenzimet buxhetore e shpenzimeve dhe kompensimeve të dëmeve të një pjese të Regjionit të Shkupit, si pasojë e vërshimeve të cilat ndodhën përgjatë periudhës verore.

Grafik 8

Ndryshime të tepriceve buxhetore dhe struktura e financimit të deficitit (në milionë denarë)




Burimi: Ministria e Financave RM.

Megjithatë, një faktor më i madh i rrezikut dhe burim i pasigurisë për politikën monetare dhe për projeksionet makroekonomike ndaj të cilëve bazohet vendimmarrja monetare, në vitin 2016 konteksti politik vendor si dhe eskalimi i krizës përgjatë muajit prill dhe maj ishte tejet i pavolitshëm. Ambienti politik jostabël, i shoqëruar me spekulime për stabilitetin e kursit të këmbimit dhe sistemit bankar, shumë shpejtë i përkeqësoi pritjet e subjekteve ekonomike dhe krijoi trysni ndaj depozitave të bankat dhe kërkesës valutore. Duke pasur parasysh josisurinë rreth kohëzgjatjes së krizës dhe madhësisë së efekteve ekonomike nga ajo, BPRM në prill përpiloi skenarin makroekonomik bazë dhe atë alternativ. Skenari bazik makroekonomik paraqite stabilizim të shpejtë të krizës politike, ndërsa skenari alternativ parashikonte vazhdimin e krizës politike edhe për një periudhë kohore të caktuar, ku si kanal kryesor i bartjes së krizës ishin veçuar besueshmëria dhe pritjet e popullatës si edhe të investitorëve dhe kreditorëve vendor dhe të huaj. Në kushte të eskalimit të krizës politike dhe vlerësimet për një gjasë të lartë të realizimit të rrezeve nga skenari alternativ, BPRM në periudhën prill-maj ndërmori masa të orientuara kah stabilizimi i flukseve. Pra paralelisht me intervenimin në tregun valutor me shitjen e valutave, BPRM ndërmori ndryshime me instrumentet monetare. Së pari, në seancën e Komitetit për politik monetare operative (KPMO) i mbajtur më 3 maj të vitit 2016, u vendos që norma e interesit të bonove të thesarit të shënojë rritje për 0.75 p.p., nga 3.25% në 4%. Rritja e normës bazë të interesit ishte një sinjal i qartë për gatishmërinë për mbajtjen stabël të kursit të këmbimit dhe për rritjen e interesit për valutën vendore. Një nga kanalet e rëndësishme për bartjen e kësaj mase ishin normat e interesit pasiv të bankave. Pritej që rritje e rendimentit të produkteve kursyese do kontribuoj për ruajtjen dhe/ose rritja e kursimeve të popullsisë, e cila në atë periudhë i tërhiqte depozitat. Krahas ndryshimit të normës bazë të interesit, BPRM e zvogëloi edhe ofertën e bonove të thesarit, që së bashku me pozicionimin fleksibël të depozitave të disponueshme dhe instrumentet tjera monetare, siguroi përkrahje plotësuese të pozitës likuide solide të bankave, me çka ato me sukses e tejkaluan gjendjen krijuar.

Për të mbështetur denarizimin dhe për të ndaluar procesin e konvertimit në valutë, janë bërë ndryshime në rezervat e detyrueshme. Pra, norma e rezervave të detyrueshme për detyrimet e bankave me valutë vendore me klauzolë valutore që rritur nga 20% në 50%. Gjithashtu, BPRM krijoi kushte për të ruajtur dhe rritur depozitat valutore të bankave në ekonominë vendore. Megjithatë, duke filluar nga 13 maj të vitit 2016, bankave iu mundësua të plasojnë depozita valutore në banka qendrore me kushte të volitshme dhe norma më pozitive të interesit kundrejt normave negative të interesit të cilat mbizotërojnë në tregjet financiare ndërkombëtare. Pritej që me sjelljen e kësaj mase do të vij gjer në rritjen e të ardhurave të bankat vendore dhe sipas kësaj edhe rritjen e normave të interesit për depozita të klientëve të tyre.

Grafik 9
Shqyrtimi i projeksioneve makroekonomike




Burimi: BPRM dhe ESHS. Parashikimet për të gjithë treguesit ka të bëjë me parashikimet makroekonomike të BPRM

Masat monetare të ndërmarra si dhe komunikimi i qartë në raport me gatishmërinë për ruajtjen e stabilitetit të valutës vendore, relativisht shpejt sollën gjer të stabilizimi i pritshëm të besueshmërisë së subjekteve afariste, që ishte e dukshëm nga rritja permanente e depozitave të popullatës nga qershori i vitit 2016 dhe me intervenime të BPRM me riblerjen e valutave të cilat filluan që nga korriku i vitit 2016. Stabilizimi i shpejt i pritshëm, karakteri kufizues i krizës dhe zhvillimet e volitshme ishin sendërtuar në projeksionet makroekonomike të tetorit, të cilat na shpjen në një rritje solide kreditore dhe ekonomike, sforcim gradual të potencialit depozitues, mungesë të trysnisë së çmimeve dhe pozicionit të bilancit të pagesave e cila siguron rritje të mëtejme të rezervave valutore. Kontinuiteti i zhvillimeve të volitshme dhe projeksionet e volitshme kah fundi i vitit krijuan hapësirë të liberalizimit të politikës monetare. Ashtu që në seancën e KPMO të mbajtur më 25 tetor, u vendos që matej të mos organizohen ankande të depozitave valutore, të cilat bankat do i kishin plasuar te BPRM, ndërsa në seancën e dhjetorit të KPMO që zvogëluar norma bazë e interesit të bonove të thesarit nga 4.00% në 37%, si në hap i parë në

procesin e normalizimit gradual të saj⁴. Rezervat valutore si tregues i rëndësishëm i mbrojtjes së valutës vendore nga goditjet, në vitin 2016 ato u mbajtën në një nivel komod, a njëherit niveli i tyre kah fundi i vitit ishte në nivel më të lartë krahasuar me fundin e vitit paraprak. Rritja e rezervave valutore i tejkaloi edhe pritjet e parapara në projeksionet e tetorit, që në tërësi rezultoi nga flukset më të larta në llogarinë financiare të bilancit pagesor. Shikuar sipas faktorëve të veçantë, depozitat valutore të shtetit të BPRM ishin kategori kyçe e cila në vitin 2016 kontribuoi në rritjen e rezervave valutore (në harmoni me prurjet nga euroobligacioni). Rritje shtesë e rezervave valutore ishte siguruar edhe nëpërmjet ankandeve të BPRM për depozita valutore të bankave, aktivitet ky i ndërmarrë për të menaxhuar me rritjen e rreziqeve nga kriza. Megjithatë, e rëndësishme është të theksohet se edhe krahas trysnive për gjatë vitit, rritje të moderuar të rezervave valutore ishte arritur edhe nga intervenimi i BPRM në tregun valutor. Pra, nga prilli e gjer në maj të vitit 2016 kur gjendja politik në vend në mënyrë shtesë u përkeqësua, BPRM intervenoi në tregun valutor me shitjen e valutave (rreth 129 milionë euro, ose 5.7% nga gjendja e rezervave në fund të muajit mars). Intervenimet në gjysmën e dytë të vitit në mënyrë të rregullt kishte të bëjë me riblerjen e valutave dhe e tejkaloi vlerën e shitjeve që nga fillimi i vitit. Në vitin 2016 si pasojë e intervenimit të BPRM në tregun valutor ku u realizua neto riblerja e valutave në vlerë rreth 17 milionë euro, që paraqet tregues të karakterit spekulues dhe kufizues së efekteve nga rreziqet të imponuara nga kriza, por edhe nga reagimi i shpejtë dhe në kohë i BPRM për stabilizimin e pritjeve dhe besimit të subjektet ekonomike, si edhe themelet e shëndosha të ekonomisë dhe potencialit solid të depozitave për për t'u marrë me rreziqe të tilla dhe të ngjashme.

Grafik 10

Intervenimet e BPRM në tregun valutor dhe depozitave valutore të bankave të plasura te BPRM (në milionë euro⁵)



Burimi: BPRM

Masat e ndërmarra nga BPRM kontribuoi në stabilizimin e pritjeve të subjekteve ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit të kursit të këmbimit, si dhe nëpërmjet tij edhe ndaj pritjeve inflacioniste. Niveli i përgjithshëm i çmimeve edhe gjatë vitit 2016 në mënyrë të moderuar u zvogëlua (rënie mesatare vjetore prej 0.2%), në tërësi si pasojë e çmimeve importuese më të ulëta të produkteve ushqimore dhe energjetike. Për gjatë vitit, në kushte të arritjeve më të dobëta dhe korigjimeve të vazhdueshme të çmimeve importuese në teposhtë, edhe BPRM e rishikoi projeksionin e inflacionit në kahe rënëse. Përshtatshmëria e caktuar në teposhtë për gjatë vitit ishte karakteristikë edhe për pritjet inflacioniste, kryesisht

⁴ Gjatë stabilizimit të mëtejshëm të pritjeve dhe besimit të subjekteve, gjatë muajve janar dhe shkurt të vitit 2017, BPRM në mënyrë plotësuese e zvogëloi normën e interesit në tërësi prej 0.50 p.p. me çka norma e interesit e bonove të thesarit u rikthye në nivelin e parakrizës prej 3.25%.

⁵ Depozitat valutore në tërësi do të maturojnë në tremujorin e tretë të vitit 2017, përkatësisht në fillimin e muajit gusht.

si pasojë e zvogëlimit të çmimeve të prodhimeve primare. Në rrethana të këtilla, kur dinamika e inflacionit dhe pritjeve inflacioniste ishin nën ndikim të ndryshueshmërisë së çmimeve në tregjet botërore, ishte vlerësuar se përshtatshmëritë janë të një karakteri të përkohshëm. Kjo u vërtetua edhe përmes hendekut të prodhimit pozitiv dhe përmes ndryshimit të inflacionit bazë (pa ushqimet dhe energjinë), e cila kishte tendencë në një rritje të moderuar edhe në vitin 2016 e që shënonte 1.4% mesatarisht.


Rreziqet e shkaktuara nga kriza politike në vend u efektua në vëllimin e kursimeve të popullatës te bankat dhe strukturës valutore të depozitave, duke rritur prirjen për disponueshmërinë e depozitave në valutë të huaj. Megjithatë, efektet më së shumti u ndjenë në periudhën prill-maj, ndërsa nga fillimi i qershorit gjer në fund të vitit, depozitat e popullatës në mënyrë të vazhdueshme rriteshin, me çka rritja ishte rishpërndarë te të gjitha komponentët e kursimit, si në aspekt të afatizimi ashtu edhe në aspekt të valutës së depozitimit, që paraqet sinjal të qartë në stabilizimin e pritjeve të subjekteve ekonomike. Në kushte të këtilla, shkalla e euroizimit, i matur nga pjesëmarrja e depozitaveme komponentë valutore në gjithsej depozitat brenda një periudhe më të gjatë në vitin 2016 në mënyrë të moderuar është rritur (rreth 1 p.p.) dhe në fund të vitit shënonte 41.1%.

Si pasojë e zbutjes së një pjese të rreziqeve potenciale në raport me strukturën valutore të kursimeve, BPRM në maj bëri ndryshime edhe te rezervat e detyrueshme nëpërmjet rritjes së normës së rezervave të detyrueshme të detyrimeve të bankave me klauzolë valutore, nga 20% në 50%. Ndryshimet kanë për qëllim të sigurojnë përkrahje të mëtejme të procesit të denarizimit të depozitave dhe ndërprerje të procesit të konvertimit në valutë të huaj.

Edhe krahas ekzistimit të rreziqeve në ekonomi, mungesa e presioneve inflacioniste dhe arritjet e volitshme relative në sektorin e jashtëm siguruan ambient të volitshëm për rritje ekonomike solide të mëtejme. Aktiviteti ekonomik në vitin 2016 edhe më tej rritet, por në mënyrë të ngadaltë të moderuar, me çka arritjet ishin në suaza të pritjeve. Rikuperimi i ekonomisë, në një pjesë, ishte i përkrahur edhe nëpërmjet aktiviteteve kreditore të bankave. Rritja kreditore në vitin 2016 i tejkaloi pritshmëritë, me çka gjithsej kreditë në bazë vjetore ishin më të lartë për 0.9%, përkatësisht 6.5%, nëse do izolohej efekti nga ndryshimet rregullatore⁶, kundrejt projeksioneve për fundin e vitit prej 0.5% apo 5.6% përkatësisht. BPRM edhe në vitin 2016 i jepte përkrahje kreditimit të sektorit korporativ, nëpërmjet zbatimit të masës jostandarde të dedikuar përkrahjes së kreditimit të neto-eksportuesve dhe prodhuesit e energjisë elektrike.⁷

Grafik 11

Shkalla e euroizimit, pjesëmarrja e depozitave valutore në gjithsej depozitat (me para depozitare), në %




Burimi: BPRM

⁶ Më 17.12.2015, Këshilli i BPRM e miratoi vendimin për ndryshime dhe plotësime të Vendimit për menaxhim me rrezikun kreditues sipas së cilit përfundimisht gjer më 30 qershor të vitit 2016 bankat kanë detyrime të shlyejnë (të shlyejnë edhe mëtej) të gjitha kërkesat të cilat janë tërësisht të rezervuara më shumë se dy vite, përkatësisht te ato të cilat së paku dy vite bankat e kishin konstatuar dhe tërësisht e kanë mbuluar rrishtun kreditor nga mos arkëtimi. Krahas shlyerjes së këtyre kërkesave, përkatësisht bartjen e tyre në evidencë jashtëbilancore, bankat e ruajnë të drejtën për arkëtimin e tyre. Efekti nga bartja e këtyre tërësive të kërkesave të dyshimta dhe të diskutueshme të bankave në evidencë jashtëbilancore në masë të madhe u ndej në tremujorin e dytë të vitit 2016.

⁷ Me këtë masë u mundësua zvogëlimi i bazës për rezervat e detyrueshme të bankave për shumën e kredive të posamiratuara ndaj neto eksportuesve dhe të prodhuesve vendor të energjisë elektrike dhe të investimit të bankave në letrave me vlerë të borxhit në valutë vendore pa klauzolë në valutë të huaj të lëshuara nga kompanitë vendore neto eksportuesve dhe


Grafik 12
Struktura e aktivitet të bankave – kontributi në ndryshim vjetor p.p.




Burimi: BPRM.

Duke marrë parasysh zbatimin e strategjisë së kursit të këmbimit nominal të qëndrueshëm nominal të denarit ndaj euros, ndryshimet e normave të interesit në eurozonë, si ekonomia esperancë, kanë rol të rëndësishëm në aspekt të pozicionimit të politikës monetare në vend. Në vitin 2016, BQE edhe më tej liberalizon politikën monetare dhe e zvogëloi normën bazë të interesit nga 0.05% në 0.00%. nga ana tjetër, BPRM me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të kursit të këmbimit e rriti normën bazë të interesit (nga 3.25% në 4.00%). Si rezultat i këtyre ndryshimeve të politikave, shtrirja midis normave të interesit të bankave qendrore u zgjerua, nga 3.2 p.p. në 4.0 p.p.. Kah fundi i vitit, me zvogëlimin e normës së interesit të BPRM nga 4.00% në 3.75%, shtrirja e interesit në mënyrë të moderuar u ngushtua nga 4.0 p.p. në 3.75 p.p.. Në raport me normat e interesit të bankave në ekonominë vendore, ecuria e zvogëlimit në mënyrë të moderuar u ngadalësua, me çka shtrirja e interesit mes normave të interesit në denarë dhe normat e interesit në valutë të huaj kah fundi i vitit 2016 qe minimalisht më i lartë në raport me fundin e vitit paraprak, 1.5 p.p. kundrejt 1.4 p.p., si rezultat i nivelit më të ulët të normave të interesit të depozitave valutore.


Grafik 13
Kontributi në ndryshim vjetor të gjithsej kredive, në p.p.



Grafik 14
Normat e interesit të BPRM dhe BQE (në %) dhe shtrirja e interesit (në p.p.)



Normat e interesit të bankave (në %) dhe shtrirja e interesit (në p.p.)



* Norma bazë e interesit të BPRM – norma e interesit e bonove të thesarit të BPRM.
Norma bazë e interesit të BQE – norma e interesit të operacioneve bazike për rifinansim të BQE.
Burimi: BPRM dhe BQE.

prodhuese të energjisë elektrike. Masa që sjellur kah mbarimi i vitit 2012, ndërsa filloi të zbatohet nga viti 2013. Nga sjella e masave, zbatimi saj që vazhduar brenda dy rasteve, përkatësisht gjer në fund të vitit 2017.

II. Ambienti ndërkombëtar


Ambienti ekonomik global në vitin 2016 karakterizohet me pasiguri politike më të theksuar, aktivitet investiv të dobët dhe ngadalësim të mëtejshëm të rritjes së përgjithshme të tregtisë⁸. Rritja e ekonomisë globale në vitin 2016 shënoi 3.1%, që paraqet ngadalësim minimal në raport me vitin paraprak (3.2%), dhe njëherit edhe një rritje më e dobët që nga fillimi i krizës globale. Këto rritje i reflektojnë ndryshimet në rritjen e ekonomive të zhvilluara, ndërsa aktiviteti ekonomik te ekonomitë me rritje të përshpejtuar dhe vendet në zhvillim shënojnë dinamizëm të pandryshuar.

Në suaza të grupit të vendeve të zhvilluara, ngadalësimi ekonomik më të madh ka shënuar SHBA duke reflektuar aktivitet të dobët eksportues, në kushte të aprecimit të Dollarit Amerikan, zvogëlimi i stoqeve dhe aktiviteti i dobët investiv. Shikuar sipas dinamikës, një përshpejtim i caktuar i aktivitetit u vërejt kah fundi i vitit, në pritje të zgjedhjeve presidenciale në SHBA. Megjithatë rezultatet e zgjedhjeve në mënyrë plotësuses e rriti pasigurinë, jo vetëm në ekonominë amerikane, por edhe në zuaza globale, me atë edhe në eurozonë, si një nga partnerët kyç tregtarë i joni. Krahas njoftimeve të kryetarit të ri amerikan për rritje të mundshme në nivelit të proteksionizmit në tregtinë globale, tensionet gjeopolitike, ngadalësimi i tregtisë globale dhe gjithsesi vendimi i referendumit për dalje të Britanisë së Madhe nga Unioni Evropian⁹ paraqet faktor kyç të rrezikut për eurozonën në vitin 2016. Edhe krahas këtyre rreziqeve, eurozona edhe matej rritet, por në mënyrë të moderuar më ngadalë, në kushte të ruajtjes së përshtatshmërisë së politikës monetare të BQE. Rritja relative e lartë, edhe pse një normë rënëse e papunësisë dhe nivel relativ i ulët i investimeve edhe matej janë karakteristik për eurozonën tregojnë nevojën për rritje më të shpejtë dhe më të larmishme. Edhe pse janë të pranishëm rreziqet globale, problemet politike të brendshmen EU, si edhe nevoja për reforma më të fuqishme strukturore në eurozonë, e rrisin pasigurinë rreth rritjes ekonomike në periudhën e ardhshme. Grupi i vendeve me rritje të përshpejtuar me një rritëm të njëjtë si edhe gjatë vitit paraprak, por me zhvillime ekonomike divergjente në mes vendeve të veçanta. Çmimet relativisht të ulëta të një pjese të prodhimeve primare sollën gjer në ngadalësimin e rritjes të vendeve eksportuese të këtyre prodhimeve, ndërsa vendet importuese shënuan rritje relativisht të lartë që kryesisht rrodhi nga kërkesa e brendshme e solide dhe efektit pozitiv nga çmimet e ulëta të produkteve primare. Më pas edhe këtë vit vazhdoi rritja stabile e vendeve aziatike me rritje të përshpejtuar, ndërsa vendet e Amerikës Latine shënuan rritje negative.


⁸ "Global Economic Prospects", World Bank Group, Janar viti 2017.

⁹ Në referendumin i cili ishte mbajtur më 23 qershor të vitit 2016, shumica e votuesve u deklaruan për dalje të Britanisë së Madhe nga Unioni Evropian.


Grafik 15
Rritje ekonomike globale (%)



Grafik 16
Rritja e PBB te vendet e zhvilluara (në %)



Rritja vjetor e tregtisë globale (në %)




Burimi: Pasqyra ekonomike botërore, tetor viti 2016 dhe azhurnimi në janar të vitit 2016, FMN.

Inflacioni global në vitin 2016 shënoi një përshpejtim të vogël dhe shënonte 2.9% kundrejt 2.8% në vitin 2015. Kjo rritje minimale në masë më të madhe është si rezultat i rritjes së lehtë të çmimeve ushqimore. Rritje më të theksuar prej 0.4 p.p. shënoi inflacioni i grupit të vendeve të zhvilluara (prej 0.3% në vitin 2015 në 0.7% në vitin 2016). Rritje e këtillë e shpreh rikuperimin gradual të çmimeve të prodhimeve primare dhe në veçanti kah fundi i vitit edhe rritja e çmimeve të energjisë, kundrejt normave stabile dhe relativisht të ulëta të bazë të inflacionit. Në grupin e vendeve me rritje të shpejtuar, inflacioni ngadalësoi për 0.2 p.p. në raport me vitin 2015 dhe shënonte 4.5%. Këto zhvillime të çmimeve në një pjesë janë reflektim të aprecimit të valutës së vendeve eksportuese të naftës (kryesisht Rusia), që ka një efekt transferues në inflacionin e përgjithshëm.


Në raport me treguesit kuantitativ konkret që pasqyrojnë ambientin e jashtëm në ekonominë e Maqedonisë, kërkesa efektive e huaj në vitin 2016 shënoi rritje prej 2.0% me çka vazhdoi me rikuperimin e vet gradual. Kontribut më të lartë në realizimin e rritjes vjetore kishin ekonomitë e Gjermanisë, Bullgarisë dhe Serbisë, ndërsa vendet tjera kishin kontribut pozitiv të moderuar. Nga ana tjetër, në harmoni me zhvillimet globale, çmimet efektive të huaja në vitin 2016 ishin mesatarisht të pandryshueshme (inflacion prej 0%) kundrejt rënies mesatare prej 0.3% në vitin 2015. Shikuar në aspekt të vendeve të veçanta, kontribut më të lartë pozitiv kishin vendet si gjermania dhe Austria, ndërsa efekt më negativ ndaj inflacionit efektiv të huaj kishin zhvillimet e çmimeve të Bullgarisë dhe Serbisë.

Grafik 17
Kërkesa e huaj efektive



Burimi: Përlllogaritjet e BPRM¹⁰.

Grafik 18
Inflacioni i huaj efektiv




Te tregjet e prodhimeve primare në vitin 2016 vazhdoi trendi i zvogëlimit të çmimeve të energjisë dhe metaleve, ndërsa çmimet e prodhimeve ushqimore shënuan një rritje të lehtë. Shikuar vitin 2016 në tërësi, çmimi mesatar i naftës ishte më i ulët për 15.7% nga çmimi mesatar i vitit 2015, dhe kushtonte 44 dollar për barel. Megjithatë karakteristike për këtë vit ishin ndryshimet në zhvillimet e çmimeve të naftës (shprehur në euro) për gjatë vitit. Ashtu që pas rënies graduale vjetore në nëntë muajt e parë të vitit 2016, në tremujorin e fundit çmimi i naftës shënoi një rritje më të theksuar prej 17.2%. Këto zhvillime në masë më të madhe ishin rezultat i kontratës të arritur në mes vendeve anëtare të OPEK¹¹ për zvogëlimin e prodhimit të naftës dhe të indikacioneve për gatishmërinë e Rusisë (e cila nuk është anëtare e OPEK) të ju bashkohet masave duke zvogëluar prodhimin e vet të naftës. Çmimi i metaleve në vitin 2016 edhe më tej shënonte zvogëlim të lehtë, duke realizuar rënie vjetore prej 5%. Kjo rënie në masë më të madhe kishte të bëjë me çmimet e ulëta të metaleve në gjysmën e parë të vitit 2016, si pasojë e tepricës së ofertës dhe kërkesës së ulët. Në anën tjetër, në gjysmën e vitit 2016 çmimet e metaleve shënuan rritje, para së gjithash si pasojë e zvogëlimit të ofertës (mbylla e disa kapaciteteve prodhuese, në pjesë më të madhe në Kinë) dhe indikacionet për kërkesë të rritur nga ana e Kinës dhe SHBA-së, përshkak të planeve për investime më të mëdha në projekte infrastrukturore. Çmimi i produkteve ushqimore në vitin 2016 shënoi një rritje të lehtë prej 2.3%.

¹⁰ Kërkesa e huaj efektive llogaritet si shumë e indekseve të ponderuar të prodhimit të brendshëm bruto të partnerëve më të rëndësishëm tregtarë të Republikës së Maqedonisë. Në llogaritjen e indeksit janë të përfshira: Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Belgjika, Spanja, Serbia, Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria. Ponderet janë llogaritur në bazë të pjesëmarrjes së eksportit ndaj këtyre vendeve në eksportin e përgjithshëm. Inflacioni i huaj paraqet një shumë të ponderuar të indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve, partnerë më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë në sferën e importit të mallrave për konsumin e gjerë. Struktura e ponderuar bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili vend në importet e përgjithshme nominale në periudhën prej vitit 2010-2012. Në llogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë: Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia dhe Serbia.


¹¹ Kontrata ishte arritur më 30.11.2016 në Vjenë dhe parashikon zvogëlimin e prodhimit për 1.2 milionë barel në ditë, duke filluar nga 01.01.2017. Seanca plotësuese në mes vendeve të cilat janë ose jo të OPEK-ut që organizuar më 10 dhjetor, ku për së pari herë pas vitit 2001 që kontraktuar zvogëlimin e prodhimit të naftës edhe nga vendet jashtë OPEK e cila duhej të arrijë 558 mij barel, si plotësimi i shkurtimeve ndaj së cilëve u zotuan vendet e OPEK-ut. Kjo kontratë do zbatohet për gjatë gjashtë muajve të parë të vitit me mundësi vazhdimi edhe për gjatë muaj tjetër.

Grafik 19
Zhvillimi mujor i çmimeve të produkteve primare energjetike dhe joenergjetike (Euro, indeks: 2005=100)



Burimi: Baza e të dhënave të FMN për çmimet e produkteve primare.

Grafik 20
Zhvillimi mujor i çmimeve të naftës së papërpunuar, metaleve¹² dhe ushqimeve (Euro, indeks: 2005=100)



Në vitin 2016, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara zbatuan politika monetare divergjente. Në SHBA, në kushte të realizimeve solide të ekonomisë, FED vazhdoi me normalizimin e politikës monetare. Në dhjetor të vitit 2016, FED e rriti shënjestrimin e normës së interesit në tregun e parave për 0.25 p.p., përkatësisht nga 0.50%-0.75%. Kjo rritje ishte si pasojë e vlerësimeve të FED për përshpejtimin e rritjes ekonomike, si edhe presioneve inflacioniste të mundshme në të ardhmen. Nga ana tjetër, BQE vazhdoi me zbatimin e politikës monetare stimuluuese. Ashtu që në mars të vitit 2016, BQE ndërmori pako masash për lehtësimin shtesë të kushteve financiare në eurozonë. Në muajin mars, BQE i zvogëloi normat e interesit, përkatësisht normat e interesit të operacioneve themelore për rifinancim nga 0.05% në 0.00%, norma e interesit të depozitave nga -0.30% në -0.40% dhe normave të interesit për sigurim e kredive brenda ditës nga 0.30% në 0.25%, dhe njëherit ndërmori edhe masa shtesë¹³. Të gjitha këto masa qen ndërmarrë me qëllim të sigurohet përkrahje e mëtejme e rritjes dhe realizimit të inflacionit të synuar. Në kahe të njëjtë ishin edhe masat e ndërmarra nga Bankat e Anglisë dhe Bankat e Japonisë. Në gusht, Banka e Anglisë ndërmori masa të orientuara kah lehtësimi i mëtejme i politikës monetare, nëpërmjet zvogëlimit të normës bazë të interesit për 25 pikë bazike (në 0.25%), si edhe rritjen e vlerës së letrave me vlerë të cilat i riblenu banka qendrore. Këto masa ishin të ndërmarra me qëllim të përkrahjes së rritjes dhe realizimit të inflacionit të synuar. Banka e Japonisë, në seancën e janarit të vitit 2016, ndërmori masa shtesë për lehtësimin e politikës monetare, me qëllim arritjen e inflacionit të shënjestruar prej 2%.

¹² Indeksi i metaleve është indeks kompozit që përfshinë çmimet e bakrit, aluminit, xeheve të hekurit, fletëzave metalike, nikelit, zingut, plumbit dhe uranimit.


¹³ U soll vendimi për zbatimin e katër operacioneve afatgjata shtesë të shënjestruara për rifinancim (TLTRO II) me afat prej katër vitesh, suke filluar nga qershori i vitit 2016, me normë interesi të nivelit të normës së interesit të BQE. Më pas, për bankat që rrisin aktivitetin kreditor në vëllim më të madh nga shënjestrimi i vendosur, në vlerën e shënjestrimit do të zbatohet normë më e ulët e interesit por më së shumti gjer në nivelin e normës së interesit të depozitave. Krahas saj që rritur riblerja mujore e obligacioneve në suaza të programit për lehtësim kuantitativ (nga 60-80 miliardë eurosh) duke filluar nga prilli i vitit 2016, me kyçjen e riblerjes së letrave me vlerë të borxhit të korporatave jofinanciare nga eurozona me një rejting të përshtatshëm të investimeve. Megjithatë sipas seancës së rregullt të dhjetorit, BQE vendosi të zvogëloj sasinë e riblerjes e letrave me vlerë të siguruara në suaza të programit për lehtësim kuantitativ prej 80-60 miliardë euro në muaj. (duke filluar nga prilli i vitit 2017), por e vazhdoi afatin e kohëzgjatje nga gjashtë në nëntë muaj.

III. Lëvizjet makroekonomike në vitin 2016


3.1. PBB dhe inflacioni

Në vitin 2016 u shënuar zmadhim i pasigurisë makroekonomike, në kushte të rritjes së riskut që rezultonte nga lëvizjet politike në vend, me atë që ndikim të pavolitshëm patën edhe rreziqet që vinin nga jashtë. Edhe pranë rrethanave të tillë, ekonomia nacionale e Republikës së Maqedonisë edhe në vitin 2016 vazhdoi të rritet, me atë që u shënuar shkallë reale e rritjes prej 2.4% që është një shkallë më e ulët e rritjes në krahasim me vitin 2015. Struktura e rritjes mbetet e ngjashme me atë të vitit 2015, përkatësisht ndërtimtaria edhe më tej mbetet sektori me kontribut më të lartë pozitiv, duke reflektuar para së gjithash efektet nga ndërtimet e ulëta, të realizuara në suaza të një pjesë të projekteve infrastrukturore me financim publik. Edhe pranë rritjes së rreziqeve në ambientin e jashtëm, edhe këtë vit, sektori eksportues mbeti forcë kyç lëvizëse e rritjes, që mundet para së gjithash ti përshkruhet funksionimit të kapaciteteve të reja prodhuese të orientuara drejt eksportit, si dhe zmadhimit të kërkesës nga jashtë. Gjatë vitit, aktiviteti vendor ekonomik pati shtytje të veçantë edhe nga zhvendosjet e volitshme në tregun e punës dhe në lëmin e produktivitetit.

Grafiku 21
PBB dhe kërkesa efektive e jashtme
(shkalla vjetore e ndryshimit real, në %)



Grafiku 22
PBB (rritje reale, në %) dhe komponentët shpenzues të PBB (kontribut në rritej, në p.p.)




Burimi: Enti Shtetërorë Statistikorë dhe Eurostat, përlogaritje të BPRM, Janë shfrytëzuar të dhëna paraprake të PBB për vitin 2015 ndërsa për vitin 2016 janë shfrytëzuar të dhëna të vlerësuara

Në vitin 2016, pjesa më e madhe e veprimtarive patën ndikim pozitiv në rritjen ekonomike. Në rastin konkret, siç edhe në vitin 2015, ndikim më të madh individual në rritjen e realizuar ka ndërtimtaria, duke reflektuar para së gjithash efektet nga ndërtimet e ulëta, të realizuara në suaza të një pjesë të projekteve infrastrukturore me financim publik. Lëvizje të volitshme janë shënuar edhe në sektorin e tregtisë¹⁴, ku sipas të dhënave për qarkullimin e përgjithshëm, rritja kryesisht sqarohet përmes zmadhimit të qarkullimit në tregtinë në sasi të vogla, ndërsa rritje e qarkullimit është shënuar edhe te tregtia grosiste. Kur bëhet fjalë për veprimtaritë tjera, një stimul shtesë pozitiv në rritjen e ekonomisë vendore ka dhënë edhe bujqësia si dhe veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike. Kur bëhet fjalë për industrinë, si sektor me ndikim të konsiderueshëm në krijimin e PBB dhe hapjen e vendeve të reja të punës, në vitin 2016 është shënuar një rënie e vogël e vlerës së shtuar, , edhe pranë faktit se gjatë vitit 2016 është shënuar një rritje e konsiderueshme e madhësisë fizike të prodhimit industriale.

¹⁴ Analiza e lëvizjeve në tregti është bërë në bazë të dhënave për qarkullim në tregti.(ESHS).


Grafiku 221
Kontribut në rritjen vjetore të PBB
(në pikë përqindjeje)



Burimi: Enti Shtetërorë Statistikorë dhe kalkulime të BPRM.

Janë shfrytëzuar të dhëna paraprake të PBB për vitin 2015 ndërsa për vitin 2016 janë shfrytëzuar të dhëna të estimuara.

Grafiku 222
PBB, industria dhe shfrytëzimi i kapaciteteve




Shikuar nga aspekti i kërkesës agregate, rritja e ekonomisë vendore në vitin 2016 i përshkruhet eksportit dhe rritjes së kërkesës vendore. Shikuar sipas komponentëve të ndryshëm të shpenzimeve, aktiviteti i lartë eksportues, ngjashëm si në vitin 2015, është një shtytës kyç i rritjes dhe njëherit ka kontributin më të lartë pozitiv. Krahas kësaj, të arriturat pozitive në sektorin eksportues, për vite me radhë ndërlidhen me funksionimin e kapaciteteve të reja prodhuese të orientuara drejt eksportit. Rritja e kërkesës vendore rezultoi kryesisht nga rritja e konsumit personal, si rezultat i lëvizjeve të volitshme në tregun e punës, rritja e pagave reale dhe pensioneve, si dhe kreditimi solid i popullsisë, me atë që ndikim shtesë pozitiv kishte edhe konsumi publik. Nga ana tjetër është shënuar rënie e investimeve bruto, edhe pranë zhvendosjeve pozitive të gati të gjithë treguesit me frekuencë më të lartë mbi investimet të cilat shënojnë rritje gjatë vitit 2016. Rritja e kërkesës vendore dhe eksportit rezultoi edhe me rritje të importit të mallrave dhe shërbimeve. Megjithatë, eksporti neto, ndikimi negativ i të cilit shënoi rënie negative për dy vite radhazi, në vitin 2016 pati ndikim pozitiv në rritjen e shënuar.

Në vitin 2016, për të tretin vit në radhë, inflacioni në Republikën e Maqedonisë qëndroi në zonën negative, që në mungesë të presioneve më të konsiderueshme nga ana e kërkesës, reflekton ambientin global të çmimeve përgjithësisht të ulura importuese të ushqimit dhe energjisë¹⁵. Krahas kësaj, gjatë tërë vitit 2016, niveli i përgjithshëm i çmimeve shënoi rënie vjetore prej 0.2% që paraqet ngadalësim minimal të rënies së nivelit të çmimeve në krahasim me dy vitet paraprake (rënie mesatare e nivelit të përgjithshëm të çmimeve prej 0.3%). Analiza sipas dinamikës tregon se çmimet e konsumit gjatë tërë vitit, qëndruan në zonën negative duke shënuar një rënie më të konsiderueshme në tremujorin e dytë, me atë që faktor kryesor në thellimin e rënies ishte ulja e çmimeve vendore të ushqimit. Në gjysmën e dytë të vitit u shënuar edhe rënie e matur e çmimeve, që korespondon edhe me ndryshimin e dinamikës së çmimeve botërore të produkteve primare, para së gjithash çmimit të naftës i cili kah fundi i vitit filloi të rritet¹⁶.

¹⁵ Inflacioni i huaj efektiv në vitin 2016 ishte 0%.


¹⁶ Inflacioni gjatë vitit 2016 ndoqi dinamikën në vijim: tremujori i parë -0.1%, tremujori i dytë -0.7%, tremujori i tretë -0.1% dhe tremujori i katërt -0.1%.

Grafiku 25
Inflacioni vendor dhe inflacioni i huaj efektiv,
shkallë vjetore të rritjes
(në %)



Burim: ESSH, Eurostat dhe përlogaritje të BPRM.

Grafiku 23
Komponenti i ndryshueshëm (ushqim dhe
energji) dhe afatgjatë i inflacionit
(kontribute vjetore, në pikë përqindjeje)



Analiza e komponentëve kyç të indeksit nxjerr në pah se zvogëlimi i çmimeve të konsumit mundet ti përshkruhet zhvendosjeve në komponentit e ushqimit dhe atë të energjisë. Kështu, gjatë vitit 2016, çmimet e produkteve ushqimore rranë për 1.4% (duke kontribuar me -0.5% në normën e përgjithshme të inflacionit). Zvogëlimi i tillë te produktet ushqimore para së gjithash rezulton nga rënie e çmimeve të perimeve, pemëve, mishit dhe produkteve të drithërave gjatë vitit. Çmimet e energjisë u zvogëluan për 2.7% (duke kontribuar me -0.4% në normën e përgjithshme të inflacionit), si rezultat i rënies së çmimeve të naftës në tregun vendor në kushte të rënies mesatare vjetore të çmimit të naftës në bursat botërore. Nga ana tjetër, gjatë tërë kohëzgjatjes së vitit inflacioni bazë qëndroi në vlera pozitive dhe ishte rreth 1.4% (duke kontribuar me 0.7 pikë përqindjeje në normën e përgjithshme të inflacionit, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të duhanit¹⁷ dhe të produkteve për mirëmbajtje të amvisërive.

3.2. Tregu i punës

Në vitin 2016, pjesa me e madhe e treguesve të tregut të punës vazhdojnë të zhvillohen në mënyrë të volitshme.¹⁸ Realizimet e mira në këtë segment të ekonomisë koincidojnë me realizimet solide në sektorin real, ndërsa përkrahje shtesë ndaj rritjes së punësimit, ngjashëm si në vitin paraprak, u sigurua edhe përmes masave aktive për punësim.¹⁹ Kështu numri i personave të punësuar në vitin 2016 u zmadhua për 2.5% që nënkupton një intensifikim të matur të rritjes në krahasim me vitin paraprak. Njëkohësisht, norma e punësimit u rrit për 1 p.p. duke arritur në nivelin 43.1%. Shikuar sipas sektorëve, siç edhe në vitin 2015, zmadhimi i punësimit në masë më të madhe mundet ti përshkruhet sektorit të shërbimeve, në suaza të së cilit rritje konsiderueshme e punësimit është shënuar


¹⁷ Rritja vjetore e çmimeve të duhanit në vitin 2016 rezulton nga një kombinim i rritjes së akcizës nga korriku i vitit 2015, rritjes së ekuivalentuar të çmimeve të cigareve për pesë denarë për kuti në mars të vitit 2016 si dhe rritjes së çmimit të një marke të cigareve në qershor të vitit 2016. Në korrik të vitit 2016 në mënyrë shtesë u rit akciza e cigareve, megjithatë ndryshimet e çmimeve nuk janë afektuar nga ky korrigjim çmimor.

¹⁸ Analiza e tregut të punës është realizuar përmes shfrytëzimit të anketave tremujore të fuqisë punëtore, përkatësisht treguesit vjetorë për vitin 2016 janë nxjerrë në formë të mesatares së të dhënave të publikuara tremujore.

¹⁹ Edhe gjatë vitit 2016, Qeveria e Republikës së Maqedonisë përmes Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe Agjencinë për punësim, vazhdoi me implementimin e programeve dhe masave aktive për të stimuluar shkallën e punësimit të tilla si programi për vetëpunësim i cili u zgjeruar që të përfshijë edhe personat e moshës deri 29 vjeçare, ofrim i përkrahjes financiare për ndërmarrje mikro dhe të vogla dhe zejtarë për të hapur vende të reja pune, programe për subvencionim të punësimeve të reja, programe për përgatitje për punësim etj.


te tregtia. Krahas kësaj, ndikim solid pozitiv kanë dhënë edhe veprimtaritë "sigurim shëndetësorë dhe social", "drejtori publike, mbrojtje dhe sigurim social" si dhe sektori "veprimtari administrative dhe veprimtari ndihmëse shërbyese". Rritja e punësimit në sektorin e industrisë vazhdoi edhe në vitin 2016 (me një dinamikë më të vogël), duke reflektuar kryesisht zhvendosjet pozitive në ndërtimtari. Nga ana tjetër, trendit i rënies së numrit të punësuarve në bujqësi, ngjashëm si në vitin 2015, vazhdoi edhe në vitin 2016.

Grafiku 24
Disa tregues të tregut të punës
(ndryshime vjetore, në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM

Grafiku 25
Shkalla e papunësisë në %, sipas grup moshave
(në %)




Krahas rritjes së kërkesës për fuqi punëtore, gjatë vitit u shënuar një përshtatje e vogël rënëse edhe në ofertën e fuqisë punëtore. Në fakt, popullsia e përgjithshme aktive shënoi zvogëlim prej 0.7%, që në kushte të rritjes paralele të numrit të popullsisë aktive për 1.2%, rezultoi me zhvendosje rënëse të normës së aktivitetit (për 0.4 p.p.), duke shënuar kështu rënie të saj në 56.5%. Tejkalimi i ofertës së fuqisë punëtore nga ana e kërkesës për fuqi punëtore rezultoi me ulje të papunësisë, në ç'rast norma e papunësisë mesatare ra në 23.7% (përkatësisht shënoi rënie prej 2.3 p.p.). Në rastin konkret shikuar sipas grup moshave, rënia e normës së përgjithshme të papunësisë i përshkruhet para së gjithash rënies së papunësisë te popullsia madhore (persona në mes 25 dhe 49 vite si dhe persona në moshë 50-64 vjeçare), më atë që norma e papunësisë te popullsia më e re (persona të moshës 15-24 vjeçare) shënon rritje. Zhvendosjet strukturore të kësaj natyre, tregojnë rënie potenciale të papunësisë afatgjatë, duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e personave të papunësuar në këtë kategori i takojnë kategorisë së papunësisë afatgjatë.

Edhe në vitin 2016 vazhdoi trendi i rritjes së pagës mesatare neto, ndonëse me intensitet më të ulët në krahasim me vitin paraprak. Kështu, pagat nominale neto dhe bruto²⁰ shënuan rritje vjetore prej 2% (kundrejt 2.4% respektivisht 2.7% në vitin 2015). Korigjim rritës i pagave neto është shënuar te gati të gjithë sektorët e veprimtarive²¹, me atë që shkallë veçanërisht të larta të rritjes kanë shënuar bujqësia (6.7%), ndërtimtaria (9.8%) si dhe veprimtari "shërbime administrative dhe shërbime ndihmëse" (7.9%). Krahas kësaj, për të tretin vit në radhë është shënuar edhe rritje reale e pagave. Në rastin konkret, në kushte të përshtatjes rënëse të nivelit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit, pagat neto dhe bruto shënuan rritje reale prej rreth 2.3%.

²⁰ Bruto paga e përgjithshme e paguar përfshin: neto pagat e paguara për muajin përkatës, tatim personal i paguar dhe kontribute të paguara (për sigurim pensional dhe invalidor, për sigurim shëndetësorë, për punësim, për sëmundje profesionale dhe për ekonominë e ujërave). Të dhënat e mësipërme kanë të bëjnë me pagat e paguara.


²¹ Paga më të ulëta janë paguar te: "veprimtaritë që kanë të bëjnë me patundshmëritë", "veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike shërbyese", "veprimtari financiare dhe veprimtari të sigurimeve", si dhe te veprimtaria "veprimtari të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale".

Grafiku 26
Bruto dhe neto paga vjetore mesatare
(ndryshime vjetore, në %)




Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM.

Grafiku 27
Neto paga mesatare sipas sektorëve
(Ndryshime vjetore, në %)




Në vitin 2016 vazhduan trendet pozitive te produktiviteti i punës²², i cili shënoi rritje prej 1.3%. Megjithatë, në kushte të ngadalësimit të rritjes së aktivitetit ekonomik, rritja e matur e produktivitetit të punës është më e ulët në krahasim me vitin 2015. Shikuar sipas sektorëve, kontribut më të madh në rritjen e shënuar ka pasur sektori i ndërtimtarisë, sektor ky në të cilin gjithashtu është shënuar edhe rritja më e madhe e vlerës së shtuar në kushte të zhvendosjeve më modeste në normën e punësimit, Kostot e punës për njësi produkti, edhe në vitin 2016 kanë shënuar rritje të matur (1.8%), në kushte të shënimit të zmadhimit të kostove në sektorin shërbyes, përderisa te bujqësia dhe industria kostot e punës për njësi produkti shënojnë rënie.

Grafiku 28
Produktiviteti i punës
(kontribut në rritjen vjetore, në p.p.)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM.

Grafiku 29
Kostoja e punës për njësi produkti
(kontribut në rritjen vjetore, në p.p.)



²² Produktiviteti dhe kostot e punës për njësi produkti në nivel të ekonomisë nacionale janë kalkular në bazë të dhënave për PBB, numrin e përgjithshëm të punësuarve, Anketës për fuqinë punëtore të Enti Statistikorë të Republikës së Maqedonisë si dhe të dhënave për bruto-pagat mesatare. Produktiviteti i përgjithshëm përllogaritet si shumë e ponderuar e produktivitetit të kalkular në nivel të sektorëve individual. Në suaza të sektorëve individual produktiviteti përllogaritet si raport në mes vlerës së shtuar në sektorin përkatës dhe numrit të punësuarve.

3.3. Financa publike

Procesi i konsolidimit fiskal, i filluar para një viti, vazhdoi edhe gjatë vitit 2016. Deficiti buxhetor që u realizua në vitin 2016 arriti në 2.6% të PBB, kundrejt 3.5% të PBB në vitin 2015. Niveli i realizuar i deficitit është më i ulët krahasuar me vlerësimet fillestare në relacion me buxhetin vjetor, por edhe në relacion me deficitin e paraparë më dy rebalancët e buxhetit të miratuara gjatë vitit.²³ Me rebalancin e parë të realizuar në korrik deficiti u zmadhua në 3.6% të PBB²⁴, kundrejt deficitit fillimisht të projektuar prej 3.2%. Në rrethana ta pasigurisë politike dhe aktivitetit të ngadalësuar ekonomik, u shënua edhe korrigjim teposhtë i të ardhurave buxhetore, me atë që një korrigjim i matur teposhtë është shënuar edhe në anën e të dalurave. Pas një periudhe të shkurtë kohore, përkatësisht në muajin gusht, u miratua edhe bilanci i dytë i dedikuar me të cilin u bë zmadhimi i të dalurave buxhetore me qëllim të kompensimit të dëmeve në regjionet e përmytura²⁵, që rezultoi me zgjerim të mëtejshëm të deficitit buxhetor në 4% të PBB. Megjithatë, deri në fund të vitit, pjesa më e madhe e obligimeve për kompensim të dëmeve të kësaj natyre nuk u realizuan, që në kombinim me realizimin më të ulët të kategoritë tjera të dalurave buxhetore (në pjesën më të madhe të dalurat për investime kapitale) rezultoi me realizimin e një deficitit më të ulët buxhetor për vitin 2016.

Ndryshimet të deficitit buxhetor primar²⁶ dhe të deficitit rrjedhës²⁷ janë të ngjashme me zhvendosjet e shënuara në deficitin e përgjithshëm. Kështu, deficiti primar buxhetor në fund të vitit 2016 ishte 1.5% të PBB dhe është më i ulët në krahasim me vitin paraprak (2.3% të PBB), përderisa deficiti buxhetor rrjedhës ra në 0.8% të PBB, kundrejt 1.5% të PBB në vitin paraprak. Zhvendosjet e tilla kryesisht rrjedhojnë nga realizimet më të ulëta të të dalurat buxhetor, që rrjedhojnë kryesisht nga kategoria "mallra dhe shërbime".

Bilanci buxhetor i korrigjuar ciklik në vitin 2016 vazhdon të ngushtohet, duke demonstruar konsolidimin e financave publike nëpërmjet ndryshimeve në përbërësin diskrecional të politikës fiskale. Kështu, impulsi fiskal²⁸ në vitin 2016 është negativ, me një deficit më të ulët strukturor²⁹ prej 3.8% të PBB-së, në krahasim me 4.7% të PBB-së në vitin 2015. Lëvizje të ngjashme janë karakteristike si për impulsin primar fiskal ashtu edhe për deficitin strukturor primar. Impuls fiskal negativ është i pranishëm për të dytin vit radhazi në kushte të përmirësimit të hendekut të prodhimit. Tregues të tillë tregojnë një karakter anticiklik të politikës fiskale dhe gjatë vitit 2016.

²³ Në Qershor të vitit 2016 Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Rebalancin e parë të buxhetit për vitin 2016, ndërsa në Gusht të vitit 2016 Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi Rebalancin e dytë të buxhetit për vitin 2016

²⁴ Në suaza të analizës së deficitit të planifikuar buxhetor, për PBB nominal për vitin 2016 janë shfrytëzuar projeksionet e Ministrisë për Financa të Republikës së Maqedonisë.

²⁵ Përmes rebalancit të buxhetit të muajit Gusht u siguruan 36.4 milionë euro shtesë për kompensim të plotë të dëmtuarve në përmytjet e 6. Gushtit të vitit 2016.


²⁶ Saldoja primare buxhetore paraqet dallim në mes të ardhurave të përgjithshme buxhetore dhe të dalurave të përgjithshme buxhetore, të zvogëluara për nivelin e pagesës së obligimeve rrjedhëse në bazë të borxheve të marra (norma të interesit). Ky tregues fiskal konsiderohet të jetë më adekuat gjatë analizës së kursit aktual të politikës, meqë ai integron shpenzimet fiskale që rrjedhojnë nga menaxhimi i kaluar i politikës fiskale në pjesën e borxhit publik.

²⁷ Saldoja rrjedhëse buxhetore paraqet dallimin në mes të ardhurave rrjedhëse (të ardhura nga kontribute tatimore si dhe të ardhura jotatimore) dhe të dalat rrjedhëse buxhetore (për paga dhe kontribute, për mallra dhe shërbime, transfere dhe norma të interesit).

²⁸ Impulsi fiskal definohet si dallim në mes saldosh së përshtatur ciklike në vitin paraprak dhe atë vijues.

²⁹ Deficiti i përgjithshëm strukturor fitohet po qese nga deficiti faktik buxhetor largohet komponenta ciklike buxhetore. Ai kalkulohet si dallim në mes të ardhurave të përgjithshme buxhetore të përshtatura sipas efektit të dallimit në mes PBB potencial dhe faktit me koeficient të elasticitetit 1 dhe të dalurat reale buxhetore të përshtatura sipas efektit të dallimit në mes PBB potencial dhe faktit me koeficient të elasticitetit 0. Deficiti primar strukturor kalkulohet ashtu që nga deficiti i përgjithshëm strukturorë minusohet efekti i kostove për norma të interesit.

Grafiku 30
Treguesit fiskal




Burimi: Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë dhe kalkulime të BPRM.

Burimi kryesor i financimit të deficitit buxhetor në vitin 2016 ishte huamarrja neto e qeverisë në tregun e kapitaleve të huaja, ndërkohë që një pjesë më e vogël e nevojave për financim u siguruan nga burimet e brendshme nëpërmjet imitimit neto të letrave me vlerë nga ana e qeverisë. Megjithatë, nëse performanca analizohet gjatë vitit, përfitohet një pasqyrë e ndryshme mbi strukturën e burimeve të financimit. Kështu, deficitin buxhetor i realizuar në gjysmën e parë të vitit 2016 u financua kryesisht përmes përdorimit të depozitave të qeverisë te BPRM, ndërsa fondet e siguruar nga tregu financiar vendas dhe të huaj mbuluan vetëm një pjesë të vogël të nevojave të financimit në këtë periudhë. Nga ana tjetër, në gjysmën e dytë të vitit, huamarrja e jashtme ishte burimi kryesor për financimin e deficitit buxhetor, me më pak mobilizim të fondeve në tregun financiar vendas. Në fakt, me qëllim të sigurimit të fondeve për përmbulimin e nevojave për financim në vitin 2016 dhe 2017, në korrik të vitit 2016, shteti lëshoi një eurobond të ri³⁰. Në kushte të rritjes së huamarrjes së jashtme neto dhe emetimit të moderuar neto të letrave me vlerë të qeverisë në tregun e brendshëm, gjatë vitit 2016, u regjistrua një rritje e ndjeshme e mjeteve shtetërore në BPRM. . Sa i përket aktivitetit të shtetit në tregun primar të letrave me vlerë, totali i vlerës bruto të letrave me vlerë të emetuara nga ana e shtetit në vitin 2016 arriti në 10.3% të PBB, që paraqet një rritje të participimit prej 1 p.p. të PBB në krahasim me vitin paraprak. Në rastin konkret, rritja e shënuar gati tërësisht rrjedhë nga zmadhimi i sumës së letrave me vlerë të emituara nga ana e shtetit. Ndryshimet e tilla të struktura e maturimit të letrave shtetërore me vlerë e konfirmojnë zmadhimin e interesit të pjesëmarrësve në treg (kryesisht të bankave) për investim në letra shtetërore me vlerë, në afate më të shkurta. Gjatë vitit 2016,


³⁰ Eurobondi i publikuar ishte me vlerë nominale prej 450 milionë euro me afat të maturimit prej 7 vite dhe normë vjetore të interesi prej 5.625%.

normat e interesit te obligacionet shtetërore shënuan rritje të matur, në ç'rast norma mesatare e ponderuar e interesit të letrave shtetërore me vlerë shënoi rritje prej 0.7 p.p. respektivisht për 0.3 p.p. te bonot shtetërore duke arritur në 2.5% dhe 3.7% për obligacionet dhe bonot shtetërore, përkatësisht.

Grafiku 31
Struktura e financimit të saldos buxhetore (në milionë denarë)



Grafiku 32
Letra shtetërore me vlerë në tregun primar (përqindje e PBB)



Burimi: Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë dhe kalkulime të BPRM.

Në vitin 2016, totali i borxhit të pushtetit qendrorë³¹ ishte 3.851,5 milionë euro, përkatësisht ka shënuar rritje prej 11.5% në krahasim me vitin paraprak. Rritja vjetore e totalit të borxhit rezulton kryesisht nga huazimi i shtetit jashtë vendit (për 16.7%), si rezultat i eurobondit të ri³², në kushte të zmadhimit paralel të borxhit të brendshëm (për 3.6%). Në rrethana të tilla, pjesëmarrja e borxhit të qeverisë qendrore në PBB shënoi rritje prej 0.9 p.p. duke arritur në 39.1% të PBB. Paralelisht me rritjen e borxhit të pushtetit qendrorë, në vitin 2016 është shënuar edhe zmadhim i totalit të borxhit publik³³ prej 11.5% në bazë vjetore, duke arritur kështu në fund të vitit vlerën prej 4711.4 milionë euro. Me këtë, totali i borxhit publik ka rritur në 47.8% të PBB dhe është për 1.1 p.p. më i lartë në krahasim me vitin paraprak. Rritja e mëtejme e totalit të borxhit publik, në masë më të madhe mundet ti përshkruhet zmadhimit të borxhit shtetërorë³⁴ (para së gjithash përmes rritjes së borxhit të jashtëm të pushtetit qendrorë), ndërsa në masë më të vogël edhe borxhit të garantuar të ndërmarrjeve publike dhe të shoqërive aksionare në pronësi shtetërore. Edhe pranë rritjes nominale të borxhit të garantuar, në vitin 2016, është shënuar stabilizim i pjesëmarrjes së tij në totalin e borxhit publik (pjesëmarrje prej 18.3% në vitin 2015 dhe në vitin 2016), kundrejt zmadhimit të vazhdueshëm gjatë tre viteve paraprake si rezultat i intensifikimit të huazimit për projekte infrastrukturore. Shikuar sipas strukturës rezidente të borxhit publik, në vitin 2016 janë shënuar lëvizje divergjente të të dy komponentët kyç të borxhit të përgjithshëm publik. Në fakt, pjesëmarrja e borxhit të jashtëm në PBB shënoi rritje prej 1.9 p.p. në krahasim me vitin 2015 dhe arriti në 33.3% të PBB, ndërsa pjesëmarrja e borxhit të brendshëm shënoi ulje prej 0.8 p.p. duke rënë në 14.5% të PBB.

³¹ Kat ë bëjë me borxhin e pushtetit qendrorë duke përfshirë këtu fondet publike, por duke përjashtuar komunat.


³² Edhe pranë pagesës së rregullt të obligimeve në bazë të huazimit afatgjatë financiar nga "Citibank" në vlerë prej 132.7 milionë euro, përsëri në bazë neto borxhi i jashtëm shtetërorë shënoi rritje.

³³ Borxhi publik është i definuar me ligjin për borxhin publik („Gazeta zyrtare e RM“ nr. 165/14), sipas së cilit ai paraqet shumën e borxhit shtetërorë dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga ana e shtetit ose komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, si dhe ndërmarrjet tregtare të cilat shteti ose komunat, komunat në qytetin e Shkupit ose qyteti i Shkupit paraqiten si pronar kryesor ose i vetëm, e për të cilat shteti ka dhënë garancinë shtetërore.

³⁴ Borxhi shtetërorë përfshin shumën e borxheve të qeverisë qendrore dhe pushteteve lokale.

Grafiku 33

Stoku i borxhit të pushtetit qendrorë dhe borxhi i përgjithshëm publik




Burimi: Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë dhe kalkulime të BPRM.

3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm

Në vitin 2016, deficitin i llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave mbeti në një nivel të moderuar, duke mos sinjalizuar disbalanc më të shprehur në sektorin e jashtëm. Në bazë vjetore, bilanci negativ në llogarinë rrjedhëse ka shënuar një rritje prej 1 pikë përqindjeje dhe arriti në 3.1% të PBB-së. Kjo rezultoi nga thellimi i deficitit të ardhurave primare, që korespondo me vlerësimet për rritje të ardhurave nga investimet në kompanitë në pronësi të huaj, si dhe zvogëlimin e bilancit pozitiv të ardhurave dytësore, duke reflektuar kështu pjesërisht efektet e pasigurisë së ambientit politik mbi pritjet e subjekteve vendore. Lëvizjet më të pavolitshme të ardhurave primare dhe dytësore u zbutën përmes përmirësimit në saldon e këmbimit të mallrave dhe shërbimeve me jashtë. Ky përmirësim rrjedh nga ndikimi i më shumë faktorëve, në mesin e të cilëve veçohen zmadhimi i neto-eksportit të kapaciteteve të reja industriale, zvogëlimi i saldove negative energjetike, zmadhimi i të ardhurave neto të më shumë kategori të shërbimeve dhe mungesa e presioneve më të mëdha mbi importin nga kërkesa vendore. Llogaria financiare e bilancit të pagesave shënoi neto të ardhura më të konsiderueshme prej 6.5% të PBB, në masë të madhe për shkak të huazimit të shtetit në tregjet financiare ndërkombëtare, për shkak të publikimit të eurobondit të pestë.³⁵ Burim të konsiderueshëm të ardhurave neto në llogarinë vjetore paraqisnin edhe investimet e drejtpërdrejta të cilat shënuan rritje prej 1.4 p.p. të PBB në krahasim me vitin paraprak dhe arritën në 3.6% të PBB. Rrjedhat e tilla financiare u dëshmuar të mjaftueshme për mbulim të deficitit në llogarinë vjetore si dhe për zmadhim shtesë të rezervave devizore.


³⁵ Gjatë muajit korrik të vitit 2016 shteti mori hua nga tregjet ndërkombëtare përmes publikimit të eurobondit të pestë në vlerë prej 450 milionë euro, me normë interesi prej 5.625% dhe afat të maturimit prej 7 vite.

Grafiku 34
Llogaria vjetore, kapitale dhe financiare
(në milionë euro)




Burimi: BPRM.

Grafiku 35
Participimi i komponentëve të veçanta në
ndryshimin vjetor të llogarisë rrjedhëse (në pikë
përqindje të PBB)




Analiza e tregtisë së jashtme tregon një rritje solide të dy komponentëve, me një rritje mesatarisht më të fortë në eksportet krahasuar me rritjen e importit të mallrave. Në vitin 2016, nxitësi i arritjeve pozitive në eksport ishte aktiviteti i eksportit të kapaciteteve të reja industriale në pronësi të huaj, kryesisht të shprehura nëpërmjet rritjes së lartë të eksporteve të makinerive dhe pajisjeve të transportit, d.m.th. Eksportit investues. Nga ana tjetër, në degët tradicionale të eksportit, veçanërisht në industrinë e përpunimit të metaleve, në vitin 2016, ka një rënie në aktivitetin e eksportit. Arritjet në eksporte u reflektuan në anën e importeve, kështu që komponentë e lëndëve të para për kapacitetet e reja të huaja ishte faktori kryesorë në rritjen e importit. Kontribut shtesë të zmadhimit e importit ka dhënë edhe importi investues, si dhe importi i mallrave për shfrytëzim personal. Nga ana tjetër, u shënuar zvogëlim i importit energjetik, kryesisht për shkak të importit të zvogëluar të derivateve të naftës, shkaktuar nga rënia e çmimeve të naftës në bursat botërore.

Grafiku 36
Kontribut në ndryshimin vjetor të eksportit
(në p.p.)




Burimi: BPRM.

Grafiku 37
Kontribut në ndryshimin vjetor të importit
(në p.p.)




Analiza e treguesve të konkurrencshmërisë së çmimeve të ekonomisë nacionale të Republikës së Maqedonisë³⁶ tregon një përkeqësim të matur në krahasim me vitin paraprak. Kursi real efektiv i këmbimit i përlogaritur sipas kostove të jetës shënoi aprecim prej 1.2%, ndërsa KKEN i deflacionuar me çmimet e prodhuesve të produkteve industrial shënoi aprecim prej 3.5%. Ndryshimet e tilla vjetore në masë më të madhe rezultojnë nga ndryshimi kursit efektiv devizor në krahasim me valutat e disa nga partnerëve kryesor tregtar, në kushte të lëvizjeve të volitshme të çmimeve relative në bazë të KREK të deflacionuar me kostot e jetës, ndërsa çmimet relative të prodhuesve industrial kishin kontribut shtesë mbi aprecimin e KREK. Kostot e punës për njësi produkti, si tregues afatgjatë i konkurrencshmërisë, në vitin 2016 shënuan rritje të matur prej 1.8% që në kushte të zmadhimit të produktivitetit, rrjedhon nga rritja e pagave.

Grafiku 38
KKEN и KREK, (Kalkuluar sipas indeksit të shpenzimeve për jetesë dhe çmimeve të prodhuesve, 2010=100)



Grafiku 39
Çmime relative (2010=100)



Burimi: BPRM.

Pas rënies së shënuar në vitin paraprak, në vitin 2016 suficiti i këmbimit tregtar të shërbimeve u rrit me 0.3 p.p. të PBB-së dhe kontribuoi në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Rritja vjen nga rritja e hyrjeve neto në kategorinë "shërbime të tjera të biznesit"³⁷ dhe në shërbimet e telekomunikacionit, kompjuterëve dhe informacionit, me një bilanc pozitiv të reduktuar të shërbimeve të prodhimit për finalizimin. Në vitin 2016, deficitin në të ardhurat primare regjistroi një përkeqësim domethënës, d.m.th. u zgjerua me 1.1 pikë përqindjeje. e PBB-së. Ky ndryshim është kryesisht pasojë e ndërrimeve në të ardhurat nga investimet, duke reflektuar fitimet e parashikuara më të larta të kompanive me kapital të huaj në vitin 2016 krahasuar me një vit më parë³⁸. Rënia e peshës relative të flukseve hyrëse neto nga të ardhurat dytësore vazhdoi në vitin 2016, kur pjesa e këtij komponenti në PBB shënoi rënie prej 1.5 pikë përqindjeje. Në kushtet e transferimeve më të larta të shtetit, suficiti më i ulët në këtë kategori është shënuar për shkak të reduktimit të hyrjeve neto nga transferimet private, pjesërisht si pasojë e efekteve negative të krizës politike në vend. Lëvizjet e pafavorshme ishin veçanërisht të dukshme në tremujorin e dytë të vitit, për shkak të spekulimeve të forta rreth stabilitetit të denarit edhe në sistemin bankar vendor u shënu

³⁶ Analiza e treguesve për kompetivitetin çmimor është e bazuar në indekset e RKEK, të kalkuluara me ponder të bazuar në këmbimin me jashtë pa produkte primare. Produktet primare që mbeten të papërfshira në përlogaritje janë: nafta dhe derivatet e naftës, çeliku dhe hekuri, mineralet dhe lëndët e para të importuara për kapacitetet e reja prodhuese në zonat e lira ekonomike.

³⁷ Ndryshimi vjetor pozitiv, në saldot të kategorisë "shërbime afariste tjera" pasoi pas realizimit të daljeve të theksuara për gjatë vitit 2015.

³⁸ Fitimi i reinvestuar për vitin rrjedhës përlogaritet në bazë të rezultateve të raportit tremujor për rezultatin e planifikuar dhe realizuar financiar për vitin rrjedhës.

zmadhim i interesit të popullsisë për të disponuar me para të gatshme në deviza. Edhe pranë faktit se që nga muaji Qershor situata u stabilizua, përsëri goditja e tilla kontruboi në rënie të blerjes së efektivës në tregun e këmbimit dhe për pasojë edhe në rënien e të ardhurave neto te kategoria e të hyrave sekondare.

Në vitin 2016, nëpërmjet llogarisë financiare të bilancit të pagesave, u realizuan hyrje të larta neto prej 6.5% të PBB-së, në krahasim me flukset financiare neutrale të vitit të kaluar. Burimet kryesore të këtyre hyrjeve janë huamarrja neto e jashtme e shtetit dhe sektorëve të tjerë në ekonomi³⁹, si dhe performancat e favorshme të investimeve të huaja direkte. Huazimi i shtetit, i shprehur përmes investimeve portfolio, është rezultat i publikimit të eurobondit të pestë në tregjet financiare ndërkombëtare në vlerë prej 450 milionë euro, në kushte të zvogëlimit të obligimeve të shtetit për borxhe financiare⁴⁰.


Një burim shtesë i hyrjeve në llogarinë financiare në vitin 2016 ishin investimet direkte, të cilat treguan një strukturë të favorshme, me një përqindje më të lartë të komponentës jo huazuese, d.m.th. rritjen e fitimit të reinvestuar dhe të kapitalit aksionar. Shikuar sipas veprimtarive, investimet e drejtpërdrejta ishin kryesisht të orientuara drejt prodhimit të tekstit dhe produkteve të tekstit si dhe drejt industrisë automobilistike. Zmadhimi neto i obligimeve të sektorëve tjera ndaj jashtë, kryesisht rezultojnë nga borxhet afatgjata (1.95 të PBB), e të cilat në masë të madhe rezultojnë nga huazimi i ndërmarrjeve publike me qëllim të përkrahjes së projekteve infrastrukturore. Nga ana tjetër, edhe më tutje valutat dhe depozitat rezultojnë me të dalura në llogarinë financiare. Gjatë vitit 2016, në veçanti erdhi në shprehje ndryshueshmëria e këtyre rrjedha afatshkurta, që rezultoi nga zmadhimi i mosbesimit të subjekteve ekonomike kushtëzuar nga kriza politike vendore. Në fakt, zmadhimi i pasigurisë politike në tremujorin e dytë të vitit shkaktoi të dalurave të larta te kategoria e sektorëve tjerë të ekonomisë, duke reflektuar kësaj tërheqjen e mjeteve devizore të popullsisë si dhe mbajtjen e tyre jashtë sektorit bankar. Rritja e të dalurave pjesërisht u neutralizua përmes të ardhurave neto të institucioneve depozituese, përkatësisht te bankat. Zhvendosjet e tilla ishin pasojë e vendimit të BPRM për riaktivizim të masës përmes së cilës bankat bënë plasimin e depozitave devizore ne banka qendrore nën kushte pak më të mira në krahasim me tregjet ndërkombëtare. Masa⁴¹ rezultoi me tërheqje të depozitave devizore të bankave nga llogaritë e tyre të jashtme si dhe me zbutje të dalurave të popullsisë. Deri në fund të vitit, një shterim gradual i efekteve negative të gjendjes politike vërehej edhe përmes stabilizimit të dalurave te valutat dhe depozitat e sektorëve tjerë.

³⁹ Kat ë bëjë me bankat dhe sektorin jobankar korporativ.

⁴⁰ Në muajin nëntor të vitit 2016, shteti realizoi pagesën e rregullt të obligimeve në bazë të huazimit financiar afatgjatë nga "Citibank" në vlerë prej 132.7 milionë euro.


⁴¹ Rritja e depozitave në valutë të huaj të bankave vendase me BPRM-në në këtë periudhë vjen nga vendimi për depozitim në valutë të huaj në Bankën Kombëtare të Republikës së Maqedonisë të miratuar më 6 maj 2016, i cili mundëson që normat e interesit të vendosen në një nivel më të lartë se niveli i normave të interesit që bankat vendase ata e marrin atë kur vendosin fonde në euro jashtë vendit. Që nga 25 tetori 2016, depozitat në valutë nuk ofrohen si një alternativë për vendosjen e mjeteve në valutë të huaj

Grafiku 40
Llogaria financiare (% e PBB)




Burimi: BPRM

Grafiku 41
Investime të drejtpërdrejta (% e PBB)




Pozita investuese ndërkombëtare (PIN) në fund të vitit 2016 është negative dhe kap vlerën prej -5731.6 milionë euro ose -58.1% të PBB. Në krahasim me gjendjen në fund të vitit paraprak, obligimet neto ndaj pjesës tjetër të botës shënuan zmadhim prej 2 p.p. të PBB, në kushte të një rritje më të përshpejtuar të obligimeve ndërkombëtare, në relacion me mjetet ndërkombëtare (për 4.3 p.p. dhe 2.3 p.p. të PBB, përkatësisht). Kur bëhet fjalë për strukturën e obligimeve ndërkombëtare, edhe në vitin 2016 mbizotërojnë investimet e huaja të drejtpërdrejta, si një burim më stabil dhe më afatgjatë i financimit.

Grafiku 42
Pozita ndërkombëtare investuese (% e PBB)



Burimi: BPRM.

Grafiku 43
Pozita ndërkombëtare investuese sipas sektorëve (% e PBB)




Analiza sektoriale tregon se përkeqësimi vjetor i PIN është kryesisht për shkak të ndryshimeve në sektorët "shtet" dhe "sektorë të tjerë", ndërkohë që ndryshimi në pozicionin e bankës qendrore ka vepruar në drejtimin e kundërt. Kundrejt vitit paraprak kur u shënuar zvogëlim i borxhit, në vitin 2016 pozita e jashtme neto e sektorit "shtet" ka shënuar përkeqësim vjetor, për shkak të zmadhimit të huazimit neto ndaj kreditorëve të jashtëm. Edhe sektorët tjerë të ekonomisë karakterizohen me pozitë neto më pak të volitshme, për shkak të zmadhimit të obligimeve neto ndaj investitorëve të huaj të drejtpërdrejtë, si dhe në bazë të huazimeve financiare afatgjata. Nga ana tjetër, mjetet neto të bankës qendrore u zmadhuan si pasojë e akumulimit të rezervave devizore, që është në përputhshmëri me huazimit e jashtëm të shtetit. Njëherit, pozita e institucioneve depozituese nuk shënoi ndryshime më të konsiderueshme vjetore.

Në fund të vitit 2016, borxhi i jashtëm bruto arriti nivelin prej 7,253.2 milionë euro, përkatësisht 73.5% të PBB që paraqet rritje prej 4.1 p.p. të PBB në krahasim me fundin e vitit 2015. Huazimi më i lartë i sektorit publik dhe privat ka kontribuar gjithashtu në rritjen e borxhit të jashtëm bruto. Zmadhimi i borxhit të jashtëm publik në masë më të madhe mundet ti përshkruhet zmadhimit të obligimeve afatgjata të pushtetit qendrorë në formë të letrave huazuese me vlerë, si rezultat i publikimit të eurobondit të pestë. Krahas kësaj, edhe më tutje rritet borxhi i ndërmarrjeve publike në bazë të huazimeve afatgjata financiare, si burim për financim të projekteve të infrastruktura rrugore. Huazimi i sektorit privat kryesisht reflekton të ardhurat nga komponentë huazuese e investimeve të drejtpërdrejta, me atë që huazimi i rritur i sektorit privat jobankar ka dhënë një efekt shtesë.

Grafiku 44

Borxhi i jashtëm bruto, klasifikim sipas huazuesve dhe sektorëve institucional (% e PBB)



Burimi: BPRM.

Në përgjithësi, treguesit e borxhit të jashtëm të ekonomisë së vendit tregojnë se borxhi i jashtëm bruto është në zonën e sigurt. Në fund të vitit 2016, treguesi i vetëm sipas të cilit ekonomia klasifikohet në grupin e vendeve me borxhe të lartë është pjesa e borxhit të jashtëm bruto në PBB. Analiza e dinamikës së borxhit të jashtëm jep njohuri të ndryshme për ndryshimet në aftësinë paguese në krahasim me fundin e vitit 2015. Kështu, lëvizjet e favorshme tregojnë treguesit për shlyerjen e pagesave të interesit dhe shlyerjen e borxhit bruto në eksportin e mallrave dhe shërbimeve dhe flukseve tjera hyrëse⁴², ndërkohë që pjesa e borxhit bruto në eksportet dhe raporti midis borxhit bruto dhe PBB-së përkeqësohen. Treguesit e likuiditetit mbeten në zonën e sigurt dhe sipas dinamikës tregojnë një përkeqësim të lehtë. Përjashtim bën mbulimi i detyrimeve bazuar në borxhin afatshkurtër me maturim të mbetur me rezervat valutore, e cila është ende mbi një dhe rritet në baza vjetore.

Në fund të vitit 2016, borxhi i jashtëm neto, si një tregues shtesë për pozitën e jashtme të ekonomisë, arriti në 2,669.8 milionë euro, ose 27.1% të PBB-së, e cila krahasuar me 2015 paraqet rritje me 2.2 pikë përqindjeje. e PBB-së. Rritja e borxhit të jashtëm neto është pasojë e rritjes së borxhit neto të jashtëm publik dhe borxhit neto të sektorit privat.

⁴² Krahas eksportit të mallrave dhe shërbimeve janë përfshirë edhe të ardhurat në bazë të hyrave nga investimet, remitanca nga punonjësit dhe kompensime për punonjësit.

Tabela 1
Tregues të stokut të borxhit të jashtëm

	Solventiteti				Likuiditeti		
	Pagesa e interesit / Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto-Borxh/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto-Borxh/ PBB	Pagesa e borxhit/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Rezervat valutore/ Borxhi afatshkurtër	Rezervat valutore/ Borxhi afatshkurtër, me maturim të mbetur*	Borxhi afat shkurtër/ Gjithsej borxhi
	në %				raport	raport	në %
31.12.2004	2.41	129.3	47.3	12.4	1.14	0.89	30.3
31.12.2005	2.66	147.0	54.2	11.1	1.67	1.04	26.7
31.12.2006	3.44	131.3	49.8	21.7	1.95	1.34	29.0
31.12.2007	2.78	119.3	51.3	19.4	1.35	1.08	39.8
31.12.2008	2.66	116.9	54.1	10.2	1.29	0.95	35.2
31.12.2009	2.43	131.0	57.8	11.8	1.29	0.94	32.9
31.12.2010	3.22	140.4	59.7	13.9	1.49	0.99	27.9
31.12.2011	3.12	148.4	64.6	16.8	1.78	1.18	25.2
31.12.2012	2.92	142.1	67.6	13.1	1.64	1.03	26.7
31.12.2013	2.51	137.3	67.3	15.8	1.64	1.08	23.3
31.12.2014	3.01	149.1	74.0	17.2	1.82	1.13	22.3
31.12.2015	2.69	143.9	73.2	20.0	1.69	1.13	21.3
31.12.2016	2.36	151.3	79.2	14.9	1.64	1.15	22.0
<i>Kriteriumet për ngarkesë të moderuar me borxh</i>	<i>12 - 20%</i>	<i>165 - 275%</i>	<i>30 - 50%</i>	<i>18 - 30%</i>	<i>1.00</i>		

* Kriteri i ngarkesës së moderuar me borxh është matur sipas metodologjisë së Bankës Botërore për përpunimin e treguesve të huazimit, e cila nënkupton shfrytëzimin e proceseve tre vjeçare lëvizëse të PBB dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve si dhe prurjeve tjera si emërues të përbashkët të përlogaritjeve të këtyre treguesve.

Punuar në pajtueshmëri me „External debt statistics: Guide for compilers and users”, botuar nga FMN.

Sipas parimeve të Grinspan dhe Gvidoti, e nevojshme është që vendi të ruaj mbulim të plotë të borxhit afatshkurt (maturimi i pjesës së ngelur) me rezerva valutore.

Burimi: BPRM.


3.5. Agregatët monetar dhe kreditor

Masa monetare dhe aktiviteti kreditues i bankave edhe në vitin 2016 shënuan rritje, ndonëse me një intensitet më të matur në krahasim me vitin paraprak. Zmadhimi i masës më të gjerë valutore M4 korespondon me shëndetësimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik, zhvendosjet pozitive në tregun e punës dhe zmadhimin e të ardhurave disponabël si dhe me pozitën më të volitshme të jashtme të ekonomisë. Megjithatë, gjatë vitit 2016, dinamika e masës valutore ishte nën ndikim të shprehur të faktorëve të natyrës joekonomike. Kah mesi i vitit 2016, me eskalimin e krizës politike dhe paraqitjen e spekulimeve për stabilitetin e denarit dhe sistemit bankar të vendit, u shënuua një tërheqje më e madhe e depozitave nga bankat nga ana e popullsisë. Megjithëse duke filluar nga qershori, pritjet janë stabilizuar dhe depozitat e individëve kanë filluar të rriten, megjithatë, "episodi i krizës" ka çuar në një ngadalësim të rritjes vjetore të depozitave. Aktiviteti i kredisë, i përshtatur për ndryshimet rregullatore⁴³ në vitin 2016, vazhdon të rritet fuqishëm, por më ngadalë se dy vitet e mëparshme. Vrojtuar nga pikëpamja e ofertës dhe kërkesës së kredive, në vitin 2016, oferta e kredive vazhdon të rritet ndjeshëm, në kushtet e qëndrueshmërisë së qëndrueshmërisë dhe pozicionit të likuiditetit të bankave dhe rritjes së konkurrencës në sektorin bankar. Nga ana tjetër, në kërkesën për kredi, pas një periudhe më të gjatë kohore, një ngadalësim i ndjeshëm i rritjes ka ndodhur pjesërisht duke reflektuar efektet e krizës politike të vendit.

⁴³ Më 17.12.2015, Këshilli i Bankës Kombëtare miratoi Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për administrimin e rrezikut të kredisë, sipas të cilit, jo më vonë se 30 qershor, 2016 bankat janë të detyruara të shlyejnë (dhe edhe më tej të vazhdojnë me shlyerjen) të gjitha pretendimet të cilat janë rezervuar plotësisht për më shumë se dy vjet, dmth., në të cilën, të paktën dy vjet më parë, banka ka përcaktuar dhe mbuluar plotësisht rrezikun e kredisë nga mospagesa. Pavarësisht heqjes së këtyre kërkesave, përkatësisht transferimin e tyre në evidencë jashtëbilancore, bankat rezervojnë të drejtën për të mbledhur ato.


Grafiku 45a dhe 45b

Ndryshimi vjetor i masës monetare M4, kreditë dhe depozitat e përgjithshme, në %



Burimi: BPRM

Pjesëmarrja e kredive të përgjithshme dhe masës valutore M4 në PBB, në %




Masa më e gjerë valutore M4 në vitin 2016 shënoi rritje prej 6.1%, që paraqet një rritje më të butë në krahasim me vitin paraprak. Në të njëjtën kohë, të gjitha komponentët individualë kanë kontribuar pozitivisht në rritjen e ofertës monetare. Sidoqoftë, si në dy vitet e mëparshme, edhe në vitin 2016, paratë e depozituara kanë kontributin më të madh individual, duke treguar ndjeshmërinë e subjekteve vendase në mjedisin politik të paqëndrueshëm në vend dhe prirjen për përdorimin e aseteve me likuiditet të lartë në kushtet e rritjes së pasigurisë. Përkundër ambientit të pasigurt, kursimet në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë kontribuan në rritjen e ofertës monetare në 2016, duke sinjalizuar një stabilizim relativisht të shpejtë të sjelljes së subjekteve ekonomike dhe mbështetur nga masat e marra nga banka qendrore.

Tabela 2
Komponentë të masës monetare – gjendje dhe ndryshime

	Gjendja			Ndryshimet vjetore		
	2014	2015	2016	2014	2015	2016
	në milionë denarë			BO %		
Paratë e gatshme nëqarkullim	23,221	26,300	28,193	12.1	13.3	7.2
Paratë në depozitë	62,326	74,978	83,156	26.4	20.3	10.9
M1	85,548	101,278	111,349	22.2	18.4	9.9
Depozitat afatshkurtëra në denar	57,151	53,557	51,592	0.1	-6.3	-3.7
Depozitat afatshkurtëra në valutë të huaja	90,980	96,514	103,836	0.0	6.1	7.6
M2	233,678	251,349	266,776	7.2	7.6	6.1
Depozitat afatgjata në denar	51,673	53,518	55,834	24.5	3.6	4.3
Depozitat afatgjata në valutë të huaja	24,527	26,140	28,612	18.0	6.6	9.5
Gjithsej depozitat*	224,330	229,728	239,873	6.6	2.4	4.4
Gjithsej depozitat	286,656	304,706	323,029	10.4	6.3	6.0
M4	309,878	331,007	351,222	10.5	6.8	6.1

Burimi: BPRM.

Grafiku 46
Komponentë të masës monetare-dinamikë




Vrojtuar nga aspekti i depozitave të përgjithshme, në vitin 2016 pothuajse gjysma e rritjes vjetore të potencialit total të depozitave të bankave shpjegohet me rritjen e fondeve në llogaritë e transaksioneve (kryesisht në familje dhe në një masë më të vogël në sektorin e korporatave), duke sinjalizuar kujdes në sjellje, në kushtet e rritjes së rreziqeve. Analiza e kursimeve në sistemin bankar pa para të depozitave, tregon se rritja vjetore kryesisht rrjedh nga sektori i korporatave, ndërkohë që kontributi i kursimeve të kryera nga ana e familjeve është më i moderuar, gjë që është një veçori e pazakontë e strukturës së rritjes.

Kjo zhvendosje pasqyron efektet e krizës politike në kursimin e popullsisë, e cila ndihej më shumë në periudhën prill-maj, kur depozitat e popullsisë në sistemin bankar (duke përjashtuar depozitat pa afat) u ulën me rreth 6 miliardë denarë ose 3.2% të situatës në fund të marsit 2016.

Zvogëlim u vërejt në të gjitha komponentët e kursimeve, por veçanërisht erdhi në shprehje te kategoritë në denarë si dhe te kursimet afatshkurta. Një pjesë e fondeve të tërhequra u konvertuan në valutë të huaj. Nga qershori deri në fund të vitit, depozitat e ekonomive familjare u rritën në mënyrë të qëndrueshme, me kontributin e kursimit në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë pothuajse ishte e balancuar. Megjithatë, shikuar në nivel të vitit 2016 në tërësi, në suaza të sektorit "familje", rritja vjetore e depozitave reflekton zmadhimin e kursimit afatgjatë, me atë që depozitat afatshkurta të familjeve shënuan ulje.

Grafiku 47


Shkalla e euroizimit, pjesëmarrja e depozitave të përgjithshme devizore në totalin e depozitave dhe pjesëmarrja e depozitave devizore të familjeve në totalin e depozitave të familjeve (me dhe pa para depozituese), në %



Burimi: BPRM.


Rreziqet e rritura nga zhvillimet politike në vend kishin një ndikim të madh në strukturën valutore të depozitave të individëve. Pritshmëritë e ekonomive familjare për kursim në valutë të huaj ishin gjithashtu karakteristike për vitin 2016, ku në kushte të rritjes së pasigurisë, paralelisht me rritjen e kursimeve në valutë, depozitat në denarë të ekonomive familjare ranë, në baza vjetore, pas një periudhe të gjatë kohore. Në sektorin e korporatave, rritja vjetore është kryesisht për shkak të rritjes së depozitave afatshkurtra dhe rritjes relativisht më të lartë të monedhës së huaj në krahasim me depozitat në denarë, gjë që është gjithashtu një fenomen i pazakontë për ndërmarrjet dhe ndoshta reflekton pasigurinë në rritje në ekonomi. Duke pasur parasysh këto zhvillime, si dhe stabilizimin e shpejtë të pritjeve sipas masave të BPRM, shkalla e euroizimit financiar, e matur përmes pjesëmarrjes së depozitave me komponentë devizore në totalin e depozitave, në vitin 2016 shënoi rritje modeste nga 40.3% në 41.1%, me atë që zhvendosjet në këtë tregues për sektorin "popullsi" ishin më pak të shprehura.

Grafiku 48
Struktura sektoriale e totalit të depozitave
(përfshirë edhe para të depozituara)



Burimi: BPRM.

Grafiku 49
Kontribut në ndryshimin vjetor të totalit të depozitave të familjeve, në p.p.




Në vitin 2016, aktiviteti i tregut të kredive ishte i qëndrueshëm. Në baza vjetore, kreditë e përgjithshme janë më të larta për 1.0%, respektivisht për 6.5%, nëse efekti i ndryshimeve rregulatore është i izoluar. Rritja në ofertën e kredive u mbështet nga pozita e mirë solvente dhe likuide e bankave dhe nga konkurrencshmëria e rritur në sektorin bankar. Nga ana tjetër, në vitin 2016, kërkesa për kredi u ngadalësua ndjeshëm, pjesërisht duke reflektuar efektet e krizës politike të vendit. Performanca të tilla konfirmohen edhe nëpërmjet rezultateve të anketave të huadhënies. Për herë të parë pas një periudhe të gjatë kohore, për vitin 2016, anketa tregon një ngadalësim të ndjeshëm të kërkesës për kredi në sektorin e korporatave dhe në sektorin "popullsi". Shikuar sipas strukturës sektoriale, rritja vjetore e kredive në vitin 2016 (pa ndryshimet në rregulativë) rezultojn nga zmadhimi i kredive të miratuara për sektorin "popullsi", me atë që kreditë e ndërmarrjeve kanë një ndikim pozitiv, por me kontribut më të ulët në rritjen vjetore. Kështu, kontributi i kredive korporative në rritjen vjetore të totalit të kredive, ka shënuar ngadalësim për të dytin vit në radhë. Me qëllim të përkrahjes së mëtejme të kreditimit të sektorit korporativ, BPRM edhe në vitin 2016 e zbaton masën jostandarde të orientuar drejt eksportuesve-neto dhe prodhuesve të energjisë elektrike.⁴⁴ Krahas kësaj, me Vendimin për ndryshim të vendimit për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit nda dhjetori i vitit 2015, BPRM krijoi kushte për lehtësim të qasjes së ndërmarrjeve në shërbimet financiare të bankave (përfshirë këtu edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme⁴⁵).

⁴⁴ Me këtë masë pa klauzolë valutore e emituar nga neto eksportuesit dhe prodhuesit vendor të energjisë elektrike mundëson zvogëlimin e bazës së rezervave të detyrueshme të bankave për vlerën e kredive të reja të lejuara të eksportuesve neto dhe prodhuesve vendor të energjisë elektrike dhe për investimet e bankave në letra me vlerë të borxhit me prejardhje vendore. Masa u inkorporua në fund të vitit 2012 dhe filloi të zbatohet nga viti 2013. Që nga futja e masës, aplikimi i tij u shtri në dy raste, dmth deri në fund të vitit 2017.


⁴⁵ Me vendimin për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të adekuatitetit të kapitalit të Dhjetorit të vitit 2015 u bë zvogëlimi i kërkesës për garancionet e dhëna nga ana e bankave me të cilat garantohet pagesë në bazë të një relacioni të caktuar të klientit dhe të kërkesave të bankave të cilat janë të siguruar me hapsira afariste që plotësojnë kushte të caktuara. Me këtë u mundësua që bankat të ndajnë një sumë më të vogël të kapitalit për garantim të kredive për punë me persona juridik, përfshirë këtu edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që pritet të rezultojn me zvogëlim të kostove të bankave e me këtë edhe me zvogëlim të kostove të klientëve për këtë tip të punës.

Grafiku 50
Kontribut në ndryshimin vjetor të totalit të kredive sipas sektorëve




Burimi: BPRM.

Grafiku 51
Gjithsej kredi për popullsinë, sipas dedikimit




Analiza sipas tipeve individuale të kredive për popullsinë, tregon se rritja vjetore e kredive edhe në vitin 2016 rezulton nga rritja e kreditimit për qëllime të konsumit si dhe nga rritja e kredive për banim. Megjithatë, ngjashëm si në rastin e dinamikës së portfolios së përgjithshme kreditore edhe të këto dy komponentë vërehet ngadalësim i rritjes. Anketa mbi aktivitetin kreditues tregon se kushtet kredituese për kreditë e konsumit janë lehtësuar edhe në vitin 2016, më një intensitet të ngjashëm si në vitin paraprak. Nga ana tjetër, rritja e kredive për konsum ka shënuar ngadalësim të dukshëm. Ngadalësim i kërkesës vërehet edhe te kreditë për banim, te të cilët në vitin 2016 është shënuar edhe një lehtësim i shprehur i kushteve të kreditimit, në krahasim me vitin paraprak.

Grafiku 52
Oferta, kërkesa dhe shqyrtimi i riskut të bankave⁴⁶ (neto-përqind)
Sektori korporativ



Burimi: Anketa për aktivitetin kreditor, BPRM.

Sektori „popullsi“



⁴⁶ Sqarim: Oferta ka të bëjë me ndryshimin e kushteve kredituese (po qese përqindja neto është pozitive në atë rast kushtet kredituese janë të ashpërsuara kurse poqese është zero në atë rast ato janë më të relaksuara); kërkesa për kredi (po qese përqindja neto është pozitive në atë rast kërkesa është rritur, kurse po qese ajo është negative atëherë kërkesa është zvogëluar); faktorët e riskut që ndikojnë mbi parakushtet për kreditim (po qese përqindja neto është pozitive në atë rast kushtet kredituese janë të ashpërsuara kurse poqese është negativ në atë rast ato janë më të relaksuara). Në grafikun që ka të bëjë me popullsinë është paraqitur mesatarja e përqindjes neto të faktorëve të riskut që ndikojnë mbi kushtet kredituese gjatë miratimit të kredive banesore si dhe të atyre që ndikojnë mbi kreditë për konsum. Në faqen zyrtare të BPRM mundet të gjendet informata më të detajuara mbi aktivitetin kreditues.

IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2017 dhe 2018⁴⁷

Në përputhje me dispozitat ligjore, politika monetare e BPRM-së edhe në periudhën e ardhshme do të synojë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si një objektiv monetar bazik. Në të njëjtën kohë, BPRM do të vazhdojë të kontribuojë në ruajtjen e një sektori bankar të qëndrueshëm dhe konkurrues dhe do të mbështesë politikën e përgjithshme ekonomike pa rrezikuar arritjen e qëllimit parësor. Nga aspekti i strategjisë monetare, BPRM do të vazhdojë të zbatojë strategjinë e synimit të një kursi këmbimi nominal të qëndrueshëm të denarit kundrejt euros. Roli i kursit të këmbimit si një spirancë nominale rrjedh nga karakteristikat e ekonomisë vendase, si një ekonomi e vogël dhe e hapur me varësi të lartë nga importi i produkteve parësore. Në kushte të tilla rritet rëndësia e kursit të këmbimit për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe pritjet e inflacionit të qëndrueshëm të subjekteve ekonomike. Korniza operative e politikës monetare, si edhe më parë, do të vendoset në një bazë fleksibile, e cila do të mundësojë menaxhimin efikas të likuiditetit të sistemit bankar dhe ruajtjen e bilancit në tregun valutor. Kështu, politika monetare do të vazhdojë të kontribuojë në stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, si një faktor kyç në krijimin e një mjedisi të favorshëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Sipas parashikimeve të BPRM në tetor të vitit 2016, pritet që zbatimi i politikës monetare në vitin 2017 dhe 2018 do të zhvillohet në një mjedis relativisht të qëndrueshme, por me praninë e mëtejshme të rreziqeve të jashtme dhe të brendshme. Projektionet e fundit të BPRM në tetor të vitit 2016 parashikojnë se ekonomia vazhdon të rritet me shpejtësi, e ndikuar kryesisht nga eksportet dhe investimet. Sektori bankar do të vazhdojë të mbështesë rritjen ekonomike nëpërmjet rritjes së aktivitetit kreditues. Pritet që gjendja në sektorin e jashtëm të jetë e favorshme edhe në dy vitet e ardhshme, pavarësisht nga vlerësimet për zgjerim të moderuar të deficitit të llogarisë rrjedhëse në përputhje me forcimin e aktivitetit ekonomik. Rruga e projektuar e rezervave valutore vazhdon të tregojë drejt mbajtjes së treguesve të përshtatshmërisë së rezervave në zonën e sigurt. Inflacioni do të jetë i moderuar dhe do të lëvizë në korniza të kontrolluara, pra rreth mesatares historike prej 2%. Duke pritur kushte më të favorshme ekonomike, BPRM në periudhën e ardhshme do të jetë kryesisht e orientuar në monitorimin e arritjes së rrugës së projektuar të rezervave valutore dhe zhvillimeve në tregun e valutave, si dhe monitorimi i të gjitha rreziqeve të pranishme dhe në përputhje me rrethanat, do ta përshtat politikën monetare.

Realizimi i kornizës së projektuar makroekonomike është i shoqëruar me rreziqeve që vijnë nga jashtë, por edhe nga pasiguria e mjedisit të brendshëm. Andaj, rreziqet e jashtme që mund të rrjedhin në ekonominë e vendit nëpërmjet kanaleve të ndryshme, kryesisht kanë të bëjnë me dinamikën e rimëkëmbjes së rritjes ekonomike globale, si dhe lëvizjeve në çmimet e produkteve kryesore në bursat botërore. Kjo kryesisht ka të bëjë me rritjen potencialisht të ulët globale dhe rritja në eurozonë, si partneri ynë më i madh tregtar, duke reflektuar vendimin e Britanisë së Madhe për të dalë nga BE-ja dhe rritjen më të ngadaltë të ekonomisë amerikane, si dhe tensionet akoma të pranishme gjeopolitike. Në drejtim të rreziqeve të brendshme, ato kryesisht rezultoi nga mjedisi politik i paqëndrueshëm, efektet ekonomike të të cilit në vitin 2016 kanë qenë relativisht të kufizuara. Megjithatë, këto rreziqe mbeten të pranishme dhe mund të ndikojnë në ecurinë makroekonomike në periudhën e ardhshme. Realizimi eventual i rreziqeve të përmendura do të nënkuptojë gjithashtu ndryshimin e mjedisit për zbatimin e politikës monetare, krahasuar me pritjet bazë.

⁴⁷ Bazuar në parashikimet e BPRM-së nga tetori i vitit 2016

Në periudhën e ardhshme pritet një rritje graduale e inflacionit, e cila sipas parashikimeve të tetorit do të lëvizte nga 1.3% për vitin 2017 në 2% për vitin 2018. Pritet që rritja e çmimeve në vitin 2017 kryesisht do të jetë nxitur nga rritja e inflacionit të ushqimit, dhe në një masë më të vogël nga rritja e inflacionit të energjisë, që është në përputhje me parashikimet për rritjen e çmimeve botërore të ushqimit dhe të energjisë vitin e ardhshëm. Efekte të caktuara mbi inflacionin priten gjithashtu edhe nga rritja e inflacionit bazë, i cili shoqërohet me rritjen e mëtejshme të kërkesës së brendshme, por edhe me efektet e transferuara nga rritja së çmimeve të energjisë dhe të ushqimit. Në vitin 2018, inflacioni do të shënojë përforsim të moderuar, në kushtet e forcimit të rritjes ekonomike dhe të kërkesës vendase, intensifikimit të inflacionit të huaj dhe rritjes së mëtejshme të çmimeve të ushqimit dhe energjisë në tregun botëror. Projektionet e inflacionit shoqërohen nga rreziqe, të cilat lidhen kryesisht me lëvizjet e çmimeve botërore të produkteve primare. Nga projektionet e tetorit këndej, pritjet për çmimet botërore të produkteve primare kanë ndryshuar në drejtim rritës, duke treguar për rreziqet në rritje për inflacionin e brendshëm të parashikuar.

Në dy vitet e ardhshme, pritet një përshejtim gradual i ritmit të rritjes ekonomike, bartësit kryesorë të të cilave do të ishin eksporti dhe investimet. Pritet që rritja e eksportit do të vazhdojë të mbështetet nga kompanitë e reja të orientuara nga eksporti, rimëkëmbjen e sektorëve tradicionalë, si dhe rimëkëmbja e kërkesës së jashtme. Rritja e aktivitetit eksportues dhe njoftimet e investimeve të huaja në kapacitete të reja, së bashku me stimulin fiskal në infrastrukturë do të kontribuojë në rritjen e investimeve në dy vitet e ardhshme. Pritet që lëvizjet e tilla do të kenë një efekt pozitiv edhe në tregun e punës, që do të kontribuojë në rritjen e konsumit të ekonomive familjare. Mbështetja shtesë ndaj kërkesës së brendshme pritet edhe nga aktiviteti i kredisë. Në kushte të tilla, rritja e PBB-së në vitin 2017 do të ishte 3.5%, dhe në vitin 2018 do të përshejtohej shtesë dhe do të arrihte në 3.7%. Rreziqet për rritjen e projektuar edhe më tej rezultojnë nga mjedisi politik i brendshëm, dhe duke pasur parasysh hapjen e lartë të ekonomisë, dhe të mjedisit globale dhe zhvillimet në mjedisin e jashtëm.

Në kushte të likuiditetit dhe aftësinë paguese të ngurtë të bankave, pritet që rimëkëmbja ekonomike, mjedisi stabilizuar, rritja e potencialit të depozitave të bankave, si dhe masat e marra tashmë nga autoritetet monetare do të kontribuojnë për mbështetje më të madhe financiare për ekonominë e vendit përmes sektorit bankar. Rritja e totalit të kredive (pa përfshirë efektet e para të shlyerjeve) në vitin 2017 është parashikuar në 6.4%, ndërsa deri në fund të vitit 2018 pritet që të përshejtohet pak dhe të arrijë në 6.7%. Një rritje e tillë e parashikuar e kredisë pasqyron faktorët si nga ana e kërkesës ashtu edhe nga ana e ofertës. Gjegjësisht, performanca pozitive dhe pritjet për tendencat e vazhdueshme të favorshme në tregun e punës, si dhe rritja e projektuar solide në aktivitetin e investimeve do të kontribuojnë për kërkesë të qëndrueshme të kredisë në dy vitet e ardhshme. Nga ana e ofertës pritet akoma mbështetja nga rritja e bazës së depozitave, si dhe nga perceptimi i qëndrueshëm i rrezikut të bankave. Në aspektin e potencialit të depozitave, pas ngadalësimit të rritjes së depozitave në vitin 2016, që ishte reflektim i tërheqjes më të madhe të depozitave nga sistemi bankar për shkak të mjedisit të pasigurt të brendshëm politik, në dy vitet e ardhshme pritet që të stabilizohet situata dhe kthimi i mjeteve të tërhequra gradualisht në sistemin. Kjo, së bashku me tendencat e pritshme të favorshme në ekonominë vendase, do të mundësojë një rritje më të fortë të depozitave gjatë vitit 2017 dhe 2018. Rreziqet në rënie lidhur me parashikimin e rritjes së kredisë dhe depozitave vazhdojnë të ekzistojnë. Mundësia për një rimëkëmbja më të dobët ekonomike nga pritjet, si dhe pasiguria e vazhdueshme në lidhje me faktorët e rrezikut të brendshëm, mund të çojnë në përmbajtje

më të mëdha të kursimeve, t'i kufizojnë burimet e financimit për bankat, t'i përkeqësojnë perceptimet e rrezikut dhe të zvogëlojnë gatishmërinë për huamarrje të sektorit privat.

Projeksionet për vitin 2017 dhe 2018 tregojnë një pozitë të jashtme që do të sigurojë mirëmbajtje të mëtejshme të rezervave valutore në nivelin e duhur. Pritet që deficitin i llogarisë rrjedhëse të jetë relativisht i qëndrueshëm dhe të lëvizë rreth 3% të PBB-së. Për më tepër, në bilancin e mallrave dhe shërbimeve nuk priten ndryshime të mëdha, në kushte të zgjerimit të deficitit të energjisë, por me tendencë të favorshme në segmente të tjera. Nga ana tjetër, pas shokut negativ në vitin 2016 për shkak të krizës politike, në të ardhurat dytësore në vitin 2017 pritet rritje e tepricës së saj dhe një rënie e lehtë në vitin e ardhshëm. Zgjerimi pritet në deficitin e të ardhurave primare, pjesërisht si pasojë e vlerësimeve për përmirësimin e mëtejshëm të fitimit të kompanive në pronësi të huaj. Në drejtim të financimit, pritet që, edhe në periudhën e ardhshme, pjesa më e madhe e financimit të llogarisë rrjedhëse të sigurohet nëpërmjet investimeve të huaja direkte dhe huamarrjes së sektorit publik dhe privat në afat të gjatë. Në kushtet e rezervave valutore, gjatë dy viteve të ardhshme pritet që transaksionet në bilancin e pagesave do të kontribuojnë për të rritur më tej rezervat valutore dhe mirëmbajtjen e mëtejshme të treguesve të mjaftueshmërisë së rezervave valutore në zonën e sigurt. Rreziqet kryesore për pozicionin e jashtëm të ekonomisë në këtë periudhë edhe më tej të vijnë nga dinamika e rimëkëmbjes globale, lëvizjet e çmimeve ndërkombëtare dhe mjedisit të brendshëm politik.

Në dy vitet e ardhshme pritet politikën e matur fiskale, me konsolidim të mëtejshëm të deficitit buxhetor dhe nivelit relativisht të qëndrueshëm të borxhit publik.⁴⁸ Politika fiskale është një faktor i rëndësishëm që ndikon në vendosjen e politikës monetare, dhe koordinimi i duhur i këtyre politikave është një faktor kyç në arritjen e qëndrueshmërisë së pozitës së jashtme të vendit dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Në periudhën e ardhshme, pritet një ngushtim gradual i deficitit buxhetor. Investimet publike mbeten qëllimi kryesor i politikës fiskale. Në fakt, për periudhën e ardhshme është parashikuar realizimi i projekteve të mëdha të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, të infrastrukturës lokale dhe në sektorin e energjisë, si dhe në bujqësi. Është parashikuar financimi i deficitit të sigurohet nga burime të jashtme dhe të brendshme. Për më tepër, në kuadër të burimeve të brendshme, parasëgjithash është parashikuar emetimi i letrave me vlerë të qeverisë, si dhe përdorimi i një pjese të depozitave të qeverisë në BPRM. Një kornizë e tillë fiskal parashikon një rritje të moderuar të borxhit të qeverisë në periudhën e ardhshme, e cila nuk do të rrezikojë qëndrueshmërinë e financave publike. Politika fiskale e vendosur është e shoqëruar me rreziqe të cilat, ashtu si me politikën monetare, rezultojnë nga mjedisi i brendshëm, por edhe nga mjedisi i jashtëm dhe ndikimin e tyre në aktivitetin ekonomik të brendshëm, si dhe mbi aftësinë për të hyrë në tregjet e huaja financiare.

BPRM monitoron rregullisht trendet aktuale, rreziqet e pranishme dhe sipas tyre, e vlerëson vendosjen e politikës monetare dhe është gjithmonë e gatshme për të marrë masat e duhura për të ruajtur stabilitetin e çmimeve dhe financiar në ekonomi.

⁴⁸ Projeksionet në fushën e politikës fiskale bazohen në Buxhetin për 2017 dhe në Strategjinë fiskale të Republikës së Maqedonisë 2017-2019.

V. Instrumentet monetare

Gjatë vitit 2016, ndryshimet në pozicionin e instrumenteve monetare synonin arritjen e qëllimeve të politikës monetare. Përkundër ambientit jo të favorshëm për zbatimin e politikës monetare në tremujorin e dytë të vitit, reagimi në kohë i autoriteteve monetare kërkon ruajtjen e stabilitetit të sektorit bankar dhe të kursit të këmbimit të denarit. Thellimi i krizës së brendshme politike dhe shfaqjet e spekulimeve në lidhje me stabilitetin e sektorit bankar dhe të kursit të këmbimit në periudhën prill-maj kanë shkaktuar presione për të tërhequr depozitat nga sektori bankar dhe rritjen e kërkesës për valutë të huaj. Për të stabilizuar pritjet e agjentëve ekonomikë, pavarësisht ndërhyrjeve me shitje-neto në tregun e këmbimeve valutore, BPRM ka rritur ndjeshëm normën e interesit për bonot e thesarit nga 3.25% në 4% në ankandin në maj. Gjithashtu, ishte ulur dhe shuma e bonove të thesarit, për të kompensuar për likuiditetin e reduktuar në denarë të bankave, e cila fillimisht u kompensua nëpërmjet instrumenteve në dispozicion të BPRM (depozitave dhe kredive njëditore). Përveç reagimit me instrumentin bazë, u prezantuan edhe masa shtesë për stabilizimin e bazës së depozitave në denarë. Kështu, ishte rritur edhe norma e rezervës së detyrueshme për detyrimet me klauzolën në valutë të huaj nga 20% në 50% dhe u mundësua vendosja e depozitave në valutë të huaj të bankave në BPRM me norma më të favorshme të interesit se sa ato të huajat. Pritej që kostot e reduktuara të bankave dëto mundësojnë një ofertë më të favorshme si për valutën e huaj, ashtu edhe për normat e interesit të depozitave në denarë për klientët.


Përgjigja në kohë dhe adekuate e BPRM-së mundësoji stabilizim të shpejt të pritjeve në publikun vendas, duke çuar në një normalizim gradual të lëvizjeve në tregun e këmbimit valutor dhe likuiditetin e bankave deri në fund të qershorit. Në gjysmën e dytë të vitit, plotësisht u zbehën efektet e goditjes së periudhës prill-maj, ndërsa në tregun e këmbimeve valutore u vërejtën lëvizje pozitive. Në të njëjtën kohë, ka pasur lëvizje pozitive edhe në depozitat në sistemin bankar, gjë që krijoi kushtet për fillimin e një cikli për normalizimin e kushteve monetare. Kështu, në dhjetor BPRM bëri një ulje të moderuar në normën e interesit për bonot e thesarit për 0.25 pikë përqindje, ndërsa njëkohësisht tërhoqi edhe një pjesë të likuiditetit të tepërt nga sistemi bankar, duke rritur ofertën e bonove të thesarit.

5.1. Ndryshimet në likuiditetin e bankave


Në vitin 2016, likuiditeti i bankave regjistroi ndryshime të rëndësishme, të ndikuara nga faktorë autonomë individualë⁴⁹. Kjo u shpreh veçanërisht në mes të prillit në vitin 2016, kur likuiditeti shënoi një rënie të madhe, nën ndikimin e zhvillimeve në skenën politike vendase. Gjegjësisht, mjedisi i pasigurt politik dhe spekulimet në lidhje me stabilitetin e bankave dhe vlerës së denarit kanë kontribuar në reagimin e kujdesshëm të popullsisë, të cilat janë reflektuar në një tendencë për të ruajtur të holla në denarë dhe në valutë të huaj dhe tërheqjen e depozitave nga sistemi bankar. Kjo çoi deri në një rënie të ndjeshme të likuiditetit të monedhës së huaj dhe në denarë të bankave. Në rrethana të tilla, për të mbrojtur stabilitetin e kursit nga sulmet spekulative, BPRM në periudhën prill-maj të vitit 2016 ka intervenuar në tregun e këmbimeve valutore me bankat mbështetëse, duke siguruar likuiditet në valutë të huaj në shumë totale prej 129.1 milionë euro. Në të njëjtën kohë, asetet likuide të sistemit bankar të Maqedonisë shënuan rënien më të madhe (rreth 8 miliardë denarë) nga kriza ekonomike e këndeje.

⁴⁹ Faktorët autonomë janë zërat e bilancit të BPRM-së, në të cilat banka qendrore nuk ka ndikim, dhe dinamika e tyre varet nga sektorë të tjerë në ekonomi. Faktorët autonomë përfshijnë: paranë e gatshme në qarkullim, depozitat qeveritare, mjetet neto në valutë të huaj dhe faktorë të tjerë autonomë.


Grafiku 56
Rrjedhja e likuiditetit nga faktorë autonome, efekti kumulativ



Grafiku 57
Transaksionet e bankave me persona fizik në tregun në valutë të huaj dhe të këmbimit valutor




Grafiku 58
Ndryshimet kumulative vjetore tek neto-shitjet e valutave të huaja të bankave me klientët



Burimi: BPRM.

Grafiku 59
Intervenimet e BPRM në tregun në valute të huaja




Ndërhyrjet në valutë të huaj të BPRM, së bashku me masat e tjera të përcaktuara, mundësoi stabilizimin e pritjeve të popullatës dhe përmirësimin gradual të lëvizjeve në tregun e këmbimeve valutore, e cila është konfirmuar vazhdimisht me normalizimin e kërkesës për valutë të huaj në një nivel që ishte tipike para periudhës së krizës. Në gjysmën e dytë të vitit, oferta e qëndrueshme dhe mesatarisht më e lartë e valutës së huaj nga personat fizikë, e kombinuar me ofertë më të lartë të valutave të huaja nga kompanitë në baza vjetore, kanë çuar në rritjen e likuiditetit në valutë të huaj të bankave dhe përkatësisht, ofertës më të lartë se kërkesës për valutë të huaj në tregun ndërbankar të këmbimit valutor. Rrjedhimisht, BPRM bleu gjithsej 135 milionë euro në këtë periudhë, me çka plotësisht e kompensoi rënien e rezervave valutore dhe likuiditetin e denarit të bankave gjatë periudhës së krizës në prill-maj të vitit 2016. Kështu, pavarësisht efektit të shprehur negativ në situatën politike, në vitin 2016 ndërhyrjet e BPRM-së në tregun e këmbimit valutor në bazë-neto kanë kontribuar në rritjen e likuiditetit të bankave për 983 milionë denarë (ose një blerje neto prej 16.65 milionë euro).

Megjithë ndërhyrjet e valutës së huaj, në vitin 2016 edhe transaksionet e qeverisë mundësuan rritjen e likuiditetit në denarë të bankave. Ky faktor autonome kishte kontributin më të lartë në rritjen vjetore të likuiditetit të bankave (rreth 4,950 milionë denarë), sidomos në periudhën prilli-maj, kur bankat e kompensuan rënien e likuiditetit në denarë nga

maturimi i letrave me vlerë të qeverisë. Deri në fund të vitit, huamarrja e shtetit në tregun e brendshëm u ngadalësua, me një rritje vjetore të letrave me vlerë të qeverisë për shkak të investimeve nga ana e investitorëve institucionalë (fondet pensionale dhe të sigurimit).


Paratë e gatshme në qarkullim, në vitin 2016, kryesisht kanë pasur dinamikën e zakonshme, duke pasur parasysh se spekulimet në lidhje me stabilitetin e denarit kishin një ndikim të shkurtër dhe minimal në kërkesën e popullsisë për të holla në denarë në prill. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh përmirësimin e vazhdueshëm të të ardhurave reale të disponueshme të familjeve, paratë e gatshme në qarkullim në vitin 2016 regjistruan një rritje vjetore prej 2,476 milion denarë, në nivel mesatar për disa vite të fundit. Efekti i këtij ndryshimi të vazhdueshëm të likuiditetit të bankave u kompensua me likuiditetin e krijuar nga transaksionet qeveritare dhe transaksionet e tregut të këmbimit valutor, në mënyrë që faktorët autonomë në bazë vjetore kanë kontribuar në rritjen e likuiditetit në sistemin bankar për 3,306 milionë denarë.

Grafiku 60
Dinamika e ndryshimit të parave të gatshme në qarkullim



Burimi: BPRM.

Grafiku 61
Efekti vjetor i likuiditetit të faktorëve autonom



* FTA – Faktorë të tjerë autonom.

5.2. Instrumentet monetare

5.2.1. Bonot e thesarit


Në vitin 2016, ndryshimet në normën e interesit dhe shuma e ofruar e bonove të thesarit, si një instrument themelor monetar, kanë kontribuar në arritjen e objektivave të politikës monetare, nëpërmjet menaxhimit efektiv të likuiditetit në sistemin bankar, si dhe ndërhyrjet mbështetëse në tregun e këmbimeve valutore. Kështu, pavarësisht periudhës disa-vjeçare të zbatimit të normave të ulëta dhe të pandryshuara të interesit (në kushte të normave të ulëta negative të inflacionit, pozicionit të jashtëm të favorshëm, hapësirë për të nxitur aktivitetin kreditues në vend), në fillim të majit të vitit 2016, në përgjigje të goditjes të natyrës jo-ekonomike, BPRM vendosi të rrisë normën e interesit për bonot e thesarit për 0.75 pikë përqindjeje, nga 3.25% në 4%.⁵⁰ Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh reduktimin e ndjeshëm të potencialit të likuiditetit të bankave, BPRM e zvogëloi ofertën e bonove në nivel prej 22,000 milionë denarë.⁵¹ Norma e interesit dhe shuma e bonove të thesarit të mbajtura në këto nivele deri në dhjetor, kur nga stabilizimi i dukshëm i pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe përmirësimit të konsiderueshëm të likuiditetit në denarë të

⁵⁰ Norma bazë e interesit nuk ishte e ndryshuar që nga qershori i vitit 2013.

⁵¹ Në tre vitet paraprake, përshkak të mbajtjes së kushteve të favorshme të likuiditetit për mbështetjen e kreditimit të sektorit privat, BPRM vazhdimisht ka ofruar shumë të pandryshuar të bonove të thesarit që ishte në nivel të caktuar prej 25,000 milionë denarë.


bankave, u krijuan kushte për fillimin e një cikli të normalizimit gradual të politikës monetare. Në rrethana të tilla, në mbledhjen e rregullt mujore në dhjetor, Komiteti për politikën monetare operative vendosi të ulë normën e interesit për bonot e thesarit për 0.25 pikë përqindjeje, në një nivel prej 3.75%. Gjithashtu, është marrë vendim edhe për të rritur ofertën e bonove të thesarit për 1,000 milionë denarë në raport me shumën e maturuar, në nivel prej 23,000 milionë denarë.⁵²

Grafiku 62
Gjendja e bonove të thesarit dhe norma e interesit



Burimi: BPRM.

Grafiku 63
Norma vjetore e rritjes së detyrimeve në denarit sipas bankave⁵³



Duke marrë parasysh rreziqet negative në procesin afatgjatë të denarizimit të detyrimeve të bankave dhe rritjen e prirjes së popullatës për të kursyer në valutë të huaj, shpërndarja e shumës së ofruar në ankandet e bonove të thesarit⁵⁴, edhe në vitin 2016, janë shpërndarë në përputhje me pjesëmarrjen individuale të bankave në totalin e detyrimeve në valutën vendase pa klauzolë të valutës. Kështu që, depozitat e zvogëluara në kohën e shokut në tremujorin e dytë pjesërisht janë kthyer në sistemin bankar, duke kontribuar në rritje më të vogël të bazës së depozitave në krahasim me vitin e kaluar, me çka bankat që kanë rritjen më të lartë individuale të depozitave në denarë, në krahasim me nivelin e rritjes të sistemit, fitojnë mundësinë për pjesëmarrje më të madhe në ofertën e bonove të thesarit. Në rrethana të tilla dhe duke pasur parasysh përcaktimin e ofertës së bonove të thesarit në përputhje me gjendjen e likuiditetit, kërkesa për bono thesari nga ana e bankave në të shumtën e ankandëve ishte në nivelin i shumës së ofruar.⁵⁵

5.2.2. Depozitat në dispozicion dhe huat në BPRM

Në vitin 2016, gjatë administrimit të ndryshimeve afatshkurtra në aktivet likuide, bankat kanë përdorur aktivisht edhe depozitat në dispozicion në BPRM.⁵⁶ Në periudhën e

⁵² Në fund të vitit, norma e interesit të bonove të thesarit ishte më i lartë në krahasim me vitin 2015 për 0.5 pikë përqind, ndërsa shumica e instrumentit themelor më e ulët për 2,075 milionë denarë.

⁵³ Radhitja e bankave është sipas zgjidhjes së rastit dhe nuk varet nga madhësia e bankës.


⁵⁴ Në ankandet e bonove të thesarit, të cilat mbahen në ditën e parë të periudhës së rezervave të detyrueshme, është aplikuar tender me shumica (shumë e kufizuar e ofertës dhe normë e përcaktuar fikse e interesit).

⁵⁵ Raporti midis kërkesës dhe ofertës së bonove të thesarit nga ankandet e mbajtura në vitin 2016 ishte 0.98.

⁵⁶ Vendosija e aseteve likuide në depozitat në dispozicion në BPRM është me iniciativë të bankave. Depozitat e disponueshme njëditore janë të disponueshme për bankat çdo ditë, dhe bankat kanë mundësi të vendosin aktivet likuide në depozita me afat maturimi prej shtatë ditësh çdo të mërkurë.


analizuar, BPRM nuk bëri ndryshime në normat e interesit të depozitave në dispozicion⁵⁷, dhe dinamika e këtyre instrumenteve kryesisht korrespondon me ndryshimet në likuiditetin e bankave nën ndikimin e faktorëve autonome. Kështu, gjatë goditjes në periudhën prill-maj vendosjet në depozitat në dispozicion prej shtatë ditësh shërbyen si linja e parë e mbrojtjes nga mungesa e likuiditetit. Gjatë rënies së madhe të gjendjes së llogarive, bankat më parë përdorën vendosjet në këto depozita, të cilat janë reduktuar në nivelin më të ulët në dy vitet e fundit. Me këtë ndryshim, i cili mundësoi sigurimin e shpejtë dhe efikas të bankave me likuiditet të mjaftueshëm me denarë, edhe një herë u konfirmua funksioni themelor i instrumentit për neutralizim të ndryshimeve afatshkurtra në aktivet likuide të bankave. Përveç mjeteve nga depozitat në dispozicion shtatë ditore, bankat përdorën gjithashtu kreditë në dispozicion njëditore⁵⁸ me qëllim të kompensimit të një pjese të likuiditetit afatshkurtër. Interesi për këtë instrument kishte vetëm një periudhë të shkurtër, me çka shumica mesatare e mjeteve të aprovuara në baza ditore ka qenë relativisht e vogël dhe ka arritur në 500 milionë denarë.

Grafiku 64
Gjendja mesatare e depozitave në dispozicion



Burimi: BPRM.

Grafiku 65
Dinamika e depozitave të disponueshme njëditore (mesataret) dhe rezerva e detyrueshme



Në gjysmën e dytë të vitit, duke pasur parasysh rritjen e vahdeshme të aktiveve likuide dhe mbajtjen e e bonove të thesarit në nivelin e njëjtë, bankat i kanë ripërtërirë investimet në depozita në dispozicion për shtatë ditë, të cilat në dhjetor kanë arritur nivelin më të lartë (11,475 milionë denarë) nga prilli i vitit 2015. Duke pasur parasysh pozicionin e qëndrueshëm të likuiditetit në këtë periudhë, bankat nuk kanë përdorur kredi njëditore.

Gjatë administrimit të likuiditetit në baza ditore, bankat gjithashtu përdorën depozitat e disponueshme njëditore. Në aspektin e dinamikës, në vitin 2016 nuk janë vërejtur ndryshime në këtë instrument, i cili përdoret më shumë në fund të periudhës së rezervave të detyrueshme, për shkak të reduktimit të mjeteve mesatare të tepërta në llogaritë mbi detyrimin e një niveli minimal.⁵⁹

⁵⁷ Norma e interesit për depozitat në dispozicion prej shtatë ditësh është 0.5%, ndërsa për mjetet e vendosura në depozitat në dispozicion njëditore aplikohet norma e interesit prej 0.25%.

⁵⁸ Norma e interesit për këtë instrument është më e lartë për 0.5 p.p. nga norma bazë e interesit të BPRM-së.

⁵⁹ Në vitin 2016 gjatë përmbushjes së rezervës së detyrueshme bankat aplikuan të ashtuquajturën strategji e mjeteve të tepërta likuide në fillim të periudhës. Zbatimi i kësaj strategjie për menaxhimin e likuiditetit në kombinim me grupin e instrumenteve monetare mundësuan menaxhimin efikas të likuiditetit nga ana e BPRM-së, me çka tepërca mesatare e mjeteve likuide mbi rezervën e detyrueshme në ditën e fundit të periudhave të rezervave të detyrueshme në vitin 2016 mbeti në nivel relativisht të ulët prej 1.1%.

5.2.3. Repo operacionet për krijimin e likuiditetit në sistemin bankar⁶⁰

Në vitin 2016, Banka Popullore zhvilloi ankande të rregullta javore për transaksionet repo. Në mënyrë tipike, bankat nuk kanë interes në përdorimin e fondeve përmes këtij instrumentit, me përjashtim të dy ankandeve gjatë tremujorit të dytë, të cilat mesatarisht janë miratuar aktivet likuide prej 1,350 milionë denarë. Në ankandet e mbetura në vitin 2016 oferta ishte vendosur në një nivel më të ulët (500 milionë denarë), ndërsa bankat nuk janë paraqitur me kërkesë për mjete likuide.

5.2.4. Depozitat në valutë me Bankën Kombëtare

Për të ruajtur dhe për të rritur depozitat e personave fizikë dhe juridikë në sistemin bankar vendas, në maj të vitit 2016 janë shqyrtuar dhe përmirësuar kushtet e instrumentit depozita në valutë të huaj në bankën qendrore.⁶¹ Në këtë drejtim, nga 13 maj të vitit 2016 BPRM përsëri ngriti mundësinë e vendosjes së një sasi të pakufizuar të depozitave në valutë të huaj nga bankat komerciale vendase me normat e interesit pak më të larta se normat negative të interesit që mbizotëronin në tregjet financiare ndërkombëtare. Niveli i favorshëm i normave të interesit për këtë instrument synonte uljen e kostove të bankave vendase dhe për pasojë sigurimin e një norme më të lartë interesi bankare për depozitat e personave juridik dhe fizik vendas.

Bankat kishin një interes relativisht të lartë në vendosjen e mjeteve në depozita në valutë të huaj në BPRM, gjendja gjithsej e të cilave në tetor të vitit 2016 arriti në 156.5 milionë euro. Duke marrë parasysh stabilizimin e depozitave në sistemin bankar, në fund të tetorit të vitit 2016 BPRM i ndërpreu ankandet e depozitave në valutë të huaj. Për më tepër, duke pasur parasysh se në shumën e depozitave në valutë të huaj ishin më të përfaqësuara vendosjet me maturitet prej gjashtë dhe dymbëdhjetë muaj, ata në periudhat deri në maturimin e tyre kanë efekte pozitive mbi shpenzimet e bankave.

5.2.5. Rezerva e detyrueshme

Në vitin 2016, përveç funksionit themelor për të menaxhuar me ofertën e parasë, rezerva e detyrueshme e bankave ende kishte një karakter të matur, me çka ky instrument me strukturën e tij akoma jep mbështetje në procesin e denarizimit dhe kursimit afatgjatë, si dhe për të stimuluar aktivitetin kreditues të sektorit të korporatave. Gjithashtu, në periudhën e goditjes jo-ekonomike edhe këtij instrumenti iu bënë ndryshime në përgjigje të rreziqeve në rritje. Kështu, për mbajtjen e mëtejshëm të prirjes së ulët të agjentëve ekonomikë për vendosjen e depozitave me klauzolë në valutë të huaj në bankat komerciale të vendit, në maj të vitit 2016 BPRM e ka ngritur normën për rezervë të detyrueshme për detyrimet në valutën vendase me klauzolën valutore, nga 20% në 50%.⁶² Kjo masë ka pasur një efekt të favorshëm mbi strukturën valutore të detyrimeve të bankave, duke pasur parasysh se menjëherë pas ndryshimit të depozitave në denarë me klauzolë në valutë kishte një prirje rënëse, dhe në fund të vitit e mbajti pjesëmarrjen e parëndësishme prej vetëm 0.4% të totalit të detyrimeve të bankave.⁶³


⁶⁰ Ankandet për sigurimin e likuiditetit për shtatë ditë kryhen një herë në javë, domethënë çdo të premte. Norma e interesit e këtij instrumenti është e barabartë me normën e interesit për bonot e e thesarit.

⁶¹ Më 5 maj të vitit 2016 u miratua Vendimi për depozitimin në valutë të huaj në Bankën Popullore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/16).


⁶² Normat e diferencuara të mbetura të rezervës së detyruar nga aspekti valutor dhe i maturimit janë mbajtur në të njëjtin nivel.

⁶³ Analiza e trendeve të detyrimeve të bankave bazohet në të dhënat mbi detyrimet e bankave të përfshira në bazën për llogaritjen e rezervës së detyrueshme.


Grafiku 66
Normat e rezervës së detyrueshme




Grafiku 67
Faktorët e ndryshimit në rezervën e detyrueshme në denarë



Grafiku 68a
Kontributi i sektorëve (në p.p.) ndaj rritjes vjetore të detyrimeve në denarë të bankave



Grafiku 68a
Kontributi i sektorëve (në p.p.) ndaj rritjes vjetore të detyrimeve në valutë të huaj të bankave




Burimi: BPRM.

Rritja vjetore e rezervës së detyrueshme në denarë (nga 1,110 milionë denarë në nivelin prej 18,407 milionë denarë)⁶⁴ ka ardhur kryesisht nga rritja e detyrimeve në denarë dhe në valutë të huaj të bankave. Për më tepër, prirjet e reduktuara të ekonomive familjare për kursim në valutën vendase, së bashku me rritjen e moderuar të depozitave në denarë të sektorëve të tjerë, kanë kontribuar prej rreth 600 milionë denarë ndaj rezervës së detyrueshme më të lartë në denarë. Megjithatë, rritja më e shpejtë e detyrimeve në valutë të huaj të bankave të udhëhequra nga ekonomitë familjare, por edhe nga sektori i korporatave më së shumti e kushtëzoi rritjen e rezervës së detyrueshme në denarë (me efekt prej rreth 1,090 milionë denarë). Prirja për kursim në valutë të huaj kontribuoi edhe në një rezervë të detyrueshme më të lartë në euro, e cila në vitin 2016 u rrit për 818 milionë denarë (në kundërvlerë) dhe në fund të vitit arriti në 14,080 milionë denarë.

⁶⁴ Rezerva e detyrueshme në denarë e bankave llogaritet si shumë e vlerës së përcaktuar nga detyrimet në valutën vendase, shuma e përcaktuar nga detyrimet në valutën vendase me një klauzolë të valutës dhe 30% të shumës së përcaktuar nga detyrimet në valutë të huaj.

Në vitin 2016 vazhdoi aplikimi i rezervës së detyrueshme për të nxitur mbështetjen e bankave për sektorët me rëndësi sistimore.⁶⁵ Poashtu, për dallim nga vitet e mëparshme kur këto kredi u rritën, në vitin 2016, pati një stabilizim të dukshëm të kredive për eksportuesit neto, si dhe lëvizje pozitive që kontribuuan në rritjen e mbështetjes kredituese për prodhuesit e energjisë elektrike. Këto kredi u rritën për 515 milionë denarë dhe kishin kontributin më të madh në rritjen vjetore të kredive për sektorët me rëndësi sistimore.


Grafiku 69
Qarkullimi në tregun sekondar të letrave me vlerë



Shtojcë 1. Lëvizjet në tregun e parasë⁶⁶


Në vitin 2016, bankat kishin aktivitet më të lartë të konsiderueshme në tregjet e parasë, e cila shpjegohet kryesisht nga zvogëlimi i likuiditetit në gjysmën e parë të vitit. Qarkullimi i përgjithshëm në tregun e parasë regjistroi rritje vjetore prej 78% dhe arriti nivelin historikisht më të lartë prej 62,045 milionë denarë. Rritja e kërkesës kryesisht korrespondon me rënien dhe nivelin relativisht më të ulët të aktiveve likuide të bankave në tremujorin e dytë dhe të tretë. Përshkak të financimit afatshkurtër, bankat së pari drejtoheshin në tregun ndërbankar të depozitave të pasiguruara, ku kontribut më të madh në rritjen vjetore prej 70% kishte tregtimi me depozita me afat maturimi prej një jave (me 50 pikë përqindje), dhe relativisht e lartë ishte edhe huamarrja e depozitave njëditore, të cilët morën pjesë me 20 pikë përqindje në rritjen vjetore të qarkullimit total.

Grafiku 70
Likuiditeti i tepërt dhe qarkullimi në treg në depozitat ndërbankare



Burimi: BPRM.

Grafiku 71
Struktura e maturitetit të qarkullimit me depozita të pasigurta




⁶⁵ Bëhet fjalë për eksportuesit neto dhe prodhuesit vendas të energjisë elektrike.

⁶⁶ Tregu i parasë në Maqedoni mbulon këto segmente: tregu i depozitave të pasiguruara, tregu sekondar i letrave me vlerë afatshkurtra dhe letrave me vlerë afatgjata, tregu i depozitave të siguruara (tregu-repo).

Një pjesë të mjeteve të nevojshme bankat i siguronin edhe në tregun sekondar, nëpërmjet shitblerjes së letrave me vlerë. Qarkullimi i këtij segmenti të tregut u rrit për 49%, me një rritje të lartë të tregtimit të bonove të thesarit. Ky ndryshim është për shkak të faktit se bankat në ankandet e bonove të thesarit merrnin pjesë me shumat maksimale të përcaktuara (në bazë të pjesëmarrjes në detyrimet në denarë të sistemit bankar), ndërsa më vonë gjatë periudhës së rezervave të detyrueshme janë financuar nëpërmjet shitjeve përfundimtare të bonove të thesarit bankave tjera. Rritja vjetore e tregtimit në tregun sekondar të letrave me vlerë u mbështet gjithashtu nga qarkullimi më i lartë (për rreth 30%) me letrat me vlerë të qeverisë. Ky ndryshim u mbështet nga diversifikimi i mëtejshëm i strukturës së pronësisë dhe vazhdimi i maturitetit mesatar të letrave me vlerë të qeverisë.

Grafiku 72
Qarkullimi në tregun sekondar të letrave me vlerë



VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore

Menaxhimi dhe investimi i rezervave në valutë të huaj të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: rezervave valutore) gjatë vitit 2016 është kryer në kushte të ndryshueshme si në tregjet financiare vendore, ashtu edhe në tregjet financiare ndërkombëtare. Më fillim të vitit, BPRM ka filluar zbatimin operacionale të qasjes së re për ndarjen e portofoleve të rezervave valutore në varësi të kërkesave për likuiditet dhe periudhës së investimeve, dhe në përputhje me sugjerimet e Bankës Botërore për rastet më të mira në menaxhimin e rezervave valutore. Kjo qasje e rishikuar dhe e përmirësuar siguron fleksibilitet më të lartë në menaxhimin e likuiditetit, që u konfirmua gjatë gjithë vitit. Domethënë, BPRM me sukses u përgjigj ndaj nevojës për të ruajtur stabilitetin e valutës vendase në tremujorin e dytë të vitit 2016, ndërkohë që në tremujorin e tretë dhe të katërt tregoi efikasitet të lartë duke investuar mjete nga emetimi i euroobligacionit të pestë të shtetit, si dhe duke shlyer detyrimet e papaguara të borxhit në bazë të borxhit të jashtëm të shtetit.

Investimi i rezervave valutore edhe gjatë vitit 2016 u përball me sfidat e ruajtjes së vlerës dhe gjenerimit të të ardhurave nga mjetet e investuara. Gjatë vitit 2016, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka vazhduar të rrisë likuiditetin e tregjeve financiare për të stimuluar aktivitetin ekonomik, duke çuar në një rënie të mëtejshme të rendimenteve të instrumenteve më të sigurta financiare, si dhe mbajtjen e të ardhurave në zonën negative në disa vende. Në rrethana të tilla, korniza për investime u zgjerua me mundësitë e tjera për investime që ofrojnë kthime pozitive dhe nivel të pranueshëm të kredisë dhe riskut të tregut. Gjithashtu, është zgjeruar investimi e maturiteteve më të gjata të investimeve të lakores së rendimenteve për investime në euro dhe dollarë amerikanë në portofolet deri në maturim, si dhe investimeve në kornizë të portofoleve të likuiditetit, në kufijtë e projektuar për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit. Investimet në valutat e tjera janë ndjekur në mënyrë aktive, dhe në kushte të pasigurisë së lartë në lidhje me perspektivat e ardhshme të ekonomisë britanike, pas miratimit të vendimit të Britanisë së Madhe për dalje nga BE, investimet në paundin britanikë ishin mbyllur. Investimet në dollarë australian dhe kanadez gjithashtu ishin mbyllur në fund të vitit, dhe një pjesë e mjeteve janë të drejtuar në tregjet e SHBA-së duke perceptuar rritje të mëtejshme të rendimenteve në të ardhmen. Të gjitha vendimet e investimeve gjatë vitit janë bërë në përputhje me objektivat themelore të investimeve për ruajtje të sigurisë dhe likuiditetit të rezervave valutore, vlera e të cilave është rritur si rezultat i përfitimit të investimeve.

6.1. Drejtimet themelore në menaxhimin me rezervat në valutë të huaj

Sipas përvojave dhe rekomandimeve të Bankës Botërore, në fund të vitit 2015 u përgatit Politika e re për menaxhim dhe investim të rezervave valutore (në tekstin e mëtejshëm: Politika) dhe ajo u miratua nga ana e Këshillit të BPRM si një kornizë strategjike për zbatimin e procesit të menaxhimit të rezervave valutore gjatë vitit 2016. Me politikën e re në mënyrë më të detajuar u përpunuan aspektet themelore të këtij funksioni të rëndësishëm të BPRM-së:

- Politika përfshinte një përkufizim më të gjerë të rolit themelor të rezervave valutore dhe qëllimet dhe objektivat e tyre specifike, që janë marrë parasysh gjatë menaxhimit dhe investimit. Duke filluar nga niveli i duhur i vlerësuar, dhe duke marrë parasysh të gjitha burimet e mundshme dhe përdorime të rezervave valutore, si dhe vlerësimin e cënueshmërisë makroekonomike ndaj goditjeve të jashtme, Politika

ofron udhëzime për ndarjen optimale të rezervave valutore në varësi të likuiditetit të tyre dhe periudhës së investimeve, të: portofolit operacionale, të likuiditetit dhe të investimeve;

- Në rrezikun kreditor si një risi është parashikuar vendosja e kriterit të vetëm për vlerësim më të ulët të pranueshëm të kredive prej BBB-/Baa3 për të gjitha investimet dhe palët kontraktuese;
- Për rreziqet e tregut është vendosur një koncept i ri për nivelin e pranueshëm të rrezikut i cili është përcaktuar si reduktim i mundshëm i përgjithshëm i rezervave valutore për një periudhë të caktuar të investimeve, që prezantoi një buxhet për rrezik si një nivel të pranueshëm të dështimit të kthimit, pavarësisht kthimit të portofoleve referuese. Nga ana tjetër, rreziku i supozuar i valutës kundër strukturës themelore të valutës kufizohet me nivelin e rezervave të rivlerësimit për këtë qëllim.

Duke u bazuar në kornizën e përcaktuar, janë miratuar Rregulla të reja për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja), me të cilën përcaktohen kriteret për përcaktimin e nivelit të portofoleve individuale të rezervave valutore, dhe gjithashtu përcakton llojet e instrumenteve sipas portofoleve. Me rregullat gjithashtu është përcaktuar edhe struktura bazë e valutës së huaj të rezervave valutore, në përputhje me udhëzimet e vendosura në Politikë. Në kuptim të rrezikut të normës së interesit, risia ishte përcaktimi i nivelit të pranueshëm për rrezikun e normës së interesit, dhe u bë ndarje midis rrezikut të marrë duke vendosur portofolin referentë dhe buxhetin e rrezikut për menaxhimin aktiv. Një risi në këtë segment ishte se krahas portofolit të investimeve në euro dhe dollarë amerikanë, u vendosën portofole referente edhe për portofolin operacionale dhe portofolin e likuiditetit në euro. Ke rreziku kreditor si një risi u parashikua zbatimi i rejtingut të kompozuar (rejtingu mesatar) nga agjencionet për vlerësim të kreditit: "Standard dhe Purs", "Mudis" dhe/ose "Fiç", që është përdorur për të përcaktuar kufirin e kreditit të emetuesit, institucionet financiare dhe/ose instrumentet financiare.

Komiteti i investimeve në përputhje me rolin e tij në realizimin e vendimeve taktike, miratoi Planin e investimeve i cili është i bazuar në ndarjen strategjik të rezervave valutore dhe mbulon kohëzgjatjen taktike të adaptuar të portofolit dhe strukturën valutore taktike të rezervave valutore.

Nga mesi i vitit, është rritur nevoja për gjetjen e mundësive për investime në kuadër të portofoleve në euro, që përfaqësonte një sfidë të jashtëzakonshme në drejtim të zgjerimit të mëtejshëm të gamës së rendimenteve negative në segmentet e lakores së rendimenteve. Në mënyrë që të sigurojë kushte më të favorshme për investime në rezervat valutore, në fillim të korrikut Këshilli në kuadër të Politikës miratoi rritjen e maturimit maksimal të letrave me vlerë në portofolin e investimeve të cilat janë të klasifikuara si letra me vlerë të mbajtura deri në maturim prej 7 deri në 10 vjet. Rrjedhimisht, Rregullorja rishikoi maturitetin maksimal të letrave me vlerë për tregtim në portofolin e likuiditetit, prej 3 deri në 10 vjet.

Komiteti i investimeve ka rivlerësuar shpërndarjen strategjike të rezervave valutore dhe i ka rritur kohëzgjatjet e adaptuara strategjike dhe taktike të portofolit të likuiditetit në euro dhe të portofoleve investive në euro dhe dollarë amerikanë. Në të njëjtën kohë, Komiteti i investimeve në përputhje me vendosmërinë për të drejtuar vendosjet në investime më të sigurta dhe për të rritur ekspozimin ndaj të ashtuquajturve "bërthama e eurozonës", bëri një auditim më të detajuar të emetuesve të letrave me vlerë dhe llojet e instrumenteve në të cilat mund të kanalizohen disa nga investimet. Ndryshimet mundësuan përzgjedhje të zgjeruar të instrumenteve dhe rrjedhimisht, mundësi më të gjera për investime në mjetet e denominuara në euro.


6.2. Kushtet për investim në tregjet financiare ndërkombëtare në vitin 2016

Nga aspekti i tregjeve financiare ndërkombëtare, viti 2016 ishte një vit i surprizave nga shumë aspekte. Momentet më të rëndësishme që e pasqyrojnë vitin janë: "Breksit", zgjedhjet presidenciale amerikane dhe zgjedhja e administratës së re me ndryshim të fokusit nga politika monetare në politikën fiskale, marrëveshja e shteteve anëtare të OPEK-ut për të reduktuar prodhimin e naftës dhe performanca e përmirësuar ekonomike në zonën e euros në gjysma e dytë të vitit. Në këtë mënyrë, tregjet e aksioneve, obligacioneve dhe produktet e mallrave përjetuan lëvizje të ndryshueshme të cilat ishin një pasqyrim i ndryshimeve në bazat ekonomike, si dhe të ndryshimit në prirje të investitorëve për të ndërmarrë rreziqe.


Në fillim të vitit, tregjet financiare ndërkombëtare janë përballur me luhatshmëri të larta të shkaktuara nga shqetësimet për rritjen e ardhshme të Kinës, por edhe për ekonominë globale, si dhe me rënien e fortë të çmimeve të naftës, që kontribuuan për ruajtjen e pritjeve për çmime të ulëta.

Grafiku 73

Luhatshmëria e çmimeve të aksioneve (VIX)⁶⁷



Ndryshimet në rendimentet e obligacioneve qeveritare amerikane dhe evropiane (në p.p.)



Në përgjigje të pritjeve të ulëta të inflacionit dhe rritjes së pasigurisë ekonomike, BQE njoftoi një paketë gjithëpërfshirëse masash lehtësimi në takimin e marsit.⁶⁸ Në të njëjtën kohë, në kushte rritjes ekonomike të ngadalësuar në ekonominë amerikane në gjysmën e parë të vitit, banka qendrore amerikane tregoi se nuk parashikon shtrëngim të shpejtë të kushteve monetare, të cilat shkaktuan një rënie të rendimenteve të letrave me vlerë qeveritare edhe në SHBA dhe në eurozonë. Këto trende janë përforcuar nga mesi i vitit kur pas votimit të vendimit të Mbretërisë së Bashkuar për dalje nga Bashkimit Evropian, është rritur averzioni për të marrë risk dhe si pasojë, pjesëmarrësit e tregut janë orientuar drejt instrumenteve me siguri të lartë. Rendimentet e Eurozonës mbetën në nivel të ulët deri në fund të vitit, me çka kontribuuan masat e mëtejshme të BQE-së për lehtësimin monetar. Gjegjësisht, në përputhje me njoftimet në periudhën e mëparshme, në dhjetor BQE miratoi


⁶⁷ Indeksin VIX e publikon bursa në Çikago (Chicago Board Options Exchange), dhe paraqet një masë për luhatshmërinë e nënkuptuar të opsioneve në indeksin e S dhe P 500 (S&P 500). Shpesh quhet indeksi i "frikës" në mesin e investitorëve dhe është një tregues i pritjeve të tregut të luhatshmërisë në tregjet e aksioneve në 30 ditët e ardhshme.

⁶⁸ Paketa e re e masave për të liruar parashikoi uljen e normave të interesit, duke rritur blerjen mujore të letrave me vlerë nga 60 deri në 80 miliardë euro, në prill të vitit 2016 (me përfshirjen edhe të letrave me vlerë korporative jobankare të borxhit nga eurozona me vlerësim të investimeve, duke filluar nga tremujori i dytë i vitit) dhe realizimin e katër operacioneve shtesë për targetim të operacioneve për rifinancim afatgjatë (TLTRO II) me kushte të favorshme.


një sërë masash për mbështetje të mëtejshme monetare⁶⁹ edhe në vitin 2017, që kushtëzoi një rënie të rendimenteve të obligacioneve qeveritare me maturim prej dy vjetësh.

Nga ana tjetër, rendimentet e letrave me vlerë të borxhit evropiane në segmentin prej 5 deri në 10 vjet shënuan një korigjim rritëse në tremujorin e fundit, nën ndikimin e rritjes së rendimenteve të letrave me vlerë të qeverisë amerikane. Pavarësisht vazhdimësisë së normalizimit të kushteve monetare⁷⁰, në SHBA rritja e rendimentit është ndikuar nga rezultati i zgjedhjeve presidenciale, me çka u rritën pritjet për ekspansion fiskal dhe u forcuan pritjet për inflacion.⁷¹ Pritjet e forcuara për rritje të mëtejshme të interesit të prekura nga shtrëngimi i kushteve monetare nga ana e FED-it kontribuan edhe në forcimin e kursit të këmbimit të dollarit amerikan.

Grafiku 74
Çifti valutor EUR/USD



Grafiku 75
Çmimi i arit (ons/dollarë amerikanë)



Lëvizja e çmimeve të arit e ndoqi intensitetin e averzionit ndaj riskut të pjesëmarrësve të tregut. Kështu, në gjysmën e parë të vitit, çmimi i arit u rrit deri në 1,370 dollarë amerikanë për ons, dhe gjatë votimit të vendimit të Mbretërisë së Bashkuar u forcua pasiguria në lidhje me perspektivën ekonomike në nivel global. Pas stabilizimit të vrojtimeve të tregut, në tremujorin e fundit të vitit, çmimi i arit ka shënuar një korigjim në rënie paralelisht me forcimin e pritjeve të tregut të një rritjeje në normat e interesit në SHBA në disa raste, si përgjigje të paralajmërimeve për mbështetëse fiskale të përforcuar nga politikat e presidentit të sapo-zgjedhur amerikan. Megjithatë, në fund të vitit 2016 çmimi i arit ishte 1,159.1 dollarë amerikanë, që është rreth 9.12% më shumë në krahasim me fundin e vitit të kaluar. Gjatë vitit kërkesa për arin nga ana e bankave qendrore ka rënë për 33%, krahasuar me një vit më parë. Në fakt, bankat qendrore në bazë neto kanë blerë 384 ton, që është niveli më i ulët që nga viti 2010 e këndeje. Bankat qendrore të Rusisë, Kinës

⁶⁹ Është vendosur që të vazhdojë blerja e letrave me vlerë të paktën deri në fund të vitit 2017, por pas marsit të vitit 2017 shuma totale prej 80 miliardë euro në muaj të zvogëlohet në 60 miliardë euro, për shkak të rreziqeve të reduktuara të deflacionit. Kështu që, BQE parashikoi që shlyerja të bëhej në periudhë prej nëntë muajve shtesë, dhe jo vetëm gjashtë muaj siç pritej më parë. Gjithashtu, BQE ka vendosur të heqë dorë nga kufizimi për blerjen e letrave me vlerë rendimenti i të cilëve është nën nivelin e normës së depozitave, me çka BQE nuk e trajton këtë ndryshim si një domosdoshmëri, por si një mundësi. Ndër të tjera, BQE e zhvendosi limitin për maturimin e mbetur minimal të letrave me vlerë që i blen nga dy në një vit.

⁷⁰ Në dhjetor, banka qendrore e SHBA-së vendosi të rriste intervalin e normave të interesit për 25 pikë bazë. Kjo ishte rritja e dytë në ciklin e fillimit pas vendimit për të rritur normat e interesit në dhjetor të vitit 2015.

⁷¹ Çmimi i naftës kontriboi në rritjen e presioneve të çmimeve, të cilat, në pritje të takimit të OPEK-ut, u shënuan rritje, dhe pas arritjes së marrëveshjes, ajo u stabilizua në një nivel më të lartë. Në takimim në Vjenë midis vendeve të prodhimit të naftës OPEK (dhe më pas me vendet që nuk janë anëtare të OPEK-ut), u arrit një marrëveshje për të reduktuar prodhimin e naftës që nga 1 janari i vitit 2017. Çmimi i naftës u rrit nga 47.7 në 55.4 dollarë amerikanë për fuçi deri në fund të tremujorit.

dhe Kazakistanit i kanë rritur rezervat e tyre në ar gjatë vitit, ndërsa blerja ar nga banka qendrore e Kinës, u ndal në nëntor dhe dhjetor, për shkak të nevojës për ndërhyrje në tregun e valutës së huaj në rrethana të daljes së kapitalit nga ekonomia. Gjithashtu, disa banka të tjera qendrore i kanë reduktuar rezervat e arit si Venezuela, Azerbajxhani, Argjentina dhe Jordania.⁷²

6.3. Investimi në rezerva valutore

6.3.1. Shpërndarja e investimeve sipas portofoleve


Shpërndarja e rezervave valutore sipas portofolave merr në konsideratë detyrimet dhe qëllimet e ndryshme të rezervave valutore në periudha të ndryshme kohore. Në këtë kuptim, rezervat valutore janë shpërndarë në portofolin operativ, të likuiditetit dhe të investimeve, varësisht nga likuiditeti i tyre dhe periudha e investimit. Risia në këtë shpërndarje është ndarja e portofolit operativ, i cili konceptualisht më parë ishte pjesë e portofolit të likuiditetit, ndërsa e njëjta formohet për shkak të mënyrës më aktive të monitorimit dhe menaxhimit me flukset monetare nga rezervat valutore. Pikënisja bazë për përcaktimin e vlerës së tij janë parashikimet e shumës mujore të daljeve në llogari të shtetit, ndërhyrjet e Bankës Popullore në tregun e këmbimit valutor dhe mjetet për të lehtësuar përfundimin dhe shlyerjen e transaksioneve në rezervat valutore. Portofoli i likuiditetit duhet të mbulojë nevojat për të plotësuar portofolin operativ dhe e përcakton nivelin e daljeve të planifikuara për 12 muajt e ardhshëm. Në portofolin operativ dhe të likuiditetit janë më të përfaqësuarat eurot, si valuta më të cilën janë kryer pjesa dërmuese e pagesave dhe transaksioneve të tregut të këmbimit valutor. Nga ana tjetër, për të rritur fleksibilitetin në menaxhimin e portofolit të likuiditetit dhe për të realizuar të ardhura më të larta, ajo mund të investohet edhe në dollarë amerikanë, si dhe në valuta të tjera, të cilat ishin në kuadër të portofolit të investimeve në periudhën e kaluar, dhe që nga fillimi i vitit janë bërë pjesë e portofolit të likuiditetit. Teprica e mjeteve në valutë të huaj, pas plotësimit të nevojave për likuiditet, orientohen për investime në kuadër të portofolit të investimeve të përbërë nga euro dhe dollarë amerikanë, ku është i inkorporuar edhe portofoli i letrave me vlerë deri në maturim.

Mënyra e re e menaxhimit të likuiditetit mundësoi që BPRM t'iu përgjigjet në mënyrë efektive nevojave për përdorimin e rezervave valutore në tremujorin e dytë të vitit, dhe gjatë tremujorit portofoli operativ u plotësua me mjete të tilla si portofoli i likuiditetit në euro, si dhe nga portofoli i investimeve për tregtim në euro.

Për dallim të tremujorit të dytë, kur rezervat shënuan rënie, gjatë tremujorit të tretë disa faktorë kanë kontribuar në rritjen e tyre të rëndësishme, me çka gjatë shpërndarjes së investimeve është bërë transferimi i mjeteve nga operacionale në portofolin e likuiditetit dhe të investimeve, në varësi të vlerësimeve për periudhën në dispozicion me mjete nga hyrjet. Gjithashtu, duke pasur parasysh flukset hyrëse të mjeteve nga investimet në depozitat valutore të bankave në BPRM, është rritur niveli i detyrimeve potenciale në 12 muajt e ardhshëm (në bazë të ndryshueshme), e cila kushtëzon mirëmbajtje të një niveli më të lartë të portofolit të likuiditetit.


⁷² World Gold Council, Gold Demand Trends Full Year 2016, 3 Feb. 2017.

Grafiku 76
 Faktorët e ndryshimit të rezervave valutore
 në milionë euro



Burimi: BPRM.

Grafiku 77
 Portofolat e rezervave valutore
 niveli mesatar, në milionë euro



Në tremujorin e fundit të vitit, rezervat valutore janë zvogëluar, kryesisht për shkak të pagesës së detyrimeve të papaguara në bazë të kredisë komerciale të qeverisë dhe detyrimeve të tjera në bazë të borxhit të jashtëm, si dhe për daljet në bazë të depozitave të bankave në valutë të huaj, në kushte të ndërprerjes së mundësisë për vendosje të mëtejshme në BPRM. Këto dalje janë mbuluar pjesërisht nga flukset hyrëse të mjeteve për shkak të ndërhyrjeve të vazhdueshme për blerjen të valutës së huaj me bankat mbështetëse dhe për shkak të rritjes së vlerës së mjeteve në dollar në kuadër të rezervave valutore. Për shlyerjen e rregullt të detyrimeve ndaj jashtë është siguruar likuiditeti në kuadër të brenda portofolit operativ, i cili u plotësua nga portofoli i likuiditetit dhe portofoli i investimeve në euro.

Në bazë vjetore rezervat valutore u rritën për një total prej 351.7 milionë euro, me çka afërsisht gjysma e kësaj rritjeje ishte për shkak të transaksioneve të shtetit, ku kryesisht janë më të përfaqësuara hyrjet e mjeteve në bazë të euroobligacionit të emtuar. Për rritjen e rezervave valutore kontribuuan edhe faktorë dhe në këtë kuadër ndikimi më i rëndësishëm është nga depozitat në valutë të huaj të bankave në BPRM⁷³, si dhe rritja e vlerës së tregut të rezervave për shkak të rritjes së vlerës së arit dhe valutave të tjera të investimeve. Për rritjen e rezervave në vitin 2016 kontribuojnë edhe intervenimet në tregun e këmbimit valutor (blerje neto në vlerë prej 16.5 milionë euro), si pasojë e blerjeve të vazhdueshme në gjysmën e dytë të vitit që plotësisht i kompensuan shitjet e valutës së huaj nga fillimi i vitit dhe veçanërisht në periudhën prill-maj.


6.3.2. Ekspozimi kreditor dhe instrumentet

Siguria e investimeve të rezervave valutore ka një rëndësi të madhe në përcaktimin e strategjisë së investimeve të BPRM. Në përputhje me kornizën e investimeve të parashikuara, pjesa më e madhe e rezervave valutore ose mesatarisht rreth 74% janë investuar në instrumente financiare me vlerësime më të larta të klasifikimit të kredive (nga

⁷³ Bankat gjatë verës kanë shënuar rritje të likuiditetit në valutë të huaj si rezultat i lëvizjeve të zakonshme sezonale, me çka e shrytëzuan dobinë në instrumentin e depozitave në valutë të huaj, përkatësisht mundësinë e vendosjes në nivele më të ulëta, por norma pozitive të maturiteteve më të gjata se 6 muaj. Në kushtë të lëvizjeve të vazhdueshme të favorshme në tregun e këmbimit valutor që tregon drejt stabilizimit të pritjeve të agjentëve ekonomikë pas tronditjes nga prilli dhe maji, më 28 tetor BPRM ndaloi me mbajtjen e ankandëve të depozitave në valutë të huaj, ndërsa mjetet e vendosura më parë janë paguar në datën e maturimit. Shuma totale e depozitave në valutë të huaj në fund të vitit 2016 arrin në 74.5 milionë euro, të cilat duhet të paguhet në vitin 2017.


AAA në AA-), apo me ekspozimin më të ulët ndaj rrezikut të kredisë. Për të balancuar parimin e ruajtjes së vlerës në kushtet e përfitimeve të ulëta dhe negative, disa nga investimet e rezervës valutore gjithashtu kanë synuar dhe instrumente të cilat janë të klasifikuara nga A + në A-, të cilat karakterizohen gjithashtu me një nivel të lartë të sigurisë, por që sigurojnë një kthim pozitiv të moderuar të asetëve. Në këtë mënyrë, pa u nisur nga parimi i sigurisë, BPRM kërkon të arrijë një kthim të arsyeshëm të investimit përmes një menaxhimi aktiv dhe të kujdesshëm të rezervave valutore, në kushte të kontrollit të rrezikut në mënyrë të rreptë.

Grafik 53
Struktura mesatare e investimeve sipas vlersimit kreditor



*në kategorinë tjera janë të klasifikuara FMN dhe BIS Burimi: BPRM.

Grafik 54
Struktura gjeografike mesatare e investimeve




*IFN dhe BZHM – institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat zhvillimore multilaterale

Nga aspekti gjeografik, një pjesë e konsiderueshme e investimeve të rezervave valutore janë të drejtuara në ekonomitë e eurozonës, por përfitimet e ulëta në tregjet evropiane të instrumenteve me përfitime fikse dhe nevoja për të kërkuar përfitime kërkojnë ekspozim të moderuar më të lartë dhe ndaj ekonomive të tjera në eurozonë dhe Unionin Evropian. Investimet në instrumente nga emetuesit e letrave me vlerë në dollarë amerikanë në dy vitet e fundit kanë një përfaqësim relativisht të lartë për sa i përket shpërndarjes gjeografike të investimeve. Kjo shtrirje në dollarë amerikan është për shkak të mundësive për investime të rezervave valutore në instrumente të sigurta por dhe të cilat njëkohësisht kanë gjasa për një kthim më të favorshëm të investimeve, duke pasur parasysh ciklin e filluar të rritjes së normave të interesit në tregun e SHBA-së.

Duke pasur parasysh se letrat me vlerë janë të përfaqësuara si në investime portofolio ashtu dhe në atë të likuiditetit, këto instrumente financiare kanë një pjesëmarrje mesatare prej 78.4%, dhe janë më të përfaqësuara në strukturën e rezervave valutore për instrument. Fokusimi në parimin e sigurisë së investimeve të rezervës valutore, e kombinuar me mbajtjen e një niveli adekuat të likuiditetit vërehet dhe tek struktura e instrumenteve financiare. Gjegjësisht, tek letrat me vlerë vërehet rritje e moderuar e cila është regjistruar në investimet në letra me vlerë të qeverisë dhe letra me vlerë me garanci shtetërore, të cilat marrin pjesë me 70.5% mesatarisht, në investimet në rezervat valutore në letra me vlerë (1.4 pp më shumë në raport me vitin 2015). Me qëllim që të mbahet rreziku i normës së interesit në kornizat e parashikuara në portofolion e likuiditetit në euro, investimet afatgjata në letra me vlerë shtetërore kombinohen me investime në letrat komerciale afatshkurtër dhe certifikatat e depozitave të lëshuara nga bankat e huaja komerciale të klasit të parë, të cilat ofrojnë fleksibilitet në kushte të nevojës për likuiditetit. Pjesëmarrje më të konsiderueshme (11.5%) kanë pasur investimet në letrat me vlerë të cilat kanë mbështetje të pritur të shtetit, të cilat përveç nivelit të lartë të sigurisë gjithashtu sigurojnë një përfitim më të lartë


në lidhje me letrat me vlerë të qeverisë. Një pjesë e vogël e investimeve është drejtuar në letra me vlerë të lëshuara nga organizatat⁷⁴ shumëpalëshe me një përqindje mesatare prej 7.1% në letra me vlerë, dhe në letrat me vlerë të emetuara nga qeveritë rajonale të Gjermanisë, Australisë dhe Kanadasë (me një pjesë mesatare prej 7.7%).

Grafik 55
Struktura e investimeve mesatare vjetore për instrument



Burimi: BPRM.

Grafik 56
Struktura sipas llojeve të letrave me vlerë në fund të muajit



Një pjesë e rezervave valutore është ruajtur edhe në llogaritë rrjedhëse (mesatarisht rreth 6.2%), ku faktikisht janë fondet nga portofoliot operative. Për të optimizuar kostot, përveç llogarive në bankat qendrore një pjesë e fondeve mbahen edhe në llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja tregtare. Në bankat komerciale të huaja janë deponuar depozita⁷⁵ edhe brenda portfolios investuese dhe likuiduese, me çka pjesëmarrja e tyre është reduktuar në mënyrë të moderuar (nga një mesatare prej 7% në vitin 2015, në 4.8% në vitin 2016), kryesisht për shkak të rritjes së rezervave valutore si dhe vendosjen e disa prej depozitave në instrumente të tjera të tregut të parësë (certifikatat e depozitave, faturave komerciale dhe qeveritare).

Brenda strukturës së rezervave valutore, pjesa e arit është rritur pak, nga 10% në vitin 2015 në një mesatare prej 10.3% në vitin 2016, për shkak të rritjes së çmimit të saj në tregjet ndërkombëtare me 9.1%, por ndikim ka pasur gjithashtu edhe nga rritja e moderuar e shumës së arit brenda rezervave valutore. Në fakt, që nga viti 2005 kur është arritur shuma përfundimtare e arit (20,498 ons) nga trashëgimia e arit nga ish-Jugosllavia dhe monetizimi i arit nga Thesarit i Bankës Qendrore në vitin 2006 (2,634 ons), kjo paraqet rritjen e parë që është vërejtur pas një kohë të gjatë. Kjo është për shkak të zbatimit të vendimit të Qeverisë për të kthyer monedha jubilarë në ari monetar, si dhe duke e kthyer pjesët e konfiskuara në ari të transferuara nga Agjencia e Republikës së Maqedonisë për menaxhim me pronën e konfiskuar edhe në ar monetar. Kështu, sasia e arit u rrit në 2,288.06 ons, d.m.th. nga 218,875.84 ons u rrit në 221,163.91 ons, që mundësoj rritje të rezervave valutore në vlerë prej 2.44 milionë euro.

Ari, i cili zakonisht paraqet një instrument financiar me një përfitim më të ulët në treg, gjatë vitit ishte plasuar në depozita afatshkurtra tek bankat e huaja komerciale të klasit të parë. Duke pasur parasysh atraktivitetin e dollarit amerikan dhe shkallës së lartë të arit, u

⁷⁴ Banka investuese Euroeane (BIE), Banka e zhvillimit e këshillit europeane (COE), Kompania europeane për financimin e hekurudhave (EUROFIMA), Banka ndërkombëtare për zhvillim dhe rikonstruim (IBRD), Korporata financiare ndërkombëtare (IFC), Banka investuese nordeze (NIB), Banka zhvillimore aziatike (ADB), Banka zhvillimore interamerikane (IADB).

⁷⁵ Investimen të depozita në kuadër të porfoliove investuese janë të kufizuara në afat për jo më shumë se një vit.

fillua dhe me nënshkrimin e kontratave swap në ari⁷⁶ me disa nga palët kontraktuese që Banka Qendrore ka lidhur marrëveshje ISDA⁷⁷. Në transaksionet që BPRM ka realizuara gjatë vitit 2016, u realizua plasimi i dollarit amerikan dhe njëkohësisht u realizua marrje e një kredi-je prej ari (me datën e valutës) dhe duke marrë përgjegjësinë për kryerjen e një transaksioni të kundërt për 1 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës derivative. Njëkohësisht, ari i marë si kolateral plasohet si depozitë me ndonjë prej palëve me kualitetit të lartë, për të njëjtën periudhë për të cilën janë të plasuarat dollarët amerikanë.

Nga operacionet e tjera me rezerva valutore, Banka Qendrore ka vazhduar duke përdorur operacionet e huazimit të letrave me vlerë, duke nënshkruar transaksione repo dhe transaksione repo të kundërta njëkohësisht. Për shkak të rimbursimit të një pjese të shpenzimeve lidhur me mbajtjen e llogarive tek palët kontraktuese dhe deponuesit e letrave me vlerë, u vazhdua me përdorin e shërbimeve të deponuesit për huazim automatike të letrave me vlerë, nga portofoli i Bankës Qendrore të ruajtura tek deponuesi përkatës. Në kontekstin e kostos së mbajtjes së llogarive dhe evidentimin e portofolit të letrave me vlerë tek depozituesit ndërkombëtare, gjatë vitit 2016, në bazë të analizës së bërë më parë janë ndërmarrë aktivitete për konsolidimin e portfolios të letrave me vlerë ndaj njërit nga depozituesit ndërkombëtare, i cili ka ofruar një normë më të ulët për shërbimet. Me këtë është kontribuar në uljen e shpenzimeve të BPRM-së për mbajtjen e llogarive dhe regjistrimeve të portfolios të letrave me vlerë te depozituesit ndërkombëtarë.

6.3.3. Struktura e valutave⁷⁸


Ndarja sipas monedhave është realizuar me respektimin e duhur të angazhimit themelor strategjik për strukturën e monedhës së rezervave valutore, dhe me funksion kryesor të disponimit të mjeteve për të mbështetur strategjinë monetare me synimin e kursit të këmbimit. Rrjedhimisht, asetet e investuara në instrumentet financiare të shprehura në euro janë më të përfaqësuara brenda rezervave valutore, me një peshë mesatare prej rreth 56%. Megjithatë, duke pasur parasysh kushtet shumë të pafavorshme të tregut në tregjet evropiane, ku është vërejtur edhe më tej rënie të përfitimeve dhe në përputhje me ndarjen taktike të investimeve, një pjesë e rëndësishme e rezervave valutore janë investuar në instrumente financiare të shprehura në dollarë amerikanë. Pjesëmarrja e këtyre investimeve në strukturën e monedhës ishte mesatarisht 38.1%, gjatë vitit 2016 është rritur për rreth 5.8 p.p. krahasuar me vitin 2015. Kjo rritje justifikohet duke pasur parasysh ciklin e rritjes së normave të interesit në tregjet amerikane.

⁷⁶ Shkëmbimi me ari përbën një marrëveshje derivative në të cilën dy palët kontraktuese bien dakord të shkëmbejnë arin me një monedhë të caktuar (dollarë amerikan) në një datë të caktuar dhe njëkohësisht të kryejnë transaksionin e kundërt në një datë të ardhshme. Në këtë mënyrë, bëhet një hua e siguar.

⁷⁷ Marrëveshja ISAA është një marrëveshje kornizë ndërkombëtare e cila është e detyrueshme për të lidhur ndërmjet palëve kontraktuese që kryejnë transaksione në valutë të huaj dhe derivativë. BPRM ka nënshkruar këtë lloj kontrate me pesë palë kontraktuese: "Natixis,, "Societe Generale,, "Toronto Dominion Bank,, "Commerzbank,, dhe "BNP Paribas, (BNP Paribas).


⁷⁸ Struktura e valutës analizohet në raport me gjendjen e rezervave valutore të reduktuara me sasinë e arit.

Grafik 57
Struktura valutore e rezervave valutore
Fundi i muajit



Burimi: BPRM.

Mesatarisht në bazë vjetore



Gjatë vitit 2016, BPRM monitoroi në mënyrë aktive performancën e investimeve në monedha të tjera. Në fund të tremujorit të dytë, pas vendimit për referendum për largimin të Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian investimet në Funtën britanike⁷⁹ u rishikuan. Duke marrë parasysh informacionet aktuale të cilat vunë në pah perspektivat e pasigurta për ekonominë britanike dhe rreziqet për ulje nga uljet shtesë të vlerës së Funtës britanike, BPRM mbylli investimet e saj në Funtën britanik në qershor. Në fund të korrikut, në pritje të një vendimi nga banka qendrore e Australisë për të ulur normën bazë të interesit, pozicioni i dollarit australian gjithashtu u mbyll ndërsa u rrit ekspozimi ndaj dollarit amerikan. Deri në fund të vitit, në përputhje me përcaktimin për rritjen e ekspozimit ndaj dollarit amerikan, në kurriz të zvogëlimit të ekspozimit ndaj valutave të tjera të investimit, investimet në dollarë kanadezë gjithashtu u mbyllën.

6.3.4. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit dhe rezultateve nga investimi i rezervave valutore

Plasimi dhe investimi i rezervave valutore ishte kryesisht në letra me vlerë të cilat bartin të ardhura nga interesi dhe kuponat, por janë të ekspozuara edhe ndaj ndryshimeve në çmimet e tregut, pra në përfitimet rrjedhëse. Ky ekspozim ndaj rrezikut të normës së interesit kontrollohet duke përcaktuar kohëzgjatjen bazike të adaptimit dhe ruajtjen e disa letrave me vlerë deri në datën e maturimit të tyre. Menaxhimi i riskut të normës së interesit, përveç përmes kohëzgjatjes së modifikuar monitorohet dhe në kontekst të kufizimit të një niveli të pranueshëm të rrezikut të normës së interesit⁸⁰, i cili gjatë vitit u mbajt në kornizat e parapara, që tregon për vendosjen e duhur të strategjisë së investimeve.

Rezultatet nga investimi i rezervave valutore kryesisht ndërlidhen me kushtet e tregut në kohën e investimeve, si dhe kthimin e portofoliove referuese⁸¹, që shërbejnë si një udhëzues për investime. Portofolio operative, duke pasur parasysh nevojën për të ruajtur asetet në euro, ka një ndikim negativ në të ardhurat nga investimi i rezervave valutore në një nivel që është përafërsisht me nivelin e portofolit referuese. Portfolio e likuiditetit në euro e cila është investuar plotësisht në instrumente kreditore me përfitim pozitiv ka pasur një normë negative të kthimit për shkak të rritjes të premise të kredisë në tremujorin e

⁷⁹ Gjatë vitit 2016, funta britanike ka patur rënje kundrejt euros për 16%.


⁸⁰ Niveli i pranueshëm i rrezikut të normës së interesit sipas politikave të menaxhimit dhe investimeve të rezervave valutore është e kufizuar në probabilitetin e uljes së vlerës së tregut të rezervave valutore deri në 1% në një nivel besueshmërie prej 95% gjatë një periudhe investimi njëvjeçar.

⁸¹ Indeksi i çmimeve të referencës së letrave me vlerë dhe indeksi i tregut të parasë, i përbërë nga instrumenta financiarë realë me kohëzgjatje të rregulluar që korrespondon me rregullimin e kohëzgjatjes së rregulluar bazë të portofolio investimeve


fundit të vitit. Nga ana tjetër, portfolio investuese në dollarë amerikanë dhe euro ka patur norma relativisht të mira kthimi, të cilat janë mesatarisht më të larta se indekset referues.

Grafiku 58

Vlera e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit (fondi i tremujorit, në milionë euro)



Shkalla e kthyeshmërisë së portofolit të





Burimi: BPRM.

Për të zvogëluar ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit, disa nga letrat me vlerë të investuara brenda rezervave valutore regjistrohen si letra me vlerë të mbajtura deri në maturim, të cilat sipas karakteristikave të tyre kanë një kthim të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm. Gjatë tremujorit të tretë, një pjesë e të hyrave nga Eurobondet u shpërndanë dhe u investuan në portofolin deri në maturim në euro dhe dollarë amerikanë, me çka shuma totale e tyre u rrit në nivel deri në rreth 650 milionë euro dhe arriti në 25% të rezervave valutore.

Grafiku 59

Karakteristikat e portfolios deri në maturim



*HTM (Held-to-maturity) – letra me vlerë deri në maturim
Burimi: BPRM.

Në portofolin deri në maturim në euro, periudha e mbetur e maturimit të portofolit është rritur ndjeshëm, duke pasur parasysh shkallën e ulët të kthimit të investimit. Këto karakteristika janë në përputhje me angazhimin për të rritur pjesën e investimeve në obligacione qeveritare të vendeve të euro zonës, dhe duke marrë parasysh parimin e sigurisë. Dhe në portofolin në maturim në Shtetet e Bashkuara, mjetet e reja të future në masë të madhe kanë qenë të orientuara kryesisht në obligacione qeveritare të Shteteve të

Bashkuara, të investuara në periudha trevjeçare sipas lakores së përfitimeve, me norma relativisht të favorshme të kthimit. Pavarësisht nga rritja e moderuar e maturim të mbetur të investimeve, këto fonde janë investuar në një periudhë relativisht më të shkurtër ndërsa në maturim do të mundë të riinvestojmë me norma më të larta të kthimit, në përputhje me pritshmëritë për rritje të interesit në Shtetet e Bashkuara.

Shkalla e përgjithshme e kthimit të rezervave valutore në vitin 2016, e cila përveç të ardhurave të përfituara përfshin dhe ndryshimet e llogaritura në çmime nga kursi i këmbimit, i cili ka qenë 0.72%, dhe që është përafërsisht në të njëjtin nivel si në vitin 2015 (0.74%).

Shtojca 2. Aktivitete të lidhura me ngritjen e kapacitetit institucional gjat menaxhimit me rezervat valutore

Gjatë vitit 2016, vazhduan aktivitetet e Bankës Qendrore në kuadër të bashkëpunimit me Bankën Botërore (PKMRH - programi këshillues për menaxhimin e rezervave të huaja) dhe u mbajtën dy misione pune me ekspertë nga Banka Botërore në të cilat janë konsideruar modelet për rreziqet e buxhetimit dhe janë prezantuar strategjitë për përmirësimin e investimit të rezervave valutore. Gjithashtu, në tremujorin e tretë, përfunduan aktivitetet për mundësin e aplikimit të kontratave fjuçers brenda portofolit të menaxhuar nga Banka Botërore ndërsa në fund të muajit shtator u përfunduan dhe transaksionet e para.

Me rekomandimin e Bankës Botërore, në tremujorin e fundit të vitit 2016, Banka Qendrore ka filluar negociatat me një bankë të huaj për vendosjen e bashkëpunimit në fushën e tregtimit me kontrata fjuçers, ku kjo bankë i është përgjigjur pozitivisht kësaj kërkesë. Pritet që fazat e mëtejshme të themelimit të këtij bashkëpunimi të përfundojë deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2017 dhe në periudhën e ardhshme do të fillohet me përdorimin në mënyrë aktive të këtyre instrumenteve dhe derivateve në menaxhimin e rezervave valutore.

Në të njëjtën kohë, është vazhduar me ngritjen e kapaciteteve institucionale në BPRM, përmes vizitave të punonjësve të përfshirë në procesin e investimit të rezervave valutore në punëtori të specializuara të organizuara nga Banka Botërore. Këto vizita janë përdorur për shkëmbimin e përvojave me ekspertët e Bankës Botërore dhe përfaqësues të bankave qendrore në nivel global, të cilat janë anëtare e programit të Bankës Botërore, që është shumë e rëndësishme për të mbajtur një nivel të lartë të efikasitetit, profesionalizmit dhe cilësisë së burimeve njerëzore të angazhuara në procesin e menaxhimit të rezervave valutore.

VII. Aktivitetet dhe trendet në sistemet pagesore

BPRM vazhdimisht zbaton aktivitete të shumta në fushën e promovimit të infrastrukturës së pagesave në ekonominë e vendit dhe aktiviteteve për harmonizimin e rregullave kombëtare me rregulloret e Bashkimit Evropian (BE), me qëllim që të sigurohet pajtueshmëria e praktikës kombëtare me praktikën e BE-së. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2016, u përfunduan me sukses disa projekte të rëndësishme, përmes të cilave BPRM realizoi me sukses rolin e saj operativ, mbikëqyrës, zhvillimor dhe katalizator në këtë segment.

Në vitin 2016 ka përfunduar projekti kapital - përmirësimin e Sistemit të Pagesave Ndërbankare të Maqedonisë – MIPS të BPRM për të bërë pagesa në euro (përveç në denarë), me çka u kalua në sistemin e pagesave dy-valutor. Ky projekt, në thelbin e saj, paraqet reformat e gjeneratës së dytë në infrastrukturën e pagesave, pas reformës së parë të rëndësishme të operacioneve të pagesave në vitin 2001. Me këtë projekt kapital u arrit integrimi i infrastrukturës së pagesave të Republikës së Maqedonisë me infrastrukturën e pagesave të Bashkimit Evropian duke krijuar një lidhje korresponduese në sistemin e pagesave TARGET 2 të Eurosistemit. Qëllimi përfundimtar i këtij projekti është ekzekutimi më i shpejtë dhe më i sigurt i pagesave ndërkufitare në euro dhe zvogëlimin e kostove për ato, nga e cila kompanitë dhe familjet e Maqedonisë do të përfitonin.

Procesi i reformave në fushën e pagesave u zhvillua gjithashtu dhe në kuadër të projektit IPA, i cili ishte orientuar drejt harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian. Në kuadër të këtij projekti, në të cilin pjesëmarrje aktive ka pasur dhe Banka Qendrore, është përpiluar projektligji për shërbimet e pagesave dhe sistemet në të cilat zbatohen Direktivat për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm (PSD 2007/64 dhe disa nga dispozitat e PSD2 2015/2366), Direktiva për Financimin e Vendbanimeve. Direktiva për rregullime përfundimtare (SFD 2009/44) dhe Direktiva e Parave Elektronike (EMD2 2009/110). Ky projekt duhet të kontribuojë në nxitjen e konkurrencës, fuqizimin e të drejtave të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, çmime më të ulëta të shërbimeve të pagesave, dhe krijimin e një baze ligjore për integrimin më të shpejtë të Maqedonisë në BE dhe përfshirjen në zonën e vetme të pagesave (SEPA).

Në vitin 2016 u miratuan aktet e reja nënligjore për statistikat e pagesave përmes të cilave arritën pajtueshmëri të konsiderueshme të të dhënave me kërkesat e Rregullores mbi statistikat pagesore nr. 1409/2013 të Bankës Qendrore Evropiane. Korniza e re e statistikave pagesore kontribuon në arritjen e një prej objektivave strategjike të BPRM për të siguruar të dhëna cilësore statistikore të harmonizuara me standardet statistikore evropiane, në ndërkohë duke marrë parasysh ngarkesën e raportimit dhe shpërndarjen e tyre efikase, në kohë dhe në formë të thjeshtë për përdoruesit.


Me qëllim të përmirësimit të rolit mbikëqyrës të BPRM-së, në vitin 2016 u rishikua korniza nënligjore për monitorimin e sistemeve pagesore. U miratuan standardet më të reja të pranuar ndërkombëtarisht të njohura si "Parimet për infrastrukturën e tregut financiar", lëshuar nga Komiteti për sistemet e pagesave dhe rregullimeve në kuadër të Bankës për rregullime ndërkombëtare dhe Organizata ndërkombëtare e komisionit për letrat me vlerë. Me zbatimin e kornizave të reja të monitorimit, pritet përmirësimi i mëtejshëm i besueshmërisë, stabilitetit dhe efikasitetit të sistemeve të pagesave në Republikën e Maqedonisë. Në të njëjtën kohë, për të forcuar stabilitetin e sistemit të pagesave MIPS, është kryer testimi i Planit për sigurimin e vazhdimësisë të funksionimit të MIPS në nivelin e industrisë me pjesëmarrësit më të mëdhenj në sistem.

Procesi i shkëmbimit të njohurive mbi trendet dhe risitë në fushën e sistemeve të pagesave, mjetet dhe shërbimet në suaza ndërkombëtare vazhdojnë dhe në vitin 2016, duke organizuar konferencën e nëntë për sistemin pagesor dhe sistemin e rregullimit të letrave me vlerë nga Banka Qendrore në bashkëpunim me bankat qendrore të Holandës dhe Portugalisë. Në konferencë u zhvilluan çështje të rëndësishme që lidhen me zhvillimin e vazhdueshëm të kornizave ligjore në fushën e pagesave në nivel evropian, vizionin strategjik të Eurosistemit 2020, inovacionit brenda SEPA si dhe sfidat në sigurimin e pagesave.

7.1. Sistemi i përgjithshëm i pagesave në vend

Në vitin 2016, vlera e operacioneve totale të pagesave në vend⁸² arriti në 5,438.6 miliardë denarë. Në të njëjtën kohë, 3.609 miliardë denarë (66%) u realizuan përmes sistemeve të pagesave (MIPS, KIBS, CASIS⁸³) dhe skemave ndërkombëtare të kartelave, gjithashtu u realizuan 1,829 miliardë denarë (34%) edhe përmes sistemeve të brendshme të bankave. Pjesa më e madhe në vlerën e transaksioneve është regjistruar me MIPS (59.5%). Në të njëjtën periudhë, numri total i transaksioneve arriti në 103 milionë transaksione, nga të cilat 63 milionë transaksione (61%) u realizuan nëpërmjet operacioneve të pagesave ndërbankare⁸⁴, ndërsa pjesa tjetër u realizua nëpërmjet sistemeve të brendshme të bankave. Pjesëmarrja e lartë në numrin e përgjithshëm të transaksioneve u regjistrua me skemat e kartelave ndërkombëtare dhe me operacionet e pagesave të brendshme me kartela (përkatësisht 32.4% dhe 10.0%), gjë që tregon prirjen e klientëve për të paguar me kartela pagesore në tregti.

Grafik 60
Gjithsej qarkullim pagesor



Burimi: BPRM.

7.2. Instrumentet pagesore

Në vitin 2016, vlera e përgjithshme e transaksioneve në para jo të gatshme⁸⁵ në vend të iniciuara nga apo të drejtuara tek personat fizikë dhe juridikë (duke përjashtuar transaksionet brenda sektorit të institucioneve financiare monetare) arriti në 3.178 miliardë,

⁸² Operacionet e përgjithshme të pagesave në vend mbulojnë të gjithë sektorët e ekonomisë, përfshirë sektorin e institucioneve financiare monetare.


⁸³ Sistemi Kliring Ndërbankare - KIBS dhe Sistemi i Kartelave Ndërkombëtar - KASIS.

⁸⁴ Operacionet ndërbankare të pagesave përfshijnë transaksionet në vend të rregulluara nëpërmjet sistemeve të pagesave dhe skemave ndërkombëtare të kartave.

⁸⁵ Transaksionet në para jo të gatshme i referohen transaksioneve të iniciuara me një urdhërpagesë - një instrument pagese: transfere kreditore, huazime direkte, kartela pagesore, transaksione të cilat përdorin para elektronike, çeqe dhe instrumente të tjera pagesore. Në Republikën e Maqedonisë, huazimet direkte ende nuk janë futur si një instrument pagese, ndërsa çequet janë shfuqizuar që në vitin 2007. Në të njëjtën kohë, pavarësisht mundësisë ligjore, nuk ka transaksione që përdorin para elektronike. Ku në vlerën e përgjithshme të transaksioneve në para jo të gatshme janë të përfshira vetëm transferet kreditore në pagesat e brendshme dhe pagesat me kartela pagesore të lëshuara në Republikën e Maqedonisë në sistemin e pagesave të brendshme.

që është 5.3 herë më e madhe se shumta e PBV nominal për vitin 2016. Nga aspekti i instrumenteve të pagesës, pjesa më e madhe apo 99% e vlerës së transaksioneve me para jo të gatshme janë bërë përmes transfereve kreditore, ndërsa vetëm 1% i referohen transaksioneve në tregtinë e kartelave pagesore të lëshuara në vend. Brenda transfereve kreditore, është realizuar vlerë pothuajse e barabartë me iniciimin e urdhëresave në letra dhe urdhëresave elektronike. Megjithatë pjesëmarrja e transaksioneve të kartelave pagesore në vlerën totale të transaksioneve me para jo të gatshme është e ulët, përsëri vlera e realizuar me këtë instrument pagesor përfaqëson 11% të konsumit individual në Republikën e Maqedonisë në vitin 2016. Në një kontekst krahasues, pjesa e vlerës së transaksioneve me kartelat pagesore në shpenzimet e konsumit individual në vend është më e ulët sesa në shtetet e vjetra anëtare të BE-së (32%)⁸⁶ dhe vendet e Evropës Qendrore, Juglindore dhe Lindore (CIJE)⁸⁷ (19%)⁸⁸, me çka theksohet dhe nevoja për ndryshime të mëtejshme të zakoneve të konsumatorëve, apo përdorim më të madh të kartelave pagesore.

Grafik 61
Treguesit e instrumenteve pagesore



Burimi: BPRM.

Në aspekt të numrit të transaksioneve me para jo të gatshme nga ana e personave fizik dhe juridik në vend në vitin 2016, në total janë përfshirë 92 milionë transaksione ku pjesa më e madhe ose 62% rrjedh nga transferet kreditore ndërsa pjesa tjetër është përmes kartelave kreditore. Kjo strukturë në numrin e transaksioneve, në krahasim me strukturën në vlerë të transaksioneve, tregon në faktin e përdorimit të madh të kartelave kreditore si instrument pagesor, veçanërisht tek personat fizik.

Si rezultat i risive në pagesat dhe përfitimet që ofron shërbimi elektronik i bankave (mundësi të iniciimit të pagesave 24/7 gjatë javës dhe provizione më të ulëta për urdhëresat elektronike, në krahasim me provizionet e urdhëresave të inicuar në formë letër në sportelet e bankave), në Maqedoni vërehet një trend rritës të përdorimit të shërbimeve të e-bankimit për personat juridikë dhe fizikë. Gjithashtu vërehet një përqindje relativisht e konsiderueshme prej 41% të urdhëresave elektronike në numrin e përgjithshëm të transfereve kreditore, e cila është prap dy herë më e ulët në krahasim me grupin e anëtarëve të vjetra të BE-së dhe CIJE (89% dhe 86%, respektivisht). Numri i përgjithshëm i transfereve kreditore për kokë banori në Maqedoni është 28 transaksione, që është dy herë më pak në krahasim me shtetet CIJE dhe shtetet e vjetra anëtare të BE-së (58 dhe 56 transaksioneve, respektivisht), e cila mundë të shpjegojë faktin që ende kemi përdorim shumë të lartë të parave të gatshme në transaksionet e përgjithshme në ekonomi.


⁸⁶ Austria, Belgjika, Gjermania, Greqia, Danimarka, Irlanda, Italia, Mbretëria e Bashkuar, Portugalia, Finlanda, Franca, Holanda, Suedia dhe Spanja.

⁸⁷ Bullgaria, Estonia, Qiproja, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Çeke, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Hungaria dhe Kroacia.

⁸⁸ Të dhënat e fundit në dispozicion për shtetet anëtare të BE-së kanë të bëjnë me vitin 2015.

Brenda transfereve kreditore, pjesa më e madhe e vlerës është realizuar nga personat juridik (93.5%), ndërsa pjesa tjetër i referohet personave fizikë. Gjithsesi personat juridikë gjithnjë e më shumë përdorin përfitimet e e-bankimit, ku 53% e vlerës është realizuar përmes inicimit elektronik të transfereve kreditore, duke përdorur një kompjuter personal. Tek personat fizikë vërejmë se vlera më e madhe e transfertave të kredive (87%) është realizuar duke aplikuar urdhëresat në letër. Përkundër aplikimit të madh të transfereve kreditore në letra, megjithatë, personat fizikë priren të përdorin më shumë metoda të reja të sofistikuara të pagesave në vend. Ku përdorim më të madh ka kompjuteri personal në transaksionet e realizuara me transfertat elektronike të kredive, por vërehet gjithashtu përdorimi i moderuar i telefonave celularë dhe ATM-ve.


Gradiku 62
Treguesit e transfereve kreditore



Burimi: BPRM.

Vlera totale e transaksioneve të kartelave pagesore për vitin 2016 arriti në 191 miliardë denarë⁸⁹. Në kushtet e vendndodhjes së pajisjeve (në vend dhe jashtë tij) ku realizohen pagesa me kartela pagesore vendase dhe të huaja, vlera më e lartë është arritur tek pajisjet të vendosura në vend me kartela pagesore vendore (85%), pastaj në pajisjet e vendosura në vend me kartela pagesore të huaja (9%), dhe së fundi në pajisjet jashtë vendit me kartelat pagesore të brendshme (6%). Nëse bëjmë analizë të numrave, pjesa më e madhe (90%) janë realizuar me kartelat pagesore vendore në pajisjet vendosura në vend, ndërsa pjesmarrje të barabartë kanë transaksionet me kartela pagesore të huaja në aparatet e brendshme dhe të transaksioneve me kartela pagesore të brendshme në pajisjet që ndodhen jashtë vendit.

Gradiku 63
Treguesit e punës me kartela




Burimi: BPRM.

Në lidhje me përdorimin e parashikuar të kartelave pagesore vendase dhe të huaja në pajisje të vendosura në vend, shumica e kartelave të kreditit përdoren kryesisht për të tërhequr para të gatshme (me pjesëmarrje prej 72% dhe 63%, respektivisht). Për më tepër, banorët kanë realizuar 23% të vlerës të pikave fizike të shitjes në tregti, 4% për deponim të parave të gatshme në ATM, dhe vetëm 1% për pagesat me internet (vende virtuale për shitje). Situata është e ngjashme me jorezidentët tek pajisjet shtëpiake, të cilat kanë krijuara 36% të shumës në vendet e pikave fizike të shitjes dhe 1% për pagesat përmes internetit. Nga ana tjetër, kartelat pagesore vendase jashtë vendit kryesisht janë përdorur në pikat fizike të shitjes (52%), si dhe në pagesat përmes internetit (35%), ndërsa më së paku për tërheqjen e parave (13%). Transaksionet me kartela në vend dhe jashtë vendit në vitin 2016 parashikohet të kenë të hyra neto për Republikën e Maqedonisë në vlerë prej 5.6 miliardë denarë⁹⁰.

⁸⁹ Transaksionet përmes kartelave pagesore në këtë seksion tregohen nga aspekti i vendndodhjes të pajisjeve (në vend dhe jashtë), nga ku përveç transaksioneve në treg, përfshihen dhe transaksionet për tërheqjen dhe depozitimin e parave të gatshme në ATM.

⁹⁰ Neto të hyrat përcaktohen në bazë të të dhënave për statistikën pagesore të NBRM.

Gradiku 64
Treguesit e punës me kartela




Burimi: BPRM.

7.3. Infrastruktura pagesore

Numri i përgjithshëm i kartelave të lëshuara me funksion pagesor në dhjetor të vitit 2016 ishte 1,818,676. Nga numri i përgjithshëm i kartelave, 79% janë kartela debitore, ndërsa pjesa tjetër janë kartela kreditore. Si rezultat i monitorimit të tendencave botërore dhe zgjidhjeve më të fundit teknike dhe teknologjike në fushën e pagesave, bankat filluan të promovojnë kartelat e kontaktit pa-kontakt. Numri i këtyre kartelave në fund të dhjetorit arriti në 252,851 kartela, ose 14% të numrit të përgjithshëm të kartelave të lëshuara. Me futjen e këtyre teknologjive të sofistikuara për të kryer operacione pagesore në tregun e kartelave arrihet efikasitet më i madh dhe shpejtësi gjat pagesave në tregti, dhe reduktimin e radhëve të pritjes së klientëve.

Gradiku 65
Treguesit e kartelave kreditore



Burimi: BPRM.

Në vitin 2016, numri total i ATM-ve në territorin e Maqedonisë arriti në 1,039, shumica e të cilave shërbejnë vetëm për të tërhequr para, ndërsa pjesa tjetër e tyre, përveç funksionit kryesor ofron mundësi për të inicuar transferin e kredive (256) dhe deponimin e të hollave (86). Tendenda e prezantimit të ATM-ve të përmirësuara dhe me funksione shtesë duhet të krijonë përparësi shtesë për të gjitha palët e përfshira në procesin pagesor, edhe atë mbi të gjitha për të ndryshuar zakonet e konsumatorëve apo duke shfrytëzuar përparësitë e metodave të sofistikuara pagesore, shpejtësi dhe efikasitet në pagesa, duke kursyer kohën e pritjes në sportelet e bankave, duke reduktuar kështu dhe përpunimin manual të të dhënave të punëtorëve në sportele. Numri i pajisjeve që pranojnë kartelat pagesore në pikat fizike të shitjes në fund të vitit 2016 ishte 36,974, ndërsa pikat virtuale të shitjes arritën në 711. Numri i përgjithshëm i tregtarëve në vend që pranojnë kartelat në fund të vitit 2016 ishte 13,080. Ndërkaq pjesëmarrje më të madhe kishin tregtarët (12,265) që pranojnë pagesat në pikat fizike të shitjes, pasojnë shitësit (613) të cilët pranojnë

Tabela 3
Treguesit e pajisjeve dhe tregtarëve që pranojnë kartela kreditore

Numri i pajisjeve për pranimit të pagesës dhe numri i përgjithshëm i tregtarëve	Gjendja në 31.12.2016 r.
Bankomatet (ATM)	1,039
Me funksion të deponimit të parave të gatshme	86
Me funksion për të inicuar transfer kreditor	256
Pajisje në vende fizike të shitjeve (POS)	34,974
Pajisje për transfer elektronikë vendet fizike të shitjeve	34,826
Kontaktuese	22,770
Kontaktuese / Pa kontakt	12,056
Pajisje në vende virtuale të shitjeve (shitje përmes internetit)	711
Numri i përgjithshëm i tregtarëve në vend të cilët janë klientë të sigurimit të shërbimeve pagesore dhe pranimit të kartelave	13,080
vende virtuale të shitjeve	12,265
vende fizike të shitjeve	613
shitje në pajisje tjera	202

Burimi: BPRM.

pagesat në pikat virtuale të shitjes dhe pjesën e mbetur e përbëjnë tregtarët (202) të cilët pranojnë pagesa dhe në pajisje të tjera (sistemet për pagesë të shpejtë⁹¹ dhe ofruesit e shërbimeve për mikro-pagesa⁹²).

⁹¹ "Mikropagesat" është pagesa për produkte dhe shërbime në shumë individuale jo më të madhe se 1.000 denarë, me ç'rast pëlqimi për të bërë pagesën bëhet nëpërmjet mjeteve të telekomunikacionit, pajisjeve digjitale ose të teknologjisë informative.


⁹² Sistemi i pagesave të shpejta është një teknologji inovative që mundëson pagesa më të shpejta me para të gatshme dhe jo të gatshme për lloje të ndryshme të shërbimeve (pagesa e faturave të ujit, pagesat radiodifuzive, televizioni kabllorik, telefonia mobile, sigurimi, shkollimi etj.). nëpërmjet pajisjeve të përshtatshme.

VIII. Emetimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike në Republikën e Maqedonisë - operacionet e thesarit

8.1. Monedha në qarkullim

Më gjendjen e datës 31.12.2016, shuma totale e parave të lëshuara në qarkullim është 34.425 milionë denarë dhe krahasuar me fundin e vitit 2015 ato janë rritur në 2.477 milionë denarë ose 7.75%⁹³. Struktura e parave në qarkullim tregon se në fund të vitit, kartëmonedhat përbënin 96.6% ndërsa monedhat metalike 3.4% të vlerës totale. Nga aspekti i numrit të parave të lëshuara në qarkullim, pjesëmarrja e kartëmonedhave është 24.8% (77.9 milionë copë) dhe e monedhave metalike 75.2% (235.6 milionë copë).


Grafik 66



Burimi: BPRM

Pjesëmarrje më të lartë në vlerën e përgjithshme të parave të emituara kanë kartëmonedhat në emëtime prej 1000 denarë (77.0%) dhe kartëmonedhat në emëtime prej 500 denarë (15.7%). Kartëmonedhat tjera marrin pjesë me 7.3% nga vlera e përgjithshme. Në vitin 2016, kontribuuesit më të mëdhenj të monedhës metalike janë monedhat metalike me emëtime prej 50 denarë (35.6%), 10 denarë (31.3%) dhe 5 denarë (14.6%).


Grafik 67



Burimi: BPRM

⁹³ Në të dhënat e prezantuara për lëshimin e parave në qarkullim nuk janë inkorporuar sasitë dhe vlera e monedhave metalike për qëllime koleksionuese, të cilat BPRM për qëllime artistike, kulturore si dhe arsye promotive i ka krijuar dhe lëshuar në qarkullim. Monedhat për qëllime koleksionuese janë të ekspozuara së pari në mërgatë, por edhe në RM. Vlera e këtyre monedhave në qarkullim përfundimisht me 31 dhjetor 2016 arinë 34.430 milionë denarë.

Grafik 68



Burimi: BPRM

Në strukturën e monedhave në qarkullim sipas numrit të pjesëve, pjesëmarrje më të madhe kanë kartmonedhat të emëruara në 1000 denarë (32.9%), 10 denarë (29.7%), dhe 100 (19.8%) denarë. Kartmonedhat e mbetura përbëjnë 17.6% të totalit të kartmonedhave në qarkullim. Nga pjesa më e madhe e monedhave metalike të emetuara gjithsej ka monedha metalike të emëruara në 1 denarë (39.5%).


Dhe gjatë vitit 2016, është punuar në përmirësimin e cilësisë së parasë në qarkullim, sidomos të parave me vlerë të emëruara në shumë më të ulët duke rritur kështu sasinë e monedhave metalike në qarkullim me vlerë të emëruara prej 10 dhe 50 denarë dhe gradualisht tërheqjen nga qarkullimi të kartmonedhave me vlerë të njëjtë në denominim, të cilat paralelisht qarkullojnë me monedhat metalike me vlerë të njëjtë në denominim. Kjo qasje është për shkak të faktit se monedhat metalike kanë një afat më të gjatë të përdorimit, pra ato më pak dëmtohen gjatë përdorimit. Për dallim nga ata kartmonedhat, veçanërisht ato me vlerë më të ulët të emërtimit dhe me qarkullim më të lartë të përdorimit, kartmonedhat kanë një kohëzgjatje më të shkurtër të shfrytëzimit dhe dukshëm më shpejtë dëmtohen.

Duhet theksuar se Banka Qendrore në fund të vitit apo nga 15 dhjetor 2016, vënë në qarkullim kartmonedha të reja me një vlerë në emërim prej 200 dhe 2000 denarë. Futja e këtyre denominimeve të reja në qarkullim do të rrisë ofertën e denominimeve që janë në dispozicion gjatë kryerjes së transaksioneve në para të gatshme, ndërsa si efekt dytësor pritet që të arrihet balancimi i kërkesës për disa denominimeve të caktuara si dhe zbutjen dhe amortizimin e sulmit të kërkesës për disa denominime të caktuara përmes zëvendësimit gradual të tyre me kartmonedhat e reja.

8.2. Furnizimin e bankave dhe qendrave për para të gatshme me kartmonedha dhe monedha metalike

Gjatë vitit 2016, BPRM lëshoi një shumë para të gatshme bankave dhe qendrave të parave të gatshme⁹⁴ në vlerë prej 36,872 milionë denarë (që është rritje prej 7.1% krahasuar me vitin 2015). Ndërsa njëkohësisht, nga bankat dhe qendrat për para të gatshme janë pranuar para të gatshme në vlerë prej 34,394 milionë denarë (që është rritje prej 12,6% krahasuar me vitin 2015). Analiza e strukturës së denominimeve të kartëmonedhave dhe monedhave metalike tregon se gjatë lëshimit dhe marrjes tek kartëmonedhat pjesëmarrje më të madhe kanë ato kartëmonedha me denominime prej 1000 denarë me 38.7% në vitin 2016 (apo 41.1% në vitin 2015) ndërsa në monedha metalike më së shumti vlera në emërime prej 10 denarë me një pjesëmarrje prej 37.8% në vitin 2016 (krahasuar me 26.7% në vitin 2015).

Grafik 69



Burimi: BPRM

8.3. Përpunimi dhe anulimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike

Gjatë vitit 2016, në procesin e kontrollit të cilësisë së kartëmonedhave që ishin në qarkullim janë përpunuar të gjitha kartëmonedhat e pranuar. Nga numri i përgjithshëm i përpunimeve prej 61.5 milionë copë, 12.1 milionë copë u tërhoqën si të papërshtatshme për qarkullim (15.8 milionë kartëmonedha në vitin 2015). Ndërsa pjesëmarrje më të madhe gjatë anulimit të kartëmonedhave kanë parat me emërime prej 100 dhe 10 denarë (65.2%). Në vitin 2016 janë përpunuar gjithashtu edhe 6.7 milionë copë monedha metalike në emërime prej 1, 2, 5, 10 dhe 50 denarë, nga të cilat 211 mijë copë u tërhoqën si të papërshtatshme për qarkullim.

8.4. Ekspertiza për paratë e dyshimta / falsifikuara

Në kuadër të përgjegjësisë së saj, si autoritet i vetëm për përcaktimin e origjinalitetit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të shprehura në denarë dhe në monedha të huaja, BPRM dhe në vitin 2016 realizoi me sukses funksionin e ekspertizës të parave të falsifikuara. Në kuadër të përfundimit të kapaciteteve për të zbuluar me saktësi para të dyshimta dhe të falsifikuara tek subjektet që operojnë me para të gatshme, BPRM gjatë vitit 2016 ka vazhduar me trajnimet e specializuara për stafin e saj dhe qendrave për


⁹⁴ Bazuar në aktet nënligjore të miratuara në vitin 2015, BPRM mundësoi regjistrimin dhe përfshirjen e qendrave për para të gatshme (shoqëritë tregtare që i plotësojnë kushtet për kryerjen e furnizimit me para të gatshme) në sistemin operativ të operacioneve logjistike me para të gatshme. Qëllimi i këtij ndryshimi të akteve nënligjore paraqet një mundësi për infiltrimin e ndikimeve të tregut në këtë segment të funksionimit dhe krijimin e kushteve të shëndetshme konkurruese, që si efekt përfundimtar do të sigurojë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në para të gatshme dhe ulje të provizionëve të cilën e ngarkojnë bankat, duke ruajtur një nivel standard të cilësisë të parave. Gjatë vitit 2016, janë regjistruar dy qendra për para të gatshme, nga të cilat njëri është i përfshirë në mënyrë aktive në furnizimin e parave të gatshme, ndërsa tjetri është në fazën e përfshirjes.

para të gatshme. Përmes prezantimeve dhe trajtimit të drejtpërdrejtë të parave autentike dhe të falsifikuara, pjesëmarrësve u jepen njohuri profesionale të cilat ata do të aplikojnë në kryerjen e mëtejshme të aktiviteteve.


Sa i përket numrit të hetimeve të kryera gjatë vitit 2016, nga gjithsej 927 kartëmonedha të dyshimta të shprehura në denarë të cilat janë dorëzuar për ekspertizë profesionale, është konstatuar që 64 mostra janë origjinale, ndërsa 863 mostrat e mbetura ishin të falsifikuara. Numri i kartëmonedhave të falsifikuara të zbuluara gjatë vitit 2016 është më i ulët për 33%, krahasuar me vitin 2015. Numri i përgjithshëm i kartëmonedhave të zbuluara që janë të falsifikuara në denarë në vitin 2016, më së shumti vërehen tek kartëmonedhat me emërime prej 500 denarë (740 copë), ose 85.7% e numrit të përgjithshëm të kartëmonedhave të falsifikuara⁹⁵, pasuar nga kartëmonedhat me emërime prej 100 denarë (48 copë), ose 5.6% të numrit total i falsifikimeve dhe me emërime prej 1000 denarë (46 copë), ose 5.3% nga numri total i falsifikimeve. Vlera totale e denarëve të falsifikuar në vitin 2016 është 422.250,00 denarë dhe ka peshë të parëndësishme në raport me vlerën totale të parave në qarkullim.

Grafik 70

Kartëmonedha të falsifikuara në denarë



Kartëmonedha të falsifikuara në valutë të huaj



Burimi: BPRM

Në lidhje me hetimet e përfunduara të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të paraqitura si të dyshimta në valutë të huaj në vitin 2016, nga gjithsej 1,246 analizave të bëra janë konstatuar 1234 para të falsifikuara dhe 12 para origjinale. Në numrin e përgjithshëm të kartëmonedhave të falsifikuara, më të zakonshme janë kartëmonedhat në euro (200 copë) dhe në dollarë amerikanë (26 copë).

Për dallim nga vitet e mëparshme, në vitin 2016, u zbuluan sasi më të mëdha të monedhave metalike të falsifikuara në valutë të huaja. Bëhet fjalë për një sasi prej 1001 monedha metalike, nga të cilat 921 copë janë monedha metalike të falsifikuara në emërime prej 5 franga zvicerane dhe 80 copë janë monedha metalike të falsifikuara në euro.

Vlerësimi i përgjithshëm është se kartëmonedhat dhe monedhat metalike të falsifikuara kanë cilësi relativisht të dobët të prodhimit, gjë që mundëson zbulimin e thjeshtë dhe të lehtë dhe përcaktimin e karakteristikave të tyre⁹⁶.

⁹⁵ Pjesa më e madhe në numrin e kartëmonedhave të falsifikuara ka emërtimin prej 500 denarë, që është ekskluzivisht për shkak të faktit se ende dorëzohen mostra që në mënyrë të organizuar ishin të lëshuara në qarkullim gjatë vitit 2015.

⁹⁶ Gjatë ekspertizës së teknikës së përdorur për të falsifikuar kartëmonedha, u konstatua se ato ishin bërë kryesisht në letër të zakonshme, pa elementë të mjaftueshëm mbrojtës, duke përdorur teknologjinë kompjuterike (skanim dhe shtypje), ose duke përdorur fotokopir me ngjyra.

8.5. Shitja e monedhave metalike për qëllime koleksionimi

Gjatë vitit 2016, BPRM ka pasuruar koleksionimin aktual të monedhave metalike për qëllime koleksionuese ("Ikonat e shenjtoreve" , "Shenjat Zodiac" dhe "Dita e Engjëllit") me një gjashtë monedha metalike të reja, duke përfshirë "Shën Nikolla Çudibërësi" dhe "Shën Matrona Moskovska" nga seritë "Ikona e Shenjtorëve"; "Vladimirska" nga seritë të reja "Ikonat e Nënës Më të Shenjtë të Perëndisë"; "Viti i gjelit – gjeli me engjullin" dhe "Viti i gjelit – tregues i erës me gjel " nga seria e re "Kalendarin e hënës" dhe "Shën Tereza e Kalkutës", si një botim i veçantë.

Monedhat për qëllime të kolektorit janë unike, përfaqësuese dhe me vlerë të jashtëzakonshme artistike që kontribuojnë në promovimin e Republikës së Maqedonisë jashtë vendit. Edhe pse fillimisht shitja e monedhave për qëllime të koleksionimit ka për qëllim dhe po dhe zhvillohet kryesisht jashtë vendit, interes i konsiderueshëm ka filluar të vërehet dhe në vend.

Për atyre të rritjes së interesit për këto monedha metalike dhe me qëllim që të mundësojmë qasje më të madhe për blerje, gjatë vitit 2016, BPRM ka nënshkruar një kontratë me Institucionin Kombëtar "Shtëpia Përkujtimore e Nënës Terezë," Shkup për shitje komisioni të monedhave metalike për qëllime koleksionimi. Në vitin 2016, janë shitur gjithsej 402 monedha metalike për qëllime koleksionere.

IX. Statistika

Statistikat zyrtare, të cilat i përgatit BPRM kanë për qëllim informimin e publikut në lidhje me kushtet financiare dhe makroekonomike dhe për zhvillimet ekonomike, si dhe marrëdhëniet e saj me pjesën tjetër të botës.

Gjatë vitit 2016, BPRM edhe më tej vazhdon të jetë në rrugën e planifikuar të realizimit gradual të objektivave strategjike statistikore, të cilat janë: (1) monitorimi i vazhdueshëm i standardeve statistikore ndërkombëtare dhe evropiane, me qëllim të harmonizimit të mëtejshëm të statistikave ekzistuese dhe futjen e studimeve të reja statistikore; dhe (2) zgjerimi i fushëveprimit dhe detajimit të dhënave statistikore të cilat janë në dispozicion të publikut, duke marrë parasysh ngarkesën e raportimit, si dhe qasje më të shpejtë dhe më të lehtë për përdoruesit e jashtëm deri tek të dhënat.

Për këtë qëllim, BPRM ka vazhduar me përmirësimin e cilësisë së raportimit si dhe rritje të detajeve statistikore për aspektet monetare dhe llogaritë financiare, gjithashtu është bërë dhe një hap i mëtejshëm drejt harmonizimit të tyre me standardet më të reja statistikore. Zbatimi konsekuent i parimeve të cilësisë në përgatitjen e statistikave, në përputhje me Kodin Evropian të praktikave të mira, si dhe përparimi i sistemit statistikor kombëtar në periudhën 2010-2016 kanë qenë detajisht të dokumentuara dhe analizuara në kuadër të procesit të vlerësimit të partnerit nga ana e Eurostat. Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të komunikimit me përdoruesit, është filluar me njoftime të rregullta të raporteve statistikore për shtyp.

Më konkretisht, gjatë vitit të kaluar përparim i mëtejshëm në statistikatat është arritur në fushat e mëposhtme:

- në fushën e statistikave të jashtme, është punuar në përmirësimin e përfshirjes dhe cilësisë së të dhënave, por dhe në pasurimin e të dhënave në dispozicion. Kështu, në bilancin e pagesave dhe pozicionit ndërkombëtarë të investimeve është përmirësuar mbulimi i të dhënave tek zërat bilancorë: investime direkte (duke përfshirë të dhëna të hollësishme mbi kreditë tregtare) dhe portofolio investimet (duke përfshirë të dhëna të përgjithshme mbi investimet e investitorëve vendas në letra me vlerë në tregjet e huaja financiare). Gjithashtu, me qëllim të promovimit të metodologjisë për vlerësimin e transfereve private në bilancin e pagesave, janë ndërmarrë aktivitete për të kryer një studim të ri mbi transferet private. Lidhur me pjesën e pasurimit të sasisë së të dhënave të disponueshme, BPRM ka filluar me: (1) përgatitje dhe dorëzimin të rregullt të të dhënave gjysmë-vjetorë për investime në letra me vlerë brenda rezervave zyrtare valutore nga vendet (SEFER) prej FMN-së; dhe (2) përgatitjen dhe dorëzimin e rregullt të të dhënave gjysmëvjetore për investime jashtë vendit bazuar në portofolio investimet, d.m.th. u bashkua me pyetësorin tremujor të portofolio-investimeve (CPIS) të FMN-së. Me inkorporimin në CPIS u përmbush edhe një nga kriteret e kërkuara për anëtarësim në standardet SDDS plus të FMN-së për të pasur qasje për të publikuar të dhënat, me çka Republika e Maqedonisë afrohet plotësisht të patjetërsueshëm të kërkesave të nevojshme për t'u bashkuar me këtë standard;
- ka vazhduar zbatimin afatmesëm i projektit për ndërtimin e një depo të dhënash të vetme statistikore për nevojat e statistikave të jashtme, të cilat duhet të mundësojnë menaxhim optimal të bazave të të dhënave statistikore në BPRM, si dhe ofrimin e mëtejshëm të të dhënave më të detajuara deri tek Eurostat dhe organizata të tjera ndërkombëtare, por edhe përdoruesve të tjerë të jashtëm;

- pas futjes së statistikave për investime në letrat me vlerë të rezidentëve jashtë vendit, në vitin 2016 u arrit një përparim i mëtejshëm duke pasuruar të dhënat e disponueshme për letrat me vlerë të lëshuara në tregun e brendshëm (në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar për shkëmbimin e të dhënave me Depozituesin qendror të letrave me vlerë);
- në fushën e statistikave monetare është bërë përafrimin i mëtejshëm me standardet më të reja ndërkombëtare, pra është përpiluar një seri e re kohore e të dhënave monetare të përcaktuara në përputhje me Manualin e fundit të statistikave monetare të FMN-së nga viti 2016, me përparimin e ndarjeve sektoriale dhe valutore të instrumenteve financiare si dhe krijimi i metodologjisë së re për sasinë e parave, i cili do të publikohet gjatë vitit 2017. Gjithashtu, në kuadër të një projekti afatgjatë për të krijuar një sistem të integruar të raportimit për qëllime të statistikave dhe supervizionin janë ndërmarrë disa aktivitete për të përcaktuar strategjinë optimale për krijimin e një sistemi të ri dhe njoftimin me të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces, përfshirë këtu edhe bankat me këtë projekt;
- në fushën e statistikave të llogarive financiare është duke u punuar në përmirësimin e cilësisë së të dhënave për versionin fillestar të llogarisë financiare, si dhe përcaktimin e burimeve më të përshtatshme të të dhënave dhe ndërtimin e metodologjisë. Në kuadër të aktiviteteve për të krijuar burime të reja të të dhënave për llogarinë financiare, grupi i të dhënave është pasuruar me të dhëna më të detajuara për mjetet financiare dhe obligimet ndaj institucioneve jo-financiare. Gjithashtu, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, u prezantua një raportim i ri mbi shfrytëzuesit e buxhetit për të marrë të dhëna më të hollësishme për sektorin "shtet";
- në kuadër të vendosmërisë strategjike për të përmirësuar cilësinë e komunikimit me raportuesit, janë ndërmarrë disa aktivitete. Përveç trajnimeve të rregullta për raportuesit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (MF) janë organizuar trajnime me përdoruesit e buxhetit për raportimin e ri tremujor mbi statusin dhe qarkullimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Gjithashtu, në bashkëpunim me Zyrën Shtetërore të Statistikave (ZSHS) dhe odave ekonomike, janë zhvilluar trajnime për kompanitë, anëtarët e tyre, për të rritur ndërgjegjësimin e statistikave si një e mirë publike dhe rëndësia e kontributit të tyre për cilësinë e të dhënave statistikore. Gjithashtu, në vitin 2016 është realizua një studim për raportuesit në lidhje me mundësinë e futjes së njoftimit elektronik tek njoftimet për punët kreditore me jorezidentët;
- në drejtim të komunikimit me përdoruesit, është bërë një hap i rëndësishëm përpara me publikimin e rregullt të njoftimeve për shtyp për grupet bazë të të dhënave statistikore, publikimi i të cilave është nën autoritetin e BPRM, njëkohësisht me publikimin e të dhënave. Gjithashtu, është filluar me raportim të rregullt të serive kohore të të dhënave mbi tendencat në investimet direkte (në vend dhe jashtë), sipas vendeve dhe sipas aktiviteteve. Në nëntor të vitit 2016, në kuadër të aktiviteteve të BPRM-së për edukim financiar, në punëtorinë e dytë të organizuar për gazetarë, ndër të tjera u mbajtën prezantime mbi funksionin statistikor të BPRM-së dhe mënyrave të leximit dhe analizimit të të dhënave në dispozicion;
- në aspekt të përpjekjeve për zbatimin e duhur të klasifikimeve statistikore ndërkombëtare, BPRM ka bërë harmonizimin e akteve nënligjore me klasifikimin e ri kombëtar të sektorëve institucionalë, me çka u rrumbullakua procesi i zbatimit të segmenteve të unifikuara me ESHS;
- kah fundi i vitit kanë filluar aktivitetet për të ndërtuar një mjet softuerik i projektuar për analiza të brendshme të të dhënave statistikore, por edhe për të ndërtuar një ueb portal statistikor i cili do të rrisë nivelin e disponueshmërisë të të dhënave statistikore për shfrytëzuesit e jashtëm.

Në ushtrimin e funksionit statistikor, BPRM bashkëpunon me bartësit e tjerë të autorizuar të hulumtimeve statistikore. Bashkëpunimi me ESHS dhe Ministrinë e Financave (MF) u përforcua edhe më tej nëpërmjet krijimit të grupeve ndër-institucionale të punës për statistika të llogarive financiare dhe të raportimeve të borxheve të mëdha dhe të deficitit⁹⁷. Bashkëpunimi solid në mes BPRM, ESHS dhe MF u përforcua duke rritur më tej koordinimin në fushën e funksionit statistikor dhe rritjen e vëllimit të shkëmbimit të të dhënave, e cila është mbështetur dhe me nënshkrimin e një aneksi të ri përmes Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit në fushën e statistikave makroekonomike dhe financiare .

⁹⁷ Procedura e raportimit të deficitit të tepërt (Excessive deficit procedure-EDP) është një grup i veçantë i të dhënave që Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet candidate duhet t'i dorëzojnë Eurostat-it, dhe që ka të bënë me borxhin dhe deficitin të sektorit "shtetëror", sipas standardeve të vendosura për llogaritjen e saj.

X. Funkzioni mbikëqyrës dhe rregullator i BPRM-së

BPRM, në kuadër të funksionit mbikëqyrës, kryen monitorim të vazhdueshëm të tërthortë dhe kontroll të drejtpërdrejtë të plotë ose të pjesshëm të veprimtarisë së bankave dhe kursimoreve, me çka vlerësohet siguria, qëndrueshmëria, rreziku i operimit dhe pajtueshmëria me rregulloret. Gjatë zbatimit të kontroleve mbikëqyrëse, aplikohet koncepti i mbikëqyrjes së orientuar ndaj rrezikut, qëllimi përfundimtar i të cilit është përcaktimi i profilit të rrezikut të çdo banke dhe nivelit të nevojshëm të kapitalit për të mbuluar rreziqet në të cilat është e ekspozuar. Gjithashtu, BPRM është përgjegjëse për kontrollin e institucioneve financiare të cilat ofrojnë shërbime të transferimit të shpejtë të parave dhe punë këmbimore.

Në tetor të vitit 2016, u sollën ndryshime dhe plotësime në Ligjin për banka, të cilat i referohen inkuorporimit të shtresave mbrojtëse të kapitalit, përforcimit të kërkesave kapitale, inkuorporimit të normës së borxhit, promovimit të qeverisjes korporative në banka dhe përforcimit të masave korrigjuese të cilat mund të ndërmerren BPRM. Për shkak të zbatimit të duhur të këtyre ndryshimeve, Këshilli i BPRM-së miratoi disa akte nënligjore, me çka u mundësua harmonizimi i mëtejshëm i rregullativës vendore me reformat e standardeve ndërkombëtare të kapitalit (a.q. Bazeli 3) dhe me dispozitat e rregullativës europiane për funksionim dhe për kërkesat e kujdeshme për bankat.

Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të funksionit mbikëqyrës paraqet qëllim strategjik të BPRM-së. Andaj, gjatë vitit 2016, u realizuan dy misione të asistencës teknike nga ana e Bankës Botërore (World Bank Financial Sector Advisory Centre), qëllimi i të cilave ishte të jepte vlerësim të efikasitetit të mbikëqyrjes bankare të kryer përmes analizës së modelit aktual të mbikëqyrjes dhe të efikasitetit të aktiviteteve të licencimit. Këto misione sollën deri te përkufizimi i më shumë rekomandimeve për avancimin dhe përforcimin e mbikëqyrjes dhe licencimit jashtë terrenit dhe në teren.

Me qëllim që të arrihet një efektivitet dhe efikasitet më i lartë gjatë vlerësimit të rrezikut kreditor tek bankat tregtare, në vitin 2016 u zhvillua softueri aplikativ për kryerjen e kontroleve në terren. Në vijim është inkuorporimi i moduli i dytë i softuerit, me ndihmën e të cilit do të fitohen treguesit për vlerësimin e nivelit të ekspozimit ndaj rreziqeve të caktuara të bankave tregtare.

Gjatë vitit 2016, u zhvillua një vegël për vetëvlerësimin e rreziqeve, të pranishme në sigurinë informative tek bankat tregtare, e cila iu është dorëzuar bankave tregtare. Me këtë aktivitet u shqyrtuan rezultatet për secilën bankë veçmas, me çka u zhvilluan plane veprimi dhe strategji për bankat.

10.1. Kryerja e supervizionit dhe mbikëqyrjes

Gjatë vitit 2016, në përputhje me planin vjetor të kontrollit, BPRM-ja ka kryer kontrole të rregullta mbikëqyrëse (kontrolle terreni të rreziqeve) në 13 banka dhe 1 kursimore dhe kontrole inspektimi (kontrollet në terren rreth përputhshmërisë me rregulloret) tek 15 bankat dhe 3 kursimore. Në periudhën raportuese, është realizuar edhe kontroll tematik në të tri kursimoret në lidhje me vendosjen e sistemit të TI-së dhe përputhshmërinë me rregulloren për siguri të sistemeve informative. Në periudhën raportuese, janë realizuar aktivitete të rregullta të kontrollit tek tre ofruesit e shërbimeve të

transferimit të shpejtë të parave, 35 nën-agjentët e tyre, si dhe në 33 këmbimore të autorizuara.

10.2. Kontrolle terreni të rreziqeve

Bankat në Republikën e Maqedonisë janë të përqendruara në aktivitetet tradicionale bankare dhe rreziku kreditor në masë të madhe e përcakton profilin e tyre të rrezikut⁹⁸. Prandaj, ky rrezik, në veçanti cilësia e menaxhimit të tij, si dhe niveli i ekspozimit, shpesh janë objekt i vlerësimit nga kontrollet e terrenit. Përveç kësaj, tek disa banka u vlerësua përshtatshmëria e sistemeve të parandalimit të pastrimit të parave, menaxhimit të rrezikut ligjor, menaxhimit të rrezikut operativ dhe menaxhimit korporativ. Në periudhën raportuese, u vlerësua përshtatshmëria e sigurisë informative tek pesë banka tregtare.

Kontrollet e zbatuara tregojnë se bankat kryesisht menaxhojnë në nivel të kënaqshëm me rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuara dhe kryesisht i përmbushin masat korrigjuese të dhëna nga BPRM-ja.

Me qëllim të përmirësimit të rregullave dhe praktikave të vendosura për menaxhimin e rrezikut kreditor tek bankat, nga ana e BPRM-së janë dhënë një numër rekomandimesh që kryesisht i referohen: përforcimit të analizave kreditore për klientët, përforcimit të monitorimit të përdorimit të adekuat të kredive të miratuara për personat juridik dhe të kredive për banim për popullatën, përmirësimit të sistemeve për identifikim dhe monitorim të personave të ndërlidhur dhe të menaxhimit me rrezikun nga përqendrimi, zvogëlim të ekspozimit tek klientë të veçantë në kuadër të kufijve për ekspozim të përcaktuar ligjërisht, rritje të ndikimit të pjesës organizative për menaxhim me rreziqet në procesin e kreditimit, promovim të procedurave për miratim të kredive për rifinancim në segmentin "popullatë", si dhe përmirësim të mënyrës së përcaktimit të borxhit të përgjithshëm të popullatës në nivel të sistemit. Për më tepër, janë dhënë rekomandime edhe për përmirësimin e procesit të klasifikimit të ekspozimeve kreditore përmes rritjes së ndikimit të aftësisë kredituese dhe historisë së kreditimit të klientit, avancimit të kriterëve të paralajmërimit të hershëm në procesin e monitorimit të kredive të miratuara, përmirësimit të mënyrës së identifikimit dhe menaxhimit me kërkesat e ristrukturuara, përforcimin e evidencës dhe monitorimit të kredive të miratuara me përjashtim, si dhe rekomandime për përmirësimin e punës së auditimit të brendshëm dhe përforcimin e kontrolleve të brendshme në segmentin "popullatë".

Sa i përket masave dhe aktiviteteve të cilat i ndërmarrin bankat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, janë dhënë rekomandime për: avancimin e akteve të brendshme, përforcimin e masave për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të pronarit të personave juridikë, avancimin e analizave të klientëve dhe transaksioneve për përcaktim më të duhur të nivelit të rrezikut të klientëve, plotësimin e raporteve të cilat dorëzohen tek organet drejtuese, përforcimin e treguesve për identifikimin e transaksioneve të mundshme të dyshimta, harmonizim të vëllimit të masave dhe veprimeve të cilat ndërmerren në nivelin e rrezikut të klientëve dhe zgjerim të shtrirjes së kontrolleve të cilat i zbaton shërbimi për auditim të brendshëm tek bankat.

Për të përmirësuar menaxhimin e rrezikut ligjor dhe të reputacionit, janë dhënë rekomandime lidhur me përparimin e punës së pjesës organizative të bankave për kontroll të përputhshmërinë me dispozitat nga aspekti i përforcimit të procesit të monitorimit të ndryshimeve të cilat do të shkaktoheshin nga ndryshimet legjislative, në segmente të

⁹⁸ Analiza e rreziqeve në sektorin bankar është e përfshirë në Raportin mbi rreziqet në sektorin bankar në vitin 2016.

caktuara të punës si dhe përfshirje më të madhe e kësaj pjese gjatë monitorimit të ankesave të klientëve dhe gjatë përgatitjes së marrëveshjeve për kredi. Gjatë kontroleve ku lëndë ishte vlerësimi i përfshirjes së bankave në procesin gjyqësor, ku ajo është e paditur, u përcaktua një rezervë e përshtatshme për humbjet potenciale nga proceset gjyqësore të mundshme. Tek bankat ku është e vlerësuar qeverisja korporative, është vërtetuar ekzistimi i një strukture të përshtatshme organizative dhe procese të menaxhimit të rrezikut dhe vendosje e mekanizmave të kontrollit të brendshëm të cilët po përforcohen vazhdimisht.

Me qëllim të rritjes së sigurisë informative, janë dhënë rekomandime në lidhje me përforcimin e kontroleve të brendshme dhe kufizimin e qasjes në bazat e të dhënave, përmirësimin e mëtutjeshëm të sigurisë së sistemeve, avancim të procesit të testimit të zgjidhjeve aplikative para vënies së tyre në prodhim, përmbyllja e sistemit për gjurmë të auditimit, zëvendësim ose mbindërtim të sistemit të vjetërsuar softuerik, sidomos në pjesën e bankimit elektronik dhe zbatim të TI-auditimit nga auditimi i brendshëm. Tek bankat ku lënda ishte përcaktimi i veprimeve të ndërmarra në lidhje me masat e vendosura më parë në pjesën e TI-rrezikut, u vlerësua se ekziston reagim tek pjesa më e madhe e institucioneve të kontrolluara.

Gjithashtu, me qëllim të përmirësimit të rregullave dhe praktikave të vendosura për menaxhim me rrezikun operacional, janë dhënë rekomandime që i referohen rritjes së vetëdijes për këtë rrezik, përmirësimit të akteve dhe proceseve të brendshme për identifikimin, raportimin dhe vlerësimin e rrezikut.

10.3. Kontrolle tereni rreth përputhshmërisë së dispozitave

Kontrollet në teren rreth përputhshmërisë së dispozitave, ose të a.q. kontrollet e inspektimit kryesisht kanë të bëjnë me vlerësimin e punës së bankave dhe kursimoreve në pajtim me Ligjin për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë, Ligjit për punë devizore, Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore, Ligjit për kryerje të shërbimeve të transferimit të shpejtë të parave dhe Ligjit për qarkullim pagesor. Tek të gjitha njësitë e kontrolluara është vërtetuara funksionim në përputhje me dispozitat. Disa mangësi janë përcaktuar në disa banka në lidhje me mënyrën e llogaritjes dhe shpërndarjes së rezervës së detyrueshme.

Kontrollet në terren të institucioneve financiare jobankare, gjegjësisht, këmbimoreve të autorizuara, ofruesit të shërbimeve të transferimit të shpejtë të parave dhe nën-agjentëve të tyre synonin të jepnin vlerësim të përputhjes së punës së tyre me Ligjin për punë devizore, Ligjin për transferim të shpejtë të parave dhe Ligjin për parandalimin e larjes parave dhe financimin e terrorizmit. Tek një pjesë e këmbimoreve të autorizuara u identifikuan mospërputhje e dokumenteve të qarkullimit me gjendjen aktuale të efektives në arkë. Sa i përket funksionimit të ofruesve të shërbimeve të transferimit të shpejtë të parave, një pjesë të tyre iu theksua nevoja për zgjerim të analizave të klientëve në kontekst të dispozitave të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

10.4. Licencimi i bankave dhe kursimoreve në vitin 2016

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta në pjesën e licencimit të bankave dhe të kursimoreve në pajtim me Ligjin për banka, gjatë vitit 2016, nga ana BPRM-së janë kryer 87 procedura për lëshim të pëlqimeve. Procedurat e kryera gjatë vitit janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4

Procedurat e licencimit të zbatuara në vitin 2016

Lloji i lejes/pëlqimit (bankat)	Të lëshuara	Të refuzuara	Të ndaluara
Pëlqim për përvetësim të aksioneve në bankë	2		1
Pëlqim për fillim të ushtrimit të aktivitetit financiar	3	/	/
Pëlqim për ndryshim të emrit	2	/	/
Pëlqim për ndryshim të selisë	2	/	1
Pëlqimi për ndryshim dhe plotësim të statutit	22	/	1
Pëlqim për emërim të anëtarit të Bordit Mbikëqyrës	35	/	2
Pëlqim për emërim të anëtarit të Bordit të Drejtorëve	17	/	1
Lloji i lejes/pëlqimit (kursimoret)	Të lëshuara	Të refuzuara	Të ndaluara
Pëlqim për emërim të udhëheqësit/drejtorit	1	/	/
Pëlqim për ndryshim dhe plotësim të kontratës/deklaratës së themelimit	2	/	/
Pëlqim për ndryshim të selisë	1	/	/
Gjithsej	87	/	6

XI. Auditimi i brendshëm

Në vitin 2016, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) implementoi plotësisht Programin e tij të punës. Përmes vlerësimit sistematik dhe dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e procesit të menaxhimit me rreziqet, përshtatshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme, si dhe të proceseve të menaxhimit, auditimi i brendshëm ka arritur qëllimet e tij primare, duke dhënë bindje për:

1. përdorimin efikas dhe ekonomik të burimeve;
2. rruajtjen dhe mbrojtjen e sigurtë të mjeteve;
3. besueshmërinë dhe integritetin e informatave financiare dhe informatave tjera; dhe
4. përputhshmërinë e funksionimit me ligjet dhe aktet nënligjore, politikat dhe procedurat e brendshme për punë.

Në vitin 2016 janë kryer gjithsej 22 auditime të rregullta dhe një auditim i jashtëzakonshëm i gjithsej 33 proceseve të punës, me çka për gjetjet e vërtetuara janë dhënë gjithsej 43 rekomandime për përmirësim të sistemit të kontrollit të brendshëm. Në baza të rregullta tremujore, është ndjekur zbatimi i rekomandimeve të dhëna dhe gjetjeve nga monitorimet e kryera treguan se rekomandimet kryesisht respektohen dhe zbatohen brenda afatit të caktuar. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin 2016 është 88%.

Përveç auditimit të rregullt, auditimi i brendshëm kishte aktivitete shtesë përmes zbatimit të Programit për konfirmimin e cilësisë dhe përparimin e punës. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2016 u realizua rishikimi dhe përditësimi i listës së proceseve të punës të cilat mund të jenë lëndë audimi, në përputhje me ripërcaktimin e proceseve të punës në BPRM, procedim sipas gjetjeve të Raportit për vetë-vlerësim periodik të punës së DAB-it në vitin 2015, zbatim i Pyetësorit për kënaqësinë e njësive organizative ku është kryer auditimi, si dhe aktivitete të tjera me karakter edukativ.

Puna e DAB-it është monitoruar nga afër nga Komiteti për auditim, i cili ka mbajtur katër seanca gjatë vitit 2016.

XII. Përmirësimi i kapacitetit institucional të BPRM-së

12.1. Planifikimi strategjik

Në maj të vitit 2016, u miratua Plani strategjik i Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2017 - 2019. Plani strategjik përcaktohet në bazë të misionit, vizionit dhe vlerave organizative të BPRM-së, në varësi të mjedisit makroekonomik dhe sfidave kryesore dhe përmban qëllimet themelore strategjike për periudhën e ardhshme trevjeçare.

Në bazë të qëllimeve strategjike të miratuara, në dhjetor të vitit 2016 u miratua Programi i punës së Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017, i cili bashkon aktivitetet e planifikuara programore të njëjësive organizative në BPRM-së dhe në të njëjtën kohë mundëson koordinim të punës, vlerësim më të mirë të rezultateve të planifikuara dhe të pritshme si dhe shpërndarje adekuate të burimeve të disponueshme për realizim më efikas të qëllimeve strategjike.

12.2. Menaxhimi me rreziqet operacionale

Duke u nisur nga Politikat e menaxhimit të rreziqeve operacionale të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë, BPRM ofron sistem për menaxhim të koordinuar, gjithëpërfshirës dhe sistematik të rreziqeve operacionale me qëllim të identifikimit të ngjarjeve të cilat mund të ndikojnë në funksionimin e Bankës, ruajtjen e ekspozimit ndaj rreziqeve brenda kornizave të pranueshme dhe realizim efikas të qëllimeve.

Duke pasur parasysh kornizën e vendosur për menaxhim me rreziqet operacionale dhe në bazë të lidhjes funksionale dhe sistemore të punës, gjatë vitit 2016 është bërë auditim i regjistrit të proceseve dhe projekteve të punës. Më pas, përmes implementimit të disa skenareve ekstreme, u ndanë proceset dhe projektet kritike të punës, funksionimi i të cilave ka rëndësi të madhe për punën, rezultatin financiar dhe reputacionin e BPRM-së, me çka u realizua përditësimi i procedurave të punës dhe u identifikuan burimet e rrezikut. Pas identifikimit të rreziqeve kryesore operative të punës, u realizua vlerësimi i nivelit të rrezikut në bazë të probabilitetit dhe pasojave të mundshme në rast të shfaqjes së tyre. Duke marrë parasysh faktin që vlerësimi i rreziqeve operacionale është bërë gjatë vitit 2016, shumica e strategjive dhe masave për menaxhim me rreziqet janë përfshirë në kuadër të aktiviteteve programore për vitin 2017.

12.3. Sigurim i funksionimit të vazhdueshëm

Në përputhje me Politikën për sigurim të vazhdueshëm të funksionimit, Banka popullore realizon një proces të strukturuar dhe të rregullt të planifikimit, rishikimit dhe testimit të masave të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e proceseve të punës në situatë krize.

Gjatë vitit 2016, është kryer rishikimi i Planeve për sigurim të vazhdueshëm të funksionimit (PVF) për gjithsej 143 procese pune. Gjithashtu, për të konfirmuar mundësinë e zbatimit të planeve për vazhdimësinë e proceseve kritike të punës, gjatë vitit 2016 janë realizuar aktivitete për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, trajnimin e të

punësuarve dhe testimin e planeve për sigurim të vazhdueshëm të njëzet proceseve kritike të punës në kushte të skenarëve të paracaktuara të krizave dhe gamës së testimit. Për rezultatet e testeve të kryera u përgatitën raporte të detajuara me plane të përshtatshme veprimi për zbatimin e masave të përcaktuara për përmirësimin e planeve për sigurimin e vazhdimësisë.

Shtabi i krizës i Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë rishikoi Raportin vjetor për zbatimin e Politikës për vazhdimësi të funksionimit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 dhe në të njëjtën kohë solli përfundime në bazë të të cilave u përditësua Plani për sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë.


12.4. Menaxhimi me burimet njerëzore

BPRM vazhdimisht kujdeset për krijimin e një stafi shumë të kualifikuar i cili do t'i përgjigjet në mënyrë adekuate sfidave për realizim të suksesshëm të qëllimeve të funksionimit. Këtë ajo e bën këtë përmes procesit të trajnimit të vazhdueshëm të punëtorëve të saj, me qëllim të rritjes së njohurive profesionale dhe forcimit të aftësive të tyre, si dhe nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të sistemit të menaxhimit me burimet njerëzore.

Në vitin 2016, numri mesatar i punëtorëve të BPRM-së është 428 punëtorë me kohë të pacaktuar dhe 8 me kohë të caktuar. Në vitin 2016, nuk ka ndryshim në strukturën e gjinisë dhe moshës së punëtorëve krahasuar me vitet e mëparshme, me çka popullsia femrore përbën 59% të të punësuarve kundrejt asaj mashkullore e cila përbën vetëm 41%.

Sa i përket strukturës së moshës, moshja mesatare e punëtorëve është 44.1 vjeç në 2016, kundrejt moshës mesatare prej 44.6 vjeç, në vitin 2015. Në vitin 2016, Banka popullore filloi të paraqes strukturën e kualifikimit sipas Kornizës kombëtare të kualifikimeve të Republikës së Maqedonisë (KKK), e cila është e përshtatur me Kornizën Evropiane të kualifikimeve (KEK). Sipas grafikut nr. 1, përqindja më e lartë është regjistruar në arsimin e lartë, me një total prej 73.7% (nga të cilat përqindja më e madhe është regjistruar nga studimet katërvjeçare dhe master studimet me 43.4% respektivisht 18.7%).

Grafik 96
Struktura e kualifikimit të të punësuarve në BPRM për vitin 2016
(në përqindje)



Burimi: BPRM; gjendja më 31.12.2016


Proceset e zhvillimit profesional, vlerësimit të suksesit në punë apo performancës dhe shpërblimi janë procese që ndikojnë në zhvillimin e karrierës së të punësuarve në BPRM. Në vitin e kaluar, u kryen këshillime në nivele të drejtorive me qëllim të avancimit të mëtejshëm të procesit vjetor të vlerësimit të performancës së të punësuarve, në mënyrë që të sigurohet zbatim objektiv i tij dhe t'u jepet informacioni kthyes adekuat punëtorëve rreth arritjeve të tyre. Ky sistem përdoret si mjet edhe për angazhim, produktivitet dhe shfrytëzim më të madh të njohurive dhe potencialit krijues në institucion. Në të njëjtën kohë, për zbatim cilësor të këtyre proceseve, si dhe çdo vit, është punuar shumë në zhvillimin e aftësive profesionale dhe atyre të buta të punëtorëve dhe drejtuesve të institucionit.

BPRM në mënyrë të vazhdueshme investon në trajnimin dhe formimin profesional të gjithë të punësuarve, në mënyrë që të përmbush qëllimet strategjike, misionin dhe vizionin e institucionit. Gjatë vitit 2016, janë organizuar gjithsej 313 trajnime profesionale në vend dhe jashtë vendit.

Krahasuar me vitin paraprak, numri i trajnimeve profesionale në vend ka shënuar rritje prej 14.8%, ndërsa numri i trajnimeve profesionale jashtë vendit pothuajse është i pandryshuar. Numri i të punësuarve që kanë vizituar trajnim profesional është rritur për 8.2% krahasuar me vitin paraprak. Organizatorët kryesorë të jashtëm të trajnimeve profesionale janë Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe bankat qendrore të vendeve të Bashkimit Evropian, me të cilat BPRM bashkëpunon intensivisht përmes programeve për bashkëpunim të ndërsjellë.

Grafik 97

Trajnime profesionale të realizuara në vend dhe jashtë vendit (numri i trajnimeve profesionale)



Burimi: BPRM; gjendja më 31.12.2016.

Si organizatorët kryesorë të trajnimeve profesionale në vend, paraqiten qendrat e brendshme për edukim në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ndryshimeve në rregullativën ligjore në fushën e punës së BPRM-së.

BPRM i ndjek trendet në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, inkurajon të mësuarit e vazhdueshëm dhe zhvillimin e punëtorëve dhe veçanërisht kuadrove të rinj. Për këtë qëllim, në mënyrë të vazhdueshme organizon trajnime të brendshme, të lidhura me përforcimin e aftësive të buta të punëtorëve dhe strukturës drejtuese të BPRM-së, si dhe trajnime të specializuara për njohuri profesionale.

12.5. Aktiviteti hulumtues

Aktiviteti hulumtues i BPRM-së edhe në vitin 2016 u përqendrua në fushat të cilat janë të rëndësishme për përkrahjen e procesit të vendimmarrjes dhe parashikimit në kohë të sfidave të ardhshme, me qëllim të realizimit të qëllimeve themelore të funksionimit dhe forcimit të mëtejshëm të kapacitetit institucional. Gjatë vitit 2016 janë realizuar disa projekte hulumtuese që kanë të bëjnë me: ndikimin e komponentëve të PBB-së mbi papunësinë, elasticitetin e të ardhurave dhe çmimeve të eksportit dhe importit, lidhjen e ciklit ekonomik dhe financiar, modelet dhe qasjet për projektim afatshkurtër të inflacionit, shlyerjen e borxhit nga ana e sektorit korporativ, rolin e bankave me kapital të huaj, komunikimin në fushën e politikës monetare, reagimin e firmave ndaj goditjeve, vlerësimin e nivelit optimal të rezervave devizore, studimin e mundësive për rezervim dinamik të plasmaneve bankare, si dhe dy punime në fushën e numizmatikës. Përveç kësaj, gjatë vitit është punuar edhe në shtatë projekte hulumtuese, realizimi i të cilave është në vijim e sipër, e të cilat janë kryesisht në fushën e: ndërveprimeve ndërmjet sektorëve bazë makroekonomikë, stabilitetit financiar dhe sistemit bankar. Programi i aktivitetit hulumtues për periudhën 2017 - 2019, i miratuar në mesin e vitit 2016, sugjeroi aktivitete të mëtejshme në kuadër të fushave bazë hulumtuese dhe u plotësua edhe me disa projekte të reja.

Më 7 dhe 8 Prill, tradicionalisht, me rastin e përvjetorit të pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë u organizua Konferenca e pestë hulumtuese me temë: "Efektet e transmetimit të ciklit ekonomik dhe financiar: rishqyrtimi i kanaleve vendore dhe

ndërkufitare dhe përgjigjet e politikave". Konferenca u organizua në gjashtë sesione, duke përfshirë edhe një diskutim në panel mbi politikat e zyrtarëve të lartë të bankave qendrore, institucioneve akademike dhe hulumtuese. Në konferencë u prezantuan materialet hulumtuese të përfaqësuesve të bankave qendrore dhe institucionet akademike nga rajoni dhe nga BE-ja. Në kuadër të kësaj ngjarjeje u dha çmimi i rregullt vjetor i BPRM-së për punim më të mirë të një hulumtuesi të ri në fushën e makroekonomisë dhe bankave dhe sistemeve bankare.

Në kuadër të aktiviteteve për përkrahjen e zhvillimit të veprimtarisë hulumtuese dhe analitike, vazhdoi puna e Klubit të hulumtuesve, i cili është i hapur edhe për hulumtuesit jashtë BPRM-së. Gjatë vitit 2016, u mbajtën katër seanca tremujore të Klubit, në të cilat u prezantuan dhe u diskutuan disa punime shkencore-hulumtuese, të cilat kishin të bëjnë me pyetjet e mëposhtme hulumtuese: tregun e punës dhe papunësinë e të rinjve, parashikimin e cikleve ekonomike, përcaktuesit e plasmaneve jofunkionale të bankave sipas sektorëve, kapitalin e sektorit korporativ, investimet e huaja direkte dhe rritja ekonomike, Modeli për analizë të politikave në Maqedoni (MAKPAM) i BPRM-së, elasticiteti i të ardhurave dhe çmimit të eksporteve dhe importeve dhe komunikimi në fushën e politikës monetare. Gjithashtu, gjatë vitit, në BPRM u organizuan ligjërata të veçanta të ekspertëve të huaj të shquar mbi çështje aktuale të punës së bankimit qendrore. Gjatë vitit 2016, me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave në fushën e veprimtarisë hulumtuese, BPRM realizoi bashkëpunim teknik me Bankën qendrore të Marokut, veçanërisht në fushën e transferimit të përvojave në lidhje me zhvillimin e MAKPAM në BPRM. Në nëntor të vitit 2016, BPRM ishte nikoqir i seminarit mbi teknikat e avancuara ekonometrike të Bankës së Anglisë, ku morën pjesë përfaqësues nga bankat qendrore të vendeve të rajonit. Të punësuarit e BPRM-së, me punimet dhe prezantimet e tyre, morën pjesë në disa konferenca dhe ngjarje ndërkombëtare.

12.6. Zhvillimi në fushën e teknologjisë informative

Gjatë vitit 2016, në fushën e teknologjisë informative (TI) është punuar në më shumë se 6,800 raste pune. Nga këto, pjesa më e madhe, ose 61%, ishin kërkesa për TI shërbime, 28% kishin të bëjnë me zgjidhje të incidenteve, ndërsa 11% ishin në fushën e mirëmbajtjes së rregullt të infrastrukturës informatike dhe përmirësimit të saj. Drejtoria e TI-së mirëmban më shumë se 150 server, 400 stacione pune, 190 aplikacione (të cilat kryesisht janë zgjidhje softuerike të zhvilluara në kuadër të BPRM-së, ndërsa një pjesë e vogël të furnizuara nga furnitorë të jashtëm), si dhe një gamë të madhe të mjeteve të tjera të TI-së të cilat të punësuarit e bankës i përdorin çdo ditë.

Gjatë vitit 2016 u realizuan disa projekte: është vendosur në funksion modul i ri në MIPS (SNMP) për pagesa në euro, janë futur në përdorim servera të rinj të virtualizimit dhe sistem i ri për kopje rezervë dhe ruajtje të të dhënave, një sistem i ri për avancim qendror të softuerëve të kompjuterëve personal, softuer për kontrollin e kodit gjatë zhvillimit të aplikacioneve, shërbim për kontrollin e fjalëkalimeve të përdoruesve nga entitetet e jashtme (bankat) të cilat janë të lidhura me BPRM-në, etj. Me serverat e rinj kapaciteti i bankës u rrit ndjeshëm, me sistemin e ri për kopje rezervë dhe ruajtje të të dhënave u rrit shpejtësia e kthimit të informacioneve, ndërsa me shërbimin e kontrollit të fjalëkalimeve u ndihmuan përdoruesit që më lehtë të menaxhojnë me llogaritë përdoruese që kanë në BPRM. U përfunduan edhe disa projekte për mirëmbajtje të rregullt, të tilla si: përmirësimi i lidhjes me rrjetin e botëror bankar SWIFT, zëvendësimi i softuerit për antivirus, rritja e sigurisë së sistemeve të TI-së me futjen e pajisjeve të reja dhe të tjera.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të theksohet se gjatë vitit 2016 është nënshkruar Protokollin e parë për nivel të shërbimit (të ashtuquajtur SLA, Service Level Agreement) mes Drejtorisë për TI dhe Drejtorisë për sistemet e pagesave të BPRM-së, me çka përcaktohet niveli në të cilën duhet të jenë në dispozicion shërbimet e Drejtorisë së TI. Me këtë përmirësohet menaxhimi me teknologjinë informative të BPRM-së përmes parashikueshmërisë së rritur, me çka palët e përfshira janë në dijeni të nivelit të pritur të shërbimeve të TI-së, duke përfshirë edhe atë se sa mund të jetë ndërprerja maksimale (ang. downtime) e pajisjeve të TI-së për një drejtori specifike. Veç kësaj, në mase të madhe është e plotësuar baza e TI pajisjeve (të ashtuquajturat CMDB, Configuration Management Database), gjë që e bën më të lehtë menaxhimin e pajisjeve të TI-së.

Në periudhën prej 31 maj e deri më 3 qershor 2016, u organizua forum i TI-së me temë "Infrastruktura e TI-së në bankat qendrore". Në të morën pjesë 30 pjesëmarrës nga 15 vende dhe gjithsej u prezantuan 19 punime. Forumi i TI-së ofroi një mundësi të shkëlqyer për të mësuar më shumë rreth menaxhimit të infrastrukturës së TI-së në bankat qendrore, nëpërmjet diskutimeve, shkëmbimit të përvojave dhe prezantimeve mbi mënyrën se si bankat qendrore menaxhojnë me qasjet e përdoruesve, zhvillojnë aplikacione, punë mobile, lokacione e rezervuara dhe vazhdimësinë në punë.

XIII. Aktivitete të tjera

13.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë vitit 2016, BPRM ka vazhduar aktivitetet e saja lidhur me mirëmbajtjen dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, si në baza multilaterale ashtu dhe në atë dypalëshe.

Në kuadër të bashkëpunimit multilateral, u realizua vizitë e rregullt nga përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në lidhje me konsultimet në përputhje me Nenin IV të Statutit të Fondit. Gjatë vitit 2016, vazhdoi bashkëpunimi me FMN në fushën e statistikave me qëllim të avancimit të statistikave të cilat janë në kompetencë të BPRM-së. Sa i përket bashkëpunimit me Bankën Botërore, janë realizuar dy misione të asistencës teknike në fushën e mbikëqyrjes bankare, e cila u krye nga "FINSAC" (FinSAC – World Bank Financial Sector Advisory Centre).

Më 11 dhe 12 shkurt 2016, BPRM ishte nikoqir i takimit të pesëmbëdhjetë me rradhë të Bankës për rregullime ndërkombëtare për politika monetare në Evropën Qendrore dhe Lindore, ku morën pjesë përfaqësues të lartë të njëzet Bankave qendrore Evropiane, përfshirë këtu edhe BPRM-në. Temat kryesore për diskutim ishin perspektivat makroekonomike në terma global, si dhe në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, efektet e zbatimit të politikës monetare, si dhe modelet për një rritje afatgjatë. Po ashtu, gjatë vitit 2016, u organizuan tre konferenca ndërkombëtare: Konferenca e pestë hulumtuese, Konferenca e nëntë për sistemet e pagesave dhe TI forumi.

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh, BPRM vazhdoi bashkëpunim afatgjatë teknik të vendosur me Bankën Qendrore holandeze, Bankën Qendrore të Gjermanisë, si dhe me bankat e tjera qendrore të BE-së dhe vendeve të rajonit. Përveç kësaj, u krijua baza për bashkëpunim teknik afatgjatë me Bankën Kombëtare të Belgjikës, në kuadër të së cilës u realizuan disa projekte. Lidhur me Bankën Qendrore Evropiane (BQE), bashkëpunimi u zhvillua në kuadër të qasjes së vendosur rajonale për bashkëpunim midis BQE dhe bankave qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në kuadër të procesit të aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Europian, edhe gjatë vitit 2016, BPRM mori pjesë aktive në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociimit (MSA), në përgatitjen dhe zbatimin e Programit vjetor kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Europian (NPAA), si dhe në përgatitjen e Programit për reforma ekonomike (ERP).

Në lidhje me ndihmën e para-anëtarësimit të BE-së (IPA), këtë vit u përfunduan dy projekte. Në projektin e parë, "Harmonizimi i mëtejshëm me EU acquis në fushën e lëvizjes së kapitalit dhe shërbimeve financiare - tregut të letrave me vlerë dhe shërbimeve investuese", BPRM ishte përfshirë në komponentën e parë, e cila i referohet harmonizimit me Direktivën e shërbimeve të pagesave. Në të dytin, twinning-projekti "Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe organizative në procesin e integritit Evropian", i cili kishte për qëllim përcaktimin e nivelit aktual të harmonizimit të legjislativës kombëtar me atë Evropian, BPRM u përfshi në kapitujt "Lëvizja e lirë e kapitalit" dhe "Politika ekonomike dhe monetare". Kah fundi i vitit 2016 filloi të zbatohet projekti "Krijimi i instrumentit të brendshëm analitik dhe portalit statistikor për përdoruesit e jashtëm", me realizimin e të cilit pritet përmirësim i disponueshmërisë së të dhënave statistikore, për

përgatitjen e të cilave kompetente është BPRM, gjë që do të siguroj qasje më efikase dhe më të lehtë tek të dhënat e disponueshme për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm.

Në kuadër të Programit Shumëpërfitues të IPA-s për bashkëpunim statistikor, u sigurua mbështetje financiare për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të BPRM-së në takimet dhe komisionet e rregullta të Eurostat-it në fushën e statistikave të bilancit të pagesave.

Në kuadër të instrumentit për asistencë teknike të BE-së (TAIEX), gjatë vitit u realizuan me sukses shtatë projekte në disa fusha të punës së bankimit qendror.

13.2. Marrëdhëniet me publikun

BPRM, edhe në vitin 2016, u angazhua për transparencë dhe informim në kohë të publikut për aspekte të ndryshme të fushës së funksionimit të saj. Informimi u krye nëpërmjet komunikimit të rregullt me mediat publike, nëpërmjet publikimit të njoftimeve për shtyp, dhënie të përgjigjeve ndaj pyetjeve gazetareske, organizim të intervistave, konferenca për shtyp dhe publikimit të përmbajtjeve në faqen e internetit (www.nbrm.mk). Në faqen fillestare të internetit janë publikuar: njoftime të rregullta nga mbledhjet e Këshillit të BPRM-së dhe Komisionit për politikën monetare operative të BPRM-së, njoftime për zbatimin e instrumenteve të politikës monetare, njoftimet për të dhëna dhe publikime të reja në gjuhën maqedonase dhe angleze. Në faqen e internetit, rregullisht janë përditësuar përmbajtjet e vendosura në fushën e funksionimit të BPRM-së.

BPRM komunikon direkt me publikun edhe përmes postës elektronike info@nbrm.mk, të vendosur në faqen e internetit të BPRM-së. Gjithashtu, në faqen e internetit është e publikuar adresa për qasje të lirë në informatat me karakter publik, si dhe adresat elektronike për pyetje dhe përgjigje në fushën e statistikave dhe mbikëqyrjes.

Raportet vjetore, tremujore, mujore dhe raportet tjera rreth funksionimit, publikohen në formë elektronike në faqen e internetit të BPRM-së, në gjuhën maqedonase dhe atë angleze. Përveç kësaj, Raporti vjetor i punës publikohet në kopje fizike, në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze. Nga viti 2015, është filluar me përkthimin në gjuhën shqipe të raporteve vjetore dhe tremujore të funksionimit ndërsa raportet e përkthyera janë të publikuara në faqen e internetit të BPRM-së.

Me qëllim të monitorimit të tendencave të reja në mënyrën e komunikimit të bankave qendrore me publikun dhe me qëllim të afrimit deri te publiku i gjerë dhe përparim të informimit të qytetarëve për fushën e veprimit të institucionit, rolit dhe rëndësisë që ka në ekonominë e vendit, nga viti 2016, BPRM është e pranishme edhe në rrjetet sociale, me faqen/profilin zyrtar të institucionit në rrjetet sociale: „Facebook“, „Twitter“ dhe „Youtube“. Përveç njoftimeve të rregullta, të dhënat dhe publikimet e rregullta që publikohen në faqen e internetit të BPRM-së, përmes rrjeteve sociale, u fillua me aktivitete për plasim edhe të materialeve që kanë rol edukativ për popullatën, jo vetëm me njohjen e punës së BPRM-së, por edhe me situatat aktuale në vend, të cilat janë të lidhura me qëllimet dhe detyrat e institucionit.

13.3. Edukimi financiar

Në fushën e edukimit financiar, gjatë vitit 2016 janë kryer disa aktivitete për të njohur popullatën në Republikën e Maqedonisë me financat dhe ekonominë.

Edukimi financiar i popullsisë, si një nga funksionet më të rëndësishme të bankave qendrore moderne, kishte vend qendror në shënimin e jubileut me rastin e 70 viteve të aktiviteteve të bankimit qendrore në Republikën e Maqedonisë. Në këtë kontekst, gjatë gjithë vitit u realizua Programi gjithëpërfshirës për edukimin financiar të fëmijëve të shkollave fillore. Me Programin u përfshinë gjithsej 4,331 nxënës, të shoqëruar nga gjithsej 358 mësues nga 87 shkolla fillore nga i gjithë vendi. Pjesa e parë e Programit përfshinte vizita njëditore të filloristëve në Muzeun e Bankës popullore dhe Farkatërinë e parave ndërsa nxënësit patën mundësi të njihen edhe me funksionet themelore të BPRM-së përmes një prezantimi interaktiv. Për një pjesë të shkollave fillore nga zonat më të largëta dhe zonat me më pak popullatë, vizita u siguroa dhe u organizua nga BPRM-ja. Pjesa e dytë e Programit përfshinte një karvan të organizuar, në kuadër të së cilës u vizituan gjithsej 10 shkolla fillore nga 10 komuna.

Si pjesë e aktiviteteve për edukim financiar, në kuadër të kremtimit të jubileut, BPRM përgatiti dhe promovoi dy filma: "Banka popullore - 70 vjet në shërbim të shoqërisë në Maqedoni: film informativ-dokumentar", kushtuar historisë së BPRM-së dhe "Njiheni bankën qendrore: film informativ-edukativ", të cilët në mënyrë të thjeshtë dhe me një gjuhë të lehtë e të kuptueshme i përpunon aspektet më të rëndësishme që lidhen me qëllimet dhe funksionet e bankës qendrore.

Më 10 shkurt 2016, u nënshkrua Memorandumi për bashkëpunim në fushën e edukimit social dhe financiar ndërmjet BPRM-së, një shkolle private dhe një organizate ndërkombëtare, e cila ofron manuale për këtë qëllim. Qëllimi i futjes së edukimit financiar në arsimin fillor dhe të mesëm është përforcimi i aftësive dhe potencialit financiar tek fëmijët që në moshë të hershme. Projekti pilot, i cili filloi të zbatohet së pari tek nxënësit e klasës së parë të kësaj shkolle, përfundoi me sukses dhe pas vlerësimit të bërë, projekti vazhdoi me nxënësit nga klasa e dytë deri në klasën e nëntë. Në vitin e ri akademik 2016/2017, u vazhdua me edukimin financiar edhe me klasat e dyta. Në të ardhmen, planifikohet që rezultatet e Projektit të prezantohen para Byrosë për zhvillimin e arsimit dhe në shkolla të tjera, me qëllim të rritjes së ndikimit dhe interesit për futjen e këtij programi edhe në shkollat e tjera të vendit.

Për vitin e katërt me radhë, nga 14 deri më 20 mars 2016 u shënua "Java globale e parave", nën moton "Merr pjesë, kurse me zgjuarsi!", si pjesë e iniciativës globale të organizuar nga Organizata ndërkombëtare për edukim financiar të fëmijëve dhe të rinjve nga Amsterdami, Hollandë, dhe në organizim nga Trupi koordinues i institucioneve rregullatore për edukim financiar në Maqedoni, udhëheqës i të cilit është BPRM. Në kuadër të kësaj, janë organizuar vizita të shkollave fillore dhe të mesme në BPRM.

Më 7 tetor 2016, BPRM, në bashkëpunim me Fondin Evropian për Evropën Juglindore, përgatiti tri broshura edukative me temat si vijon: "Me kursim të denarë-ve drejt realizimit të ëndrrave!", "Çfarë duhet të dimë para marrjes së kredisë" dhe "A menaxhoni ju me paratë tuaja apo paratë tuaja menaxhojnë me ju? ". Broshurat paraqesin udhëzues të vegjël praktik, të disponueshëm në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe dhe ofrojnë informacione në lidhje me kursimet, kreditë dhe menaxhimin me paratë në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme dhe të thjeshtë. Këto broshura u shpërndanë tek të gjitha bankat

tregtare në vend. Qëllimi i botimit të këtyre materialeve edukative është të ndihmojë qytetarët të marrin vendime të shëndosha financiare.

Më 20 tetor 2016 u nënshkrua Memorandumi për bashkëpunim në fushën e edukimit dhe përfshirjes financiare në mes të BPRM-së dhe Shoqatës së organizatave mikrofinanciare. Bashkëpunimi do të realizohet në fushën e hartimit të politikave, hulumtimeve dhe analizave, aktiviteteve të përbashkëta për ngritjen e vetëdijes publike dhe promovimin e edukimit dhe përfshirjes financiare, organizimit të aktiviteteve edukative dhe shkëmbimit të ekspertizës përkatëse.

Më 26 tetor 2016 u nënshkrua Memorandumi për bashkëpunim në fushën e avancimit të edukimit financiar ndërmjet BPRM-së dhe Odës ekonomike të Maqedonisë. Nënshkrimi i këtij memorandumi paraqet një tjetër hap përpara në avancimin e bashkëpunimit të suksesshëm shumëvjeçar institucional. Roli i Odës nëpërmjet shoqatave në kuadër të Dhomës është të informoj dhe inkurajoj komunitetin e biznesit për të dhënë mbështetje në zbatimin e projekteve në fushën e edukimit financiar, në përputhje me mundësitë dhe interesat e tyre. BPRM do të mbështesë projektet e Odës për edukim financiar (nëpërmjet Qendrës së tyre për edukim dhe Qendrës së biznesit për trajnim) për kryerjen e aktiviteteve edukative, të tilla si: mbajtje të ligjëratave, seminare, punëtori, tryeza të rrumbullakëta, konferenca, trajnime të brendshme dhe ngjarje të tjera.

Me rastin e Ditës botërore të kursimeve, më 31 tetor, BPRM së bashku me Ministrinë e Financave dhe Agjencinë për mbikëqyrje të sigurimeve i dhanë çmimet për veprat më të mira artistike dhe letrare të paraqitura në konkursin për shkollat fillore dhe të mesme, në temat si vijon: "Edhe unë di të kursej" dhe "Çfarë do të thotë për mua siguri i shtëpi dhe familjes". Në konkurs u paraqitën 402 krijime dhe 15 më të mirët morën diploma dhe shpërblime të holla. 44 nxënësve dhe 7 shkollave iu ndanë mirënjohje për ide kreative dhe inovative të fëmijëve lidhur me kursimet dhe sigurimet.

Më 15.11.2016, në mjesditet e BPRM-së u mbajt Punëtorja e dytë për gazetarët. U vërejt një interesim i madh nga mediat më të mëdha ndërsa disa media morën pjesë për herë të parë. Ligjëratat ishin nga fushat me interes për gazetarët dhe kryesisht kishin të bëjnë me përdorimin dhe interpretimin e treguesve monetarë dhe financiarë, statistikat e jashtme dhe të ngjashme.

13.4. Aktivitetet e Muzeut, Bibliotekës dhe arkivit të BPRM-së

Në kuadër të veprimtarisë së muzeut të BPRM-së, gjatë vitit të kaluar nga ana Muzeut të BPRM-së, përveç detyrave aktuale, janë realizuar disa aktivitete lidhur me edukimin e fëmijëve dhe të rinjve përmes realizimit të vizitave të organizuara të ekspozitës ekzistuese të muzeut si dhe përgatitja dhe botimi i broshurës për edukim të fëmijëve. Gjithashtu, Muzeu në mënyrë aktive u përfshi në kremtimin e 70 vjetorit të punës së bankimit qendror të institucionalizuar në Republikën e Maqedonisë përmes pjesëmarrjes në përgatitjen e filmave informativ-edukativ dhe ekspozitës muzeore të përkohshme. Njëkohësisht, vazhdoi puna hulumtuese-shkencore, e cila përfshin studimin dhe interpretimin e aspekteve të ndryshme të numizmatikës dhe historisë monetare të Maqedonisë, ndërsa në të njëjtën kohë përfaqësuesit e Muzeut morën pjesë në ngjarje ndërkombëtare në fushën e veprimtarisë muzeale.

Sa i përket aktiviteteve të Bibliotekës dhe arkivit të BPRM-së, paralelisht me detyrat aktuale, në Bibliotekën e BPRM-së për herë të parë u prezantua shërbimi i huazimit ndërbankar të brendshëm dhe ndërkombëtar të botimeve të shtypura. Përveç kësaj, në

kuadër të kremit të 70 vjetorit të bankimit qendror, u përgatitën dhe u botuan dy botime bibliografike: për bankimin qendror në Republikën e Maqedonisë në periudhën 70-vjeçare dhe për mendimin shkencor të BPRM-së nga periudha e pavarësisë monetare. Në fushëveprimin e punës arkivore, vazhdoi përzgjedhja dhe hulumtimi i materialit arkivor në Arkivin shtetëror të Republikës së Maqedonisë. Vitin e kaluar u nënshkrua Marrëveshja për bashkëpunim me Bankën popullore të Serbisë, me çka u mundësua vazhdimi i aktiviteteve hulumtuese për përzgjedhjen e materialeve arkivore e cila është e rëndësishme për punën e bankimit qendror në Republikën e Maqedonisë ndërsa të njëjtat janë të vendosura në Bankën popullore të Serbisë.